

**QENDRA SHQIPTARE PËR KONKURRUESHMËRINË DHE TREGTINË
NDËRKOMBËTARE**

ALBANIAN CENTRE FOR COMPETITIVENESS AND INTERNATIONAL TRADE

RAPORTI I STUDIMIT

**“ANALIZË E KOSTOVE DHE PËRFITIMEVE POLITIKE DHE
EKONOMIKE TË PROCESIT TË INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË
BASHKIMIN EUROPIAN”**

TIRANË, SHTATOR 2014

Ky projekt kërkimor u realizua me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Grupi i punës:

Klodjan Seferaj, Menaxher Programi për Mirëqeverisjen dhe Integrimin Evropian (OSFA)

Arjan Kadareja, PhD

Dokt. Blerjana Bino

Dokt. Besart Kadia

Elona Varfi, MSc

Sashenka Lleshaj, MSc

Dorela Noti, MA

Erisa Çakalli, BA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Projekti kërkimor bën një analizë të kostove dhe përfitimeve politike dhe ekonomike të procesit të integritimit në Bashkimin Europian për Shqipërinë duke u ndalur në fusha specifike si tregtia e lirë, konkurrenca, rritja ekonomike, bujqësia dhe siguria ushqimore si dhe në pikëpamjen politike dhe institucionale. Projekti kërkimor ofron një analizë sistematike të bazuar në kombinimin e qasjes metodologjike sasiore dhe cilësore. Kështu projekti ndihmon në rritjen e informimit dhe ekspertizës vendase për çështjet e integritimit dhe fushat specifike. Kjo do të sjellë një përmirësim dhe orientim të debatit publik si dhe do të nxisë ritmin e reformave integruese.

Ashtu sikurse sugjerohet në literaturë dhe pasi kontrollohet për një sërë efektsh që nuk kanë të bëjnë me procesin e integritimit të Shqipërisë me BE-në, studimi gjen evidence se flukset tregtare të Shqipërisë me vende të BE-së të prekura më pak ose aspak nga kriza janë rritur në përqindje të totalit. Ajo që duket më e rëndësishme është se kjo rritje dominon rritjet respektive të flukseve të tregtisë së Shqipërisë me secilën nga zonat e tjera të botës.

Gjithashtu studimi gjen evidence se në rastin e Shqipërisë gjatë periudhës së pas hyrjes në fuqi të MSA-së (2009-2012) ka një rritje të ndjeshme të IHD-ve ndonëse periudha në fjalë koinçidon me ashpërsimin e krizës së borxheve sovranë në eurozonë, që është zona e origjinës së një pjese të konsiderueshme të IHD-ve për në Shqipëri. Por, rezultatet e mësipërme të flukseve tregtare Shqipëri – BE, ndonëse të qarta dhe interesante, duhet marrë me rezervë të paktën për tre arsye: së pari, periudha e të dhënave të përdorura është relativisht e shkurtër; së dyti, rritja e flukseve tregtare Shqipëri – BE, ndonëse më e larta, nuk është statistikisht e ndryshme nga rritja e flukseve me dy zonat e tjera më të afërta dhe së treti, metoda e kontrollit për krizën është e përafërt. Gjithashtu, evidence e IHD-ve duhet marrë me rezervë, sepse periudha 2009-2012 koinçidon edhe me futjen e Shqipërisë në NATO gjë që me të drejtë mendohet se ka ndikuar pozitivisht në rritjen e sigurisë dhe për pasojë edhe të IHD-ve në Shqipëri.

Analiza e flukseve tregtare do të pasurohej shumë nëse do të zbatohet edhe në nivel mikro, dmth duke zbatuar të njëjtën metodologji për secilën kategori importesh dhe eksportesh. Ne gjithashtu mendojmë se efektet potenciale të integritimit europian në rritjen ekonomike dhe në fushën e integritimit financiar do të materializohen më tej teksa Shqipëria ti afrohet anëtarësimit të plotë në BE. Studime të mëtejshme është mirë të fokusohen në këto drejtime.

Integrimi europian do të kishte efekte në rritjen ekonomike të Shqipërisë në atë masë që ndikon akumulimin e kapitalit fizik, njerëzor dhe teknologjik. Teorikisht përcaktohen dy mekanizma, përmes të cilëve integrimi europian ndikon akumulimin e kapitalit. Së pari, integrimi europian e bën më eficientë ekonominë, dmth. i paraprin një efekti pozitiv shpërndarjeje të burimeve, sjell rritjen e prodhimit dhe kjo, më tej – duke supozuar një raport konstant investimesh kundrejt të ardhurave – çon në rritjen absolute të investimeve. Rezultati përfundimtar është një sasi më e madhe e kapitalit dhe e të ardhurave për frymë në ekuilibër. Së dyti, ai mund të sjellë edhe rritjen e raportit të investimeve kundrejt të ardhurave përmes uljes së rrezikut. Ashtu sikurse edhe në rastin më sipër, rezultati përfundimtar është një sasi më e madhe kapitali dhe të ardhurash për frymë.

Për vlerësimin e efekteve të integrimit europian në investime dhe rritjen ekonomike, literatura është marrë sidomos me rastet e vendeve që i janë bashkuar BE-së gjatë rrugës. Vende të tilla janë Portugalia, Spanja, vendet Balltike, Greqia, etj. Kështu, në Portugali (Baldwin dhe Seghezza, 1998) investimet në raport me PBB-në u rritën shumë dhe shpejt në periudhën para anëtarësimit në BE. Edhe në Spanjë, pas anëtarësimit, investimet u rritën shumë duke mbështetur teorinë që lidh integrimin më të ngushtë me rritjen e investimeve dhe më tej me rritjen ekonomike.

Është e vështirë për tu përgjigjur pyetjes për ndikimin e procesit të integrimit në rritjen ekonomike. Teorikisht nuk ka dyshime se integrimi europian sjell, deri në terma afatmesme, një rritje më të lartë ekonomike për vendet që anëtarësohen në BE, por në fushën empirike rezultatet nuk janë aq bindëse. Gjithësesi, në përputhje me hipotezën e ngritur në këtë studim, ne nuk mendojmë se faza e tanishme, relativisht e hershme, e procesit të integrimit Shqipëri – BE ka lënë gjurmë në rritjen ekonomike të Shqipërisë apo në zhvillimet e tregjeve të saj financiare. Këto mbeten drejtime për tu eksploruar në të ardhmen teksa Shqipëria të avancojë në fazën e integrimit europian.

Kostot dhe përfitimet në aspektin politik dhe institucional nuk mund të shihen veçse në terma afatmesëm dhe afatgjatë në lidhje me atë që është tashmë *‘e vetmja lojë në qytet’* ose ndryshe *‘alternativa e vetme e zhvillimit të Shqipërisë’* – integrimi në BE. Kur flitet për PSA-në, MSA-në, lëvizjen e lirë në zonën Shengen apo marrjen e statusit të vendit kandidat, përveç simbolikës që lidhet me momente dhe data të caktuara, në terma politik është procesi ai që fiton rëndësi. Në këto kushte, procesi i integrimit në BE i ka ndikuar institucionet, demokratizimin, dialogun politik dhe politikëbërjen në Shqipëri në aspektin formal dhe përmbajtësor si në terma kostosh ashtu dhe përfitimesh.

Në terma formalë, sidomos gjatë intervistave të thelluara, u vu re se aktorët e përfshirë në proces nënvizuan anën normative të procesit, sidomos përmirësimin e kuadrit legjislativ; vendosjen e standardeve të përbashkëta; asistencës financiare dhe ndërtimin e kapaciteteve për çështjet e brendshme dhe të sigurisë. Në aspektin normativ, përafrimi i legjislacionit është ndoshta dhe arritja më e matshme në terma sasiorë, ndërkohë që përshtatja me kontekstin vendor dhe zbatueshmëria e tij ka përbërë dimensionin më problematik të kuadrit legjislativ.

Në terma përmbajtësorë, analiza e të dhënave tregon se procesi i integrimit europian ka shërbyer si një shtysë e fortë për zhvillimin e institucioneve në vend; koordinimin ndërinstitutional; ngritjen e institucioneve të reja; hapjen e vendimmarrjes përkundrejt aktorëve të tjerë shoqërorë dhe rritjen e llogaridhënies; përmirësimin e burimeve njerëzore dhe shtimin e kapaciteteve përthithëse të fondeve.

Kostot kryesore sa i takon demokratizimit dhe dialogut politik janë: kushtëzimi politik krijon varësi të aktorëve dhe institucioneve kundrejt atyre të BE-së; Parlamenti Evropian nuk ka dalë gjithmonë me një qëndrim të përbashkët dhe kjo ka thelluar polarizimin në arenën politike në Shqipëri. Megjithatë, problematika më e madhe këtu nuk vjen nga kostot në vetvehte, sesa nga instrumentalizimi i procesit nga aktorët politik, komunikimi politik i personalizuar dhe në llogore të ndryshme, fitimi i një farë ‘imuniteti’ ndaj kushtëzimit të BE-së.

Në lidhje me politikëbërjen, vendimmarrjen dhe llogaridhënien, presioni i jashtëm i realizimit të proceseve konsultative dhe monitoruese ka sjellë një mungesë të pronësisë së tyre lokale, e cila do të ishte më e qartë nëse proceset do kishin ndodhur gradualisht dhe si një nevojë e brendshme. Gjithashtu, konsultimi me grupet e interesit dhe shoqërinë civile shpesh nuk është i qenësishëm, por i bërë shpejt e shpejt për shkak të pranisë së përfaqësuesve të BE-së apo nevojës për të raportuar.

EXECUTIVE SUMMARY

The principal aim of the project is to conduct an analysis of the costs and benefits of the European Union process of Albania with a particular focus on the economic and political dimension. The analysis concentrated on the following main areas: free trade, economic growth, agriculture and food security, competitiveness and free movement. The project seeks to provide a thorough analysis of the process of integration considering the period between 2006 and 2013 of the specific areas mentioned above. The project does not attempt to look into the projections of costs and benefits of the accession process and becoming a member of the European Union, which will require an entirely new project, analysis and methodology.

The project applies a combined methodology approach of quantitative and qualitative methods. In addition, researchers have adopted specific methodology in accordance with the areas being analysed. The quantitative analysis is used to analyse the data regarding the impact of the EU integration process on trade and economic growth as well as agriculture. The qualitative analysis is used to analyse the effects of the integration process on food security, free movement, and competitiveness. In addition, the project has used in-depth interviews to collect the perceptions of the public and private sector as well as the independent experts and scholars regarding the costs and benefits of the integration process.

The project analyses the period of seven, between 2006 (Stabilization and Association Agreement) and data from 2013. This period is divided into two sub-periods: 2006-2009 and 2009-2013. The first is deemed as slow-integration phase and 2009-2013 as a faster integration phase. The economic dimension of the integration process considers free trade and trade exchanges and foreign direct investment. The analysis is complicated to the fact that the EU integration process is not the only control variable for the impact on trade, other variables include: the Eurozone and global crises, the crises of the main trade partners and neighbouring countries of Albania (Italy, Greece), NATO membership.

As suggested by the literature on the effects of the European integration, the analysis shows that if we control for other variables not related to the process of EU integration, the trade exchanges have increased in total between Albania and those EU countries that have been less affected or not at all by the crises. The highlight here is that this increase in trade exchanges is higher than the increase in trade exchanges between Albania and other countries.

The analysis shows that in the case of Albania there has been an increase in the Foreign Direct Investment (FDI) for the period between 2009-2012, i.e. after the Stabilization and Association Agreement with the EU enters into force. The increase in FDI is noticed even though this period coincides with the debt crisis in the Eurozone, which is also the original of the majority of the FDI for Albania. However, when using these results one needs to consider the following: first, the period used in the analysis is relatively short; second, the increase in the trade exchanges between Albania and EU, even though the highest, is not statistically different from the increase in trade exchanges with other countries; third, the analysis uses an approximation of the control method for the effect of the crisis on the trade exchanges between Albania and EU. In addition, the increase in FDI inflows for the period 2006-2012 may also be related to the Albanian membership into NATO, which might have positively affected the flow of FDI.

This project suggests that the analysis of the trade exchanges should also be conducted at the micro level, i.e. using the same methodology for all categories of import and export. The potential impact of the European integration in the economic growth of the country and in the financial integration will be fully

materialized once Albania becomes a member of the EU. Therefore, future research should consider the projection of accession effects.

The costs and benefits in political and institutional terms of what is now “the only game in town” or “the only development alternative for Albania” — EU integration — are only visible in the mid-and-long-term. When one mentions the SAP, the SAA, the free movement into the Schengen zone or the granting of the status of the candidate country, apart from the symbolic which is related to a specific moment in time, it is the process that gains importance when it comes to political terms. Thus, EU integration process has affected institutions, democratization, political dialogue and decision-making in Albania in a formal and substantial sway in relation to both costs and benefits.

In formal terms, especially during the semi-structured interviews, it was noticed that the actors involved in the process would underline the normative side of the process, especially the improvement of the legislative framework; the adoption of common standards; the financial assistance and the building of capacities for domestic and security issues. In relation to the normative aspect, the harmonization of Albanian legislation is perhaps the best quantifiable achievement, whereas the domestic adaptation and its implementation are the most problematic side of the legislative framework.

Moreover, still in formal terms, the process has also been coupled with a sophistication of the bureaucratic aspect (in the direct sense, with no negative connotation) given the fact that during this time a series of new institutions and structures have been built in order to serve both citizens and other actors involved in the process (such as civil society, interest groups, etc.), but also to facilitate the inter-institutional coordination and to bring the process forward. The most concrete example of these developments is the foundation of the Ministry of European Integration and of all of the other structures that deal with EU integration in other institutions.

In substantial terms, data analysis shows that the process of European integration has served as a strong incentive for the development of institutions in the country: inter-institutional coordination; building of new institutions; opening of the decision-making process towards other societal actors and increased accountability; improvement of human resources and increase of grant absorptive capacities.

Another field where Albania has benefited during the integration process is the functioning of institutions in terms of: development of institutional and human capacities through the assistance programs; better inter-institutional coordination; improved institutional independence; higher quality of institutional functioning and their technical capacity.

In regard to democratization and political dialogue, Albania is considered to have benefited from the integration process in these aspects: empowerment of political actors; improvement of democratic processes (elections) and mediation in resolving polarized situation; the establishment of a main framework for accountability and transparency in decision-making; the process has served as an incentive of reform for political dialogue. The European integration offers a model for the political, institutional, economic and social development. Communication and openness towards Europe and an increased feeling of belonging and sharing European values have served the development of Albanian society; the European integration is a continuous process of conditionality, negotiation, harmonization and integration that helps democratization.

Regarding the quality of policymaking, decision-making and accountability, the EU pressure to create institutions, the legal framework and the mechanisms for consultation with other actors in society are seen

as the main benefits. More specifically, benefits are: a consultative process motivated by the EU in drafting policies/strategies — consultation and monitoring; resolution of internal crisis with the mediation of EU institutions; a positive incentive to prepare strategic documents; higher access to information for citizens and the creation of a culture of accountability; enforcement of the role of civil society actors in their requirements for higher accountability through formal and informal instruments; as well as building new formal structures for an integrated development at the local level.

Regarding the costs of the integration process, government officials identify as the major cost the financial cost of the harmonization of the Albanian legislation with the EU one and the local adaptation of such a legislation; the adaption of instruments for the implementation of the legislation and the development of human capacity.

Another cost that was identified by the public officials was the dependency track of the country towards EU conditionality, thus undermining the creation of a culture of sustainability in developing policies and processes that originate from within and which are not conditioned from the outside.

A series of costs were identified by the civil society representatives such as: the internal institutional communication has been threatened under the pressure of finishing everything in a hurry in meeting EU conditions; the connection between the political will and decision-making with the technical side of decision-making in other institutional levels has been undermined; the process of EU integration has become technical and executive, something that could potentially threaten the institutional balance and independence if instrumentalised by political actors.

The main costs when it comes to democratization and political dialogue are: political conditionality creates dependence of domestic actors and institutions towards the EU ones; The European Parliament (a political entity) has not always advocated a common position in relation to specific issues in Albania, something that has contributed to the polarization of the political arena in Albania. Nevertheless, the main problematic here is not related to cost themselves, but mostly to the instrumentalisation of the process by political actors, a personalized political communication and the acquisition of a certain 'immunity' towards EU conditionality.

In regard to policymaking, decision-making and accountability, the external pressure to perform processes of consultation and monitoring has led to a lack of local ownership of these processes, something that would have been better developed if the processes would have happened gradually and as a consequence of internal needs. Moreover, the consultation with interest groups and civil society is often not substantial, but done in a hurry just because of the presence of EU representatives or the need to report.

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	KAPITULLI HYRËS	1
1.1	Konteksti i projektit kërkimor	1
1.2	Qëllimi dhe objektivat e projektit kërkimor	2
1.3	Rëndësia e projektit kërkimor.....	3
II.	METODOLOGJIA E PROJEKTIT KËRKIMOR.....	5
2.1	Metodologjia e kërkimit.....	5
2.3	Intervista të thelluara me politikëbërës, biznesin dhe ekspertët	6
2.4	Arritjet dhe vështirësitë e projektit kërkimor	6
III.	ANALIZA E KOSTOVE DHE PËRFITIMEVE TË PROCESIT TË INTEGRIMIT	8
3.1	Kontekstualizimi i procesit të integrimit evropian: Nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit tek statusi i vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.....	8
3.1.1	Integrimi evropian dhe institucionet, politika dhe demokracia shqiptare.....	8
3.1.1	Analizë cilësore dhe kronologjike e hapave të procesit të integrimit	8
3.1.2	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit	10
3.1.3	MSA dhe Kriteret e Kopenhagenit.....	11
3.1.4	Plotësimi i pyetësorit dhe heqja e regjimit të vizave	12
3.1.5	Statusi i vendit kandidat, fillimi i negociatave për anëtarësim dhe anëtarësimi në BE	12
3.2	Dimensioni ekonomik i procesit të integrimit në Bashkimin Evropian.....	14
3.2.1	Marrëveshjet e liberalizimit preferencial të njëanshëm: MSA (SAA) dhe statusi GSP (General System of Preferences)	14
3.2.2	Modeli teorik për efektet e marrëveshjes së liberalizimit preferencial të njëanshëm.....	15
3.2.4	Vlerësim i efekteve në investimet e huaja direkte (IHD) 2006-2013	18
3.2.5	Diskutim: Rritja ekonomike dhe efektet e integrimit	19
3.2.6	Përfundime dhe pista studimesh të mëtejshme në fushën e integrimit Shqipëri – BE	20
3.3	Efektet e procesit të integrimit në fushën e konkurrencës.....	21
3.4	Efektet e procesit të integrimit në lëvizjen e lirë të njerëzve, kapitalit dhe shërbimeve	22
3.5	Efektet e procesit të integrimit në sektorin e bujqësisë dhe sigurisë ushqimore	24
3.5.1	Bujqësia në procesin e integrimit në BE.....	24

3.5.2	<i>Kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit në sektorin e bujqësisë</i>	29
3.5.3	<i>Siguria ushqimore në procesin e integrimit në BE</i>	33
3.5.4	<i>Kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit për sigurinë ushqimore</i>	39
3.6	Perceptimet dhe shpjegimet e aktorëve të përfshirë: Një analizë cilësore	42
3.6.1	<i>Perspektivat e sektorit privat për kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit</i>	42
3.6.2	<i>Perspektivat e politikbërësve për kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit</i>	43
3.6.3	<i>Qasja kritike për kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit nën optikën e ekspertëve</i>	44
I.	KAPITULLI PËRMBYLLËS	47
4.1	Përfundimet e projektit kërkimor	47
	<i>Përmbledhje e përfitimeve dhe kostove të procesit të integrimit në BE në fushën ekonomike</i>	49
	<i>Përmbledhje e përfitimeve dhe kostove të procesit të integrimit në BE në fushën e bujqësisë</i>	50
	<i>Përmbledhje e përfitimeve dhe kostove të procesit të integrimit në BE në sigurinë ushqimore</i>	51
4.2	Kërkimi i mëtejshëm	52
ANEKSE		58

LISTA E TABELAVE DHE FIGURAVE

Tabela 1: Shkëmbimet tregtare 2006-2013	17
Tabela 2: Shkëmbimet tregtare dhe efektet e integritit.....	18
Tabela 3: Flukset e investimeve të huaja direkte në Shqipëri në përqindje të PBB-së?.....	19
Tabela 4: Buxheti për 2014-2020 IPARD II/ milion euro	26
Tabela 5: Kampioni i studimit për intervistat e thelluara	61
Tabela 6: Përmbledhja e perceptimeve të sektorit privat.....	72
Tabela 7: Përmbledhja e perceptimeve të sektorit publik.....	74
Tabela 8: Përmbledhja e perceptimeve të ekspertëve/ shoqëria civile	75
Figura 1A: Mesatarja e eksport-importeve shqiptare sipas Zonave (në përqindje të totalit).....	58
Figura 2A: Mesatarja e eksport-importeve shqiptare sipas zonave (në vlerë).....	58
Figura 3A: Importet shqiptare të mallrave sipas zonës së origjinës	58
Figura 4A: Eksportet e mallrave shqiptare sipas destinacionit (zonës)	59
Figura 5A: Investimet e huaja direkte në Shqipëri (në përqindje të PBB-së).....	59

SHKURTIME

ACIT	Qendra Shqiptare për Konkurrueshmërinë dhe Tregtinë Ndërkombëtare
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ATP	Regjimi Autonom Preferencial
AZHBR	Agjensia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
CARDS	Asistenca Komunitare për Rikonstruktim, Zhvillim dhe Stabilizim
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Europës Qëndrore
CMO	<i>Organizimi i Tregut të Përbashkët</i>
DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
DPM	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
DPS	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
DPSUMK	Drejtoria e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
EEC6	Vendet Fillestare të Komunitetit Ekonomik European
EFSA	Autoriteti European i Sigurisë Ushqimore
EFTA	Shoqata Europiane e Tregtisë së Lirë
EU	European Union
EURALIUS	Misioni i Asistencës Europiane për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë
FDI	Foreign Direct Investment
FTA	Marrëveshje e Tregtisë së Lirë
IHD	Investimet e Huaja Direkte
INSIG	Instituti i Sigurimeve
IPA	Instrumentat për Asistencën e Para-antarësimit
IPARD	Instrumentat për Asistencën e Para-antarësimit për Zhvillimin Rural
ISUV	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MBZHRAU	<i>Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave</i>
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
MTBE	Marrëveshja për Tregti dhe Bashkëpunim Ekonomik
NAFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut
NATO	North Atlantic Treaty Organisation
OMGJ	Organizmat e Modifikuar Gjenetiksht
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
PAMECA	Misioni i Komunitetit European për Asistencën ndaj Policisë në Shqipëri
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PDO/PGI	Produktet me Origjinë të Mbrojtur
PHARE	Programi i Asistencës së Komunitetit European ndaj vendeve të Europës Qëndrore dhe Lindore
PKPL	Plani Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit
PKZMSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
PSA	Procesi i Stabilizim Asocimit
SAA	Stabilisation and Association Agreement

SAP	Stabilisation and Association Process
SIEE	Strategjia për Integrimin European dhe Euro-Atlantik
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
TAIEX	Assitenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WTO/OBT	Organizata Botërore e Tregtisë

I. KAPITULLI HYRËS

1.1 Konteksti i projektit kërkimor

Që nga përmbysja e regjimit komunist, Shqipëria filloi marrëdhëniet e bashkëpunimit ekonomik dhe politike me Bashkimin Europian dhe vendet anëtare. Këto marrëdhënie u intensifikuan ndjeshëm në vitet 2000, me hapjen e negociatave për nënshkrimin e një marrëveshje stabilizim-asocimi midis Shqipërisë dhe Bashkimit Europian. Nga ai moment vendi ka përjetuar një thellim të integritit me Bashkimin Europian, duke intensifikuar bashkëpunimin institucional dhe duke përshtatur legjislacionin vendas me atë komunitar. Hapat më të rëndësishëm të viteve të fundit kanë qenë nënshkrimi i marrëveshjes së stabilizim asocimit, hyrje në fuqi e kësaj marrëveshjeje, bashkë me pjesën tregtare, aplikimi për marrjen e statusit kandidat.

Pavarësisht frymës pozitive dhe perceptimit që mbart ky proces, në terrenin shqiptar ka munguar një debat i mirëfilltë dhe i stukturuar mbi analizën e kostove dhe benefiteve të integritit. Përveç disa zërave dhe artikujve të izoluar në shtypin e përditshëm, në Shqipëri ende nuk janë bërë përpjekje serioze për të studiuar implikimet e procesit për realitetin shqiptar. Përtej nevojave të përmbushjes së kriterëve administrative dhe legjislativë, konformimi dhe përafrimi me kriteret e anëtarësimit kërkon një sërë transformimesh ekonomike dhe politike të vendit. Është e qartë që përshtatja institucionale, ekonomike dhe sociale që vijnë për shkak të adoptimit të ligjeve europiane kanë kosto.

Në praktikën e vendeve që janë anëtarësuar më parë, janë vënë re 2 lloje kryesore kostosh (në fazën para anëtarësimit): (i) kostot që lidhen me adoptimin e normave dhe politikave europiane (acquis i BE). Këtu hyjnë kostot që lidhen me ndërtimin e institucioneve, burimet njerëzore, etj.; (ii) Kostot që lidhen me konformimin dhe zbatimin e standarteve që përcaktohen nga politikat dhe normat europiane. Këto janë kostot që lidhen me fushat dhe politikat specifike, me modernizimin e infrastrukturës, me standartet e punës, ato sociale, mbrojtje e konsumatorit, cilësia, mjedisi, etj. Pra, shumica e kostove vijnë nga diferencat midis strukturave institucionale dhe normave ekzistuese dhe atyre që kërkon anëtarësimi në Bashkimin Europian.

Pamundësia e Shqipërisë për të përmbushur nevojat që shfaqen në këtë proces, ka sjellë disa pasoja, sidomos nga pikëpamja e zbatimit të politikave të adoptuara. Kjo ka bërë që vendi të adoptojë me ritëm të konsiderueshëm norma dhe praktika komunitare, pa patur kapacitetet financiare dhe institucionale për të garantuar zbatimin, duke rritur atë që cilësohet në literaturë si deficieti i zbatimit. Ky fenomen ka prodhuar disa pasoja të tjera të ndërlidhura, për të cilat mungojnë analiza të mirëfillta. *Qëllimi i këtij studimi është jo vetëm analiza e kostove direkte të integritit në sektorët si tregtia, rritja ekonomike, konkurrenca, bujqësia dhe siguria ushqimore, lëvizja e lirë, por edhe një diskutim mbi kostot indirekte, por me pasoja domethënëse që kanë prodhuar deformimet e procesit.*

Nga ana tjetër, procesi i integritit europian, me anë të instrumentave të kushtëzimit, ka rezultuar i suksesshëm në përshpejtimin e reformave në Shqipëri dhe vende të tjera. Perceptimi i përgjithshëm është që benefitet janë gjithmonë më të mëdha se sa kostot, sidomos për vendet e vogla. Edhe pse në rastin e Shqipërisë, benefitet e integritit raportohen dhe reklamohen shpesh nga institucionet apo aktorët e ndryshëm, mungon një analizë e thelluar mbi matjen e këtyre pasojave. Ndërkohë që

ka indikatorë të qartë matës për sa i përket ‘produkteve’ (output) që sjell integrimi, situata paraqet boshllëqe kur trajtohet impakti (outcome) i procesit.

Krahas benefiteve tradicionale të integrimit, që kanë nevojë për analizë në rastin shqiptar, si: shtimi dhe diversifikimi i burimeve financiare, përshpejtimi i reformave dhe mbështetja në politikat ekonomike të vendit, etj., tashmë ka ardhur koha për një studim specifik mbi impaktin që këto politika kanë patur në terrenin shqiptar.

1.2 Qëllimi dhe objektivat e projektit kërkimor

Qëllimi i projektit kërkimor është të bëjë një analizë të kostove dhe përfitimeve politike dhe ekonomike të procesit të integrimit në Bashkimin Europian për Shqipërinë, duke u ndalur në fusha specifike si tregtia e lirë, konkurrenca, rritja ekonomike, bujqësia dhe siguria ushqimore si dhe në pikëpampjen politike dhe institucionale.

Objektivat e projektit kërkimor janë:

Së pari, t’i sigurojë shtetasve shqiptarë dhe aktorëve politikë të dhëna tërësore dhe analizë të mirëfilltë mbi kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit. Duke qenë se mungon një analizë e tillë në rastin shqiptar, projekti synon të mbushë këtë boshllëk, duke ofruar një pasqyrë sa më koherente të implikimeve dhe impaktit që procesi ka në Shqipëri.

Së dyti, duke matur dhe analizuar komponentët e ndryshëm të politikave publike në fushat e përzgjedhura, objektivi i projektit është të nxisë reformat, duke ushtruar presion mbi qeverinë shqiptare dhe institucionet përkatëse, përgjegjëse për zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga Partneriteti Evropian me Shqipërinë, MSA-ja dhe raportet vjetore të Komisionit Evropian për Shqipërinë. Kjo synon edhe përmirësimin e procesit të përafrimit dhe zbatimit të legjislacionit komunitar, si pasojë indirekte e studimit.

Së treti, duke qenë se aktorët e tjerë jo-qeveritarë janë shumë të rëndësishëm në procesin e integrimit, qëllimi i projektit është informimi dhe forcimi i kapaciteteve të tyre për të qenë aktorë politikë pro-aktivë në fushën e integrimit në BE, duke ndikuar në debatin e politikave publike mbi reformat e bazuara në:

- informimin më të saktë dhe bazuar në të dhëna, për procesin e integrimit;
- aftësinë për të reaguar në mënyrën dhe kohën e duhur ndaj ambientit politik që ndryshon me shpejtësi;
- ekspertizë e thelluar dhe profesionale mbi çështje të veçanta brenda fushës së politikave të integrimit në BE;
- aftësinë për të mobilizuar burimet civile, duke zgjeruar kështu kufijtë e njohurive mbi integrimin në BE si edhe ekspertizën jashtë administratës publike për shoqërinë civile dhe sektorin e biznesit;
- aftësinë për të tërhequr vëmendjen e medias dhe për të formësuar debatin politik mbi çështje të integrimit në BE.

Pyetja kërkimore qëndrore e projektit kërkimor është:

“Cilat janë kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit në Bashkimin European në periudhën 2006-2013 në sektorët e tregtisë, rritjes ekonomike, konkurrencës, bujqësisë dhe sigurisë ushqimore?”

Nënpyetjet kërkimore janë:

“Cili është impakti i procesit të integrimit në Bashkimin European nga pikëpamja institucionale dhe politike si në përafrimin e legjislacionit komunitar, procesin e hartimit të politikave dhe instrumentave të zbatimit?”

“Cili është impakti i procesit të integrimit në Bashkimin European në fushën e tregtisë dhe konkurrencës si dhe rritjes ekonomike?”

“Cili është impakti i procesit të integrimit në Bashkimin European në fushën e bujqësisë, dhe sigurisë ushqimore?”

Pas vendosjes së demokracisë në fillim të viteve 1990, Shqipëria hyri në rrugën e integrimit me Bashkimin European (BE). Një stacion i rëndësishëm i kësaj rruge të gjatë ishte nënshkrimi në vitin 2006 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), Shqipëri – BE. Por, Shqipërisë i mbetet edhe shumë rrugë për të bërë.

Natyrisht, anëtarësimi i plotë në Bashkimin European do të kërkojë edhe shumë vite të tjera dhe merret lehtë me mend se efektet e plota të procesit të integrimit do të duhet kohë të materializohen. Gjithësesi, edhe pse në një fazë të ndërmjetme të procesit, me të drejtë mund të ngrihet çështja e vlerësimit të efekteve të integrimit Shqipëri – BE në ekonominë, institucionet dhe demokracinë shqiptare.

Në këtë fazë ne mendojmë se nuk duhen pritur dhe kërkuar efekte që materializohen me kalimin në një fazë të avancuar të procesit. Të tilla efekte janë rritja më e lartë ekonomike që karakterizon vendet disa vjet para dhe pas anëtarësimit në BE (rastet e Spanjës, Portugalisë, Irlandës, etj.), integrimi i tregjeve financiare, etj. Të tilla efekte nuk mendojmë se i korrespondojnë rastit të Shqipërisë, për vetë fazën ku ndodhet.

Ne ngremë *hipotezën* se efektet ekonomike dhe institucionale të procesit të integrimit Shqipëri – BE duhet të jenë të lidhura ngushtë me shkallën e avancimit të procesit. Një fazë e ndërmjetme e procesit integrues Shqipëri – BE nënkupton efekte kryesisht në tregti dhe investime, përsa i përket ekonomisë dhe në adoptimin e legjislacionit komunitar dhe hartimin e politikave e instrumentave të zbatimit, përsa i përket institucioneve.

1.3 Rëndësia e projektit kërkimor

Projekti kërkimor ofron një analizë sistematike të bazuar në kombinimin e qasjes metodologjike sasiore dhe cilësore në fushat e përzgjedhura për tu studiuar. Kështu projekti ndihmon në rritjen e informimit dhe ekspertizës vendase për çështjet e integrimit dhe fushat specifike. Kjo do të sjellë një përmirësim dhe orientim të debatit publik si dhe do të nxisë ritmin e reformave integruese.

Hulumtimi i mekanizmave institucionalë të procesit, që është pjesë e studimit, nxit debatin dhe ushtrimin e presionit për adoptimin e instrumentave më efikasë në hartimin dhe zbatimin e politikave komunitare, duke u bazuar në praktikat më të mira. Për më tepër studimi sjell edhe qasje krahasuese me eksperiencat e vendeve të tjera.

II. METODOLOGJIA E PROJEKTIT KËRKIMOR

2.1 Metodologjia e kërkimit

Projekti kërkimor përdor një qasje metodologjike të kombinuar përmes ndërthurjes së qasjes sasiore dhe cilësore. Analiza e dimensionit ekonomik të kostove dhe përfitimeve të procesit të integrimit realizohet përmes një modeli analitik të bazuar në përpunimin e të dhënave sasiore të publikuara nga institucione zyrtare si Banka e Shqipërisë, Instituti i Statistikave dhe raporte vjetore për tregtinë e lirë të Qendrës Shqiptare për Konkurrueshmërinë dhe Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT). Ndërkohë që përmes qasjes metodologjike cilësore, projekti kërkimor adreson dimensionet e tjera të procesit të integrimit nga pikëpamja institucionale dhe politike si në adoptimin e legjislacionit komunitar, procesin e hartimit të politikave dhe instrumentave të zbatimit. Për më tepër, qasja metodologjike cilësore shërben për të mbledhur dhe më pas analizuar mendime, perceptime dhe shpjegime të aktorëve kyç të procesit të integrimit.

Qëllimi është të mblidhen të dhëna të thelluara për perceptimet e politikëbërësve dhe grupeve të interesit për kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit sipas linjave të përcaktuara për kërkimin. Kampionimi në këtë rast është i qëllimshëm dhe kampioni përbëhet nga drejtorë të drejtorive kryesore në Ministrinë e linjës, të cilët kanë qenë të përfshirë direkt në hartimin e politikave dhe legjislacionit dytësor në kuadër të procesit të integrimit, si dhe që janë pikërisht personat që merren me aspektet e faturës financiare të ndërhyrjes, apo edhe të mekanizmave institucionalë të mundshëm për të zbatuar politikën e caktuar.

Përzgjedhja e grupeve të interesit, komponent i rëndësishëm për të marrë edhe perceptimin e impaktit të politikave në terren, është në bazë të nivelit të organizimit, angazhimit dhe dimensioneve të grupit. Pëfaqësuesit e shoqatave të biznesit dhe të grupeve të ndryshme sociale janë intervistuar përmes intervistave të thelluara, për të mbledhur opinionet e tyre mbi pasojat që ka patur procesi i integrimit. Intervistat janë transkriptuar dhe analizuar me instrumentat përkatës për të nxjerrë informacionin e nevojshëm.

2.2 Modeli analitik për analizën e dimensionit ekonomik të procesit të integrimit

Për vlerësimin e efekteve ekonomike të procesit të integrimit të Shqipërisë me BE-në ndjekim në vija të trasha metodologjinë e flukseve tregtare dhe të investimeve të huaja direkte, të përdorur nga Baldwin&Wyplosz (2012). Në librin e tyre ilustron mjaft qartë një metodologji e tillë.

MSA e Shqipërisë me BE-në është marrëveshje tregtare preferenciale dhe teorikisht duhet të shohim efekte asimetrike në sasinë e eksporteve dhe importeve të mallrave. Kështu teoria na thotë se sasia e eksport-importeve shqiptare me BE-në duhet të rritet në përqindje të totalit. Për të vlerësuar këtë efekt analizojmë eksportet dhe importet e mallrave shqiptare në vlerë dhe në përqindje të totalit për periudhën 2006-2012. Procesi i integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian mendohet se do të sjellë edhe rritjen e investimeve të huaja direkte. Arsyet janë pritshmëria për një rritje ekonomike më të lartë në terma afatmesme kur Shqipëria të jetë pranë antarësimit në BE dhe rritja e eficiencës së ekonomisë shqiptare gjatë rrugës së procesit integruar. Në këtë projekt kërkimor dokumentat që do të përdoren për mbledhjen e të dhënave janë: (i)

raportet e progresit të Komisionit European; (ii) raportet e institucioneve qeveritare; (iii) publikime të organizatave të shoqërisë civile në fushën e procesit të integritetit; (iv) publikime shkencore dhe artikuj të institucioneve të arsimit të lartë dhe/ose qendrave kërkimore.

2.3 Intervista të thelluara me politikëbërës, biznesin dhe ekspertët

Krahas modelit analitik për analizën e dimensionit ekonomik dhe analizës së dokumentave për dimensionin institucional e politik, ky projekt kërkimor përdor edhe intervistat e thelluara për të kuptuar në brendësi procesin e përafrimit dhe zbatimit të politikave komunitare, si dhe kostot reale që i shoqërojnë. Përmes një kampionimi të qëllimshëm, janë përzgjedhur përfaqësues nga tre sektorë kryesorë të procesit të integritetit: (i) institucionet politikëbërëse; (ii) sektori privat dhe organizatat përfaqësuese apo ombrellë të biznesit dhe sipërmarrjeve në Shqipëri; (iii) ekspertë të procesit të integritetit dhe/ose përfaqësues të shoqërisë civile dhe akademisë së angazhuar në kërkim dhe projekte për integrimin europian.

Për realizimin e intervistave të thelluara është përdorur teknika e kampionimit të qëllimshëm¹ dhe madhësia e kampionit është 19 intervista të thelluara të kategorizuara si vijon:

- 9 intervista të thelluara me përfaqësues të ministrive të linjës si Ministria e Integritetit European; Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ujrave; Ministria e Mjedisit;
- 1 intervistë e thelluar me institucione të pavarura: Autoriteti i Konkurrencës;
- 4 intervista të thelluara me organizatat përfaqësuese të biznesit si Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë; Bashkimi i Dhomave të Tregtisë, Business Albania dhe Dhoma e Fasonëve;
- 5 intervista të thelluara me ekspertë të procesit të integritetit europian si dhe përfaqësues të shoqërisë civile si: European Movement Albania, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare.

Linjat kryesore të pyetjeve për intervistat e thelluara bazuar në objektivat dhe pyetjet kërkimore të projektit janë hartuar sipas tre kategorive kryesore të kampionimit më sipër. Megjithatë linjat kryesore të pyetjeve janë: profili i institucionit dhe ndjeshmëria apo roli në procesin e integritetit europian; ndikimi i procesit të integritetit në funksionimin dhe performancën e institucionit; efektet konkrete të MSA-së dhe pikëpamjet lidhur me asimetritë e mundshme të procesit të integritetit². Analiza e gjetjeve është bërë sipas tre sektorëve dhe linjave të pyetjeve për intervistat e thelluara duke e lidhur ngushtë edhe me gjetjet e analizës së të dhënave sasiore.

2.4 Arritjet dhe vështirësitë e projektit kërkimor

Ky projekt kërkimor përpiket të realizojë një analizë tërësore dhe sistematike bazuar në metodologji rigoroze të efekteve të procesit të integritetit në disa fusha specifike, duke shërbyer kështu edhe si një model për të ndërtuar kërkime të thelluara në të ardhmen edhe për fusha të tjera të prekura nga procesi i integritetit. Vështirësia kryesore e projektit kërkimor është analiza e kostove dhe përfitimeve për fusha të tilla si integrimi financiar, eficienta e kompanive dhe rritja ekonomike për mungesë të dhënash të plota e të sigurta. Kryerja e intervistave të thelluara me

¹ Shih Aneks II 'Kampionimi për intervistat e thelluara' për listën e plotë të të intervistuarve.

² Shih Aneks III 'Linjat e pyetjeve për intervistat e thelluara' për më shumë detaje.

përfaqësuesit e institucioneve qeveritare në fillim të vitit 2014 paraqiti një sfidë deri diku të paparashikuar të projektit kërkimor që lidhet me ndryshimet në administratën publike me qeverinë e re të zgjedhjeve të qershorit 2013. Si rrjedhojë, gjatë mbledhjes së të dhënave u vërejt se në disa institucione qeveritare, nëpunësit e emëruar rishtazi nuk mund të mbartnin dijen dhe eksperiencën për të vlerësuar procesin e integritetit evropian dhe efektet e MSA-së. Kështu, vihet re se një nga mangësitë e administratës publike në Shqipëri, është akumulimi dhe ruajtja e dijes institucionale si dhe qëndrueshmëria e personelit. Për më tepër studimi përdor një metodë specifike për çdo fushë kërkimi në varësi të specifikave të saj dhe të të dhënave të disponueshme.

III. ANALIZA E KOSTOVE DHE PËRFITIMEVE TË PROCESIT TË INTEGRIMIT

3.1 Kontekstualizimi i procesit të integrimit europian: Nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit tek statusi i vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian

3.1.1 Integrimi europian dhe institucionet, politika dhe demokracia shqiptare

Shqipëria e viteve '90, ashtu si vendet e tjera e Lindjes të dala nga sistemi komunist, e barazoi tranzicionin, lëvizjen drejt ekonomisë së lirë të tregut, reformimin e institucioneve si dhe demokratizimin me përpjekjet për antarësim në Bashkimin Europian. Ky ekuacion përligjte paradigmen mbizotëruese të kohës, ku europianizimi si proces fitonte një dimension sistemik, ndërkohë që përparimi i vendit perceptohej në mënyrë të njëkahshme drejt BE-së. Eksperiencia e munguar me demokracinë e kombinuar me një eksperiencë intensive me diktaturën komuniste, bëri që refomat institucionale në Shqipëri të mos përktheheshin lehtësisht në procese demokratizuese (Stern & Wohlfeld, 2012: 3). Gjithashtu, eksperiencia e munguar me ekonominë e tregut dhe mungesa e një kulture konkurrence, kombinuar kjo me aplikimin e të ashtuquajturës terapi shoku e vështirësonte më tej tretjen e transformimeve radikale që po ndodhnin në Shqipërinë e kohës (shiko Gugu, 2004; Gruda & Melani, 2010). Për më tepër, nocione si shteti ligjor, kulturë politike pjesëmarrëse, apo institucione të pavaruara nuk kishin fituar akoma kuptueshmëri politike në Shqipëri.

Nga ana tjetër, Bashkimi Europian, ndryshe nga eksperiencia me vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore, në Europën Juglindore eksperimentoi një metodë të re kushtëzimi (conditionality) dhe vlerësimi të progresit për anëtarësim, duke kombinuar qasjen rajonale me atë specifike sipas progresit të secilit vend (Anastasakis & Bechev 2003). Kështu, fazën përgatitore për anëtarësim të vendeve të Ballkanit, BE-ja e paralelizoi me një proces të përbashkët stabilizimi – Pakti i Stabilitetit – që i përshtatej kontekstit të një rajoni post-konfliktual dhe kushtëzonte anëtarësimin e vendeve me progresin e shfaqur drejt bashkëpunimit rajonal. Procesi i Stabilizim Asocimit (PSA) e veçanërisht Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) adresonte vendet një nga një dhe përbënte bazën e bashkëpunimit dypalësh me BE-në. Në këto kushte, MSA-ja e nënshkruar në vitin 2006 u bë baza e marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Europian si dhe njësi matëse e progresit të Shqipërisë drejt anëtarësimit.

3.1.1 Analizë cilësore dhe kronologjike e hapave të procesit të integrimit

Përcaktimi i vendeve të Ballkanit Perëndimorë si kandidatë potencialë për anëtarësim në Bashkimin Europian u parashtrua fillimisht gjatë Këshillit Europian të Feiras dhe Samitit të Zagrebit në vitin 2000 dhe u konfirmua formalisht në Samitin e Selanikut në vitin 2003. Në komunikatën e Komisionit Europian drejtuar Këshillit dhe Parlamentit thuhet se “përgatitja e vendeve të Ballkanit Perëndimor për integrim në strukturat europiane është një prioritet kryesor i Bashkimit Europian” (COM, 2003, 285 final). Prej këtui, formalizimi i përgatitjeve u bë përmes PSA-së. Pavarësisht ndryshimit substancial që PSA-ja dhe MSA-ja sollën në marrëdhëniet e Shqipërisë me BE-në si dhe në perspektivën reale të antarësimit, do të ishte e vështirë analiza e hapave të procesit të integrimit pa iu referuar dinamikës së marrëdhënieve Shqipëri-BE që prej gjenezës në fillim të viteve '90.

Ndërkohë që kushtëzimi politik dhe përpjekjet e Shqipërisë për përmbushjen e këtyre kritereve aplikohen në mënyrë më sistematike me fillimin e PSA-së e sidomos MSA-së, bashkëpunimi ekonomik, asistenca ekonomike si dhe asistenca në ndërtimin e institucioneve i ofrohet Shqipërisë nga BE-ja herët në vitet '90 (Komisioni European, EU-Albania Relations). Kështu, me nënshkrimin e Marrëveshjes për Tregti dhe Bashkëpunim Ekonomik (MTBA) në vitin 1992, Shqipëria përfiton në mënyrë të njëpasnjëshme nga programet PHARE nga viti 1992, më pas me programin CARDS që fillon zbatimin nga viti 2001 dhe lidhet me asistencën institucionale dhe PSA-në, e më tej, nga viti 2006, ndihma europiane u përmbledh në Instrumentat për Asistencën e Para-antarësimit (IPA).³

Ndërkohë marrëveshje të tjera u nënshkruan, të cilat rregullonin përfitimin nga këto programe ndihme si dhe përcaktonin më tej marrëdhëniet e Shqipërisë me BE-në. Kështu, nga nënshkrimi i MTBE-së deri në nënshkrimin e MSA-së, Shqipëria ishte pjesë e një politike aktive të BE-së në lidhje me bashkëpunimin ekonomik. Fillimisht BE-ja ndërmori Përqasjen Rajonale (Regional Approach) për të forcuar marrëdhëniet dypalëshe me vendet e rajonit, hap ky që u ndoq nga Regjimi Autonom Preferencial me BE-në (ATP) si dhe nga një shtim i mallrave shqiptare pa doganë në tregjet europiane. Gjithashtu, me prezantimin e PSA-së në vitin 1999 marrëdhëniet tregtare të Shqipërisë me BE-në u intensifikuan. Për më tepër, në vitin 2004 u prezantua Partneriteti European për Shqipërinë, i cili u rinovua në vitet 2006 dhe 2008. Në këto kushte, Komisioni European paraqiste një listë prioritetesh afatshkurta dhe afatmesme për përgatitjet e Shqipërisë për anëtarësim.

Përkrah dinamikës së marrëdhënieve dypalëshe BE-Shqipëri, Shqipëria ishte palë në marrëveshjet rajonale, që, siç dhe u theksua më lart, përbënin një shtyllë po aq të rëndësishme sa dhe marrëdhëniet dypalëshe për perspektivën e antarësimit të secilit vend. Ky dimension u theksua sidomos me fillimin e PSA-së. Kështu, fillimisht bashkëpunimi rajonal u zhvillua përmes marrëveshjeve dypalëshe të tregtisë së lirë (FTA), ku Shqipëria nënshkroi marrëveshjen e parë me Maqedoninë në vitin 2002, e pasuar nga marrëveshjet me Kosovën dhe Kroacinë në vitin 2003 dhe një vit më vonë pasuan marrëveshjet me Serbinë dhe Malin e Zi, si dhe me Bosnjen dhe Hercegovinën. Edhe pse të rëndësishme, këto marrëveshje dypalëshe dhe Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë që u parapriu nuk ishin të mjaftueshme për të krijuar një zonë të lirë tregtie për rajonin (Pere, 2008: 170). BE-ja e adresoi këtë mangësi duke vendosur t'i përfshinte vendet e Ballkanit Perëndimor në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Europës Qëndrore (CEFTA). Si rrjedhojë, Shqipëria së bashku me vendet e tjera të rajonit përfshirë edhe Moldavinë u bë pjesë e CEFTA-s në vitin 2006. Duke iu referuar këtyre zhvillimeve Vurmo (2008: 29) argumenton se “operatorëve ekonomikë shqiptarë do tu duhet tashmë të kenë një qasje më të qëndrueshme në mënyrë që të përfitojnë nga tregjet fqinje dhe njëkohësisht të përballen me presionin e ekonomive rajonale si dhe atë të Bashkimit European”. Përpos marrëveshjeve të mësipërme, Shqipëria nënshkroi në 2009-ën një Marrëveshje të Tregtisë së Lirë edhe me vendet e EFTA-s duke zgjeruar kështu zonën e tregtisë së lirë në të cilën vendi bënte pjesë.

³ Asistenca nën IPA për Shqipërinë erdhi në rritje që nga viti 2007, duke kaluar shifrën e 98 milion eurove në vitin 2013 (COM (2009) 543, MIFF 2011- 2013).

Pavarësisht nënshkrimit të MSA-së më 12 qershor 2006, hyrja në fuqi e marrëveshjes do të realizohej tri vite më vonë. Ndërkohë që për MSA-në do të flitet në mënyrë të detajuar në nënkapitullin pasardhës, këtu vlen të përmendet rëndësia themelore e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje për formalizimin dhe strukturimin e marrëdhënieve BE-Shqipëri. Nga nënshkrimi i MSA-së deri në hyrjen e saj në fuqi, një tjetër marrëveshje do të rregullonte marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe BE-së: “Marrëveshja e Përkohshme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar” (Interim Agreement, 8154/06). Ky dokument zëvendësoi TCA-në fillestare dhe detajoi më tej marrëdhëniet e BE-së me Shqipërinë, sidomos ato ekonomike. Marrëveshja e Përkohshme vendosi baza të qëndrueshme të reciprocitetit në lidhje me detyrimet dhe të drejtat në fushën e tregtisë. Kështu, marrëveshja specifikonte që “Komuniteti dhe Shqipëria duhet të vendosin gradualisht një zonë të tregtisë së lirë për një periudhë maksimumi dhjetë vjeçare, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje” (Interim Agreement, Neni 3). Një seri përfitimesh ishin listuar, si ulja e tarifave doganore në zero për produktet industriale dhe disa produkte të përpunuara bujqësore shqiptare, ndërkohë që për produkte të tjera do të kishte një ulje graduale (Interim Agreement, Aneksi I).

3.1.2 Marrëveshja e Stabilizim Asocimit

Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA)⁴, e nënshkruar në qershor 2006, hyri në fuqi me 1 prill 2009. Hyrja në fuqi e kësaj marrëveshje ndryshoi natyrën e marrëdhënies kontraktuale midis Shqipërisë dhe BE-së, ndërkohë që hapi perspektivën e antarësimit (Vurmo, 2008: 22). MSA-ja rikonfirmon të ashtuquajturat kritere të Kopenhagenit dhe mbështetet mbi disa parime bazë, duke filluar nga respekti për parimet demokratike, të drejtat e njeriut, ligjin ndërkombëtar, shtetin ligjor si dhe respektin për parimet e ekonomisë së tregut (MSA, Neni 2). Gjithashtu, parime kryesore të marrëveshjes përbëjnë edhe përpjekjet për paqe e stabilitet në rajon bashkë me marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë (Neni 3), si dhe bashkëpunim të thelluar rajonal në aspektin ekonomik, sidomos tregtisë së lirë (Neni 4). Sipas Artikullit 6 asocimi i vendit me BE-në duhet të realizohet përgjatë një periudhe tranzitore me një kohëzgjatje maksimale prej dhjetë vjetësh.

Shtyllat kryesore të MSA-së janë: dialogu politik; bashkëpunimi rajonal; lëvizja e lirë e mallrave, njerëzve, punës dhe kapitalit; përafrimi i legjislacionit; çështjet e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë; politikat e bashkëpunimit; bashkëpunimi financiar; si dhe institucionet. Marrëveshja parashtron kritere politike dhe ekonomike të nevojshme për antarësim si dhe përcakton të drejtat e Shqipërisë si palë në marrëveshje. Kështu, MSA-ja do të kishte tri kontribute kryesore për vendet e rajonit: “afrimin e vendeve të rajonit më afër standarteve europiane; fokusimi i vëmendjes tek respektimi i parimeve demokratike kryesore (të drejtat e njeriut dhe minoriteteve, institucione demokratike të qëndrueshme, etj.); dhe përfshin elementet kryesore që janë në qendër të tregut të përbashkët të BE-së (konkurrenca dhe ndihma shtetërore, të drejtat e pronësisë intelektuale, etj.)” (Hoffmann, 2005: 59). Në kuadër të krijimit të një zone të tregtisë së lirë midis BE-së dhe vendeve të Ballkanit, një prej përfitimeve kryesore ishte heqja e tarifave doganore për shumicën e mallrave të rajonit, përfshirë ato shqiptare, si dhe shtimi i bashkëpunimit midis vendeve të rajonit.

Për më tepër, me hyrjen në fuqi të MSA-së Shqipëria duhet të angazhohet në ngritjen e një serie strukturash institucionale të përbashkëta Shqipëri-BE. Një fazë paraprake e këtyre strukturave ishte dhe Komiteti i Përbashkët, i krijuar me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Përkohshme (Interim

⁴ Shih Aneks VI për përmbledhjen e marrëveshjeve tregtare Shqipëri-BE

Agreement), i cili u takua tri herë gjatë periudhës 2006-2008 (COM (2010) 680). Strukturat kryesore të ngritura me MSA-në janë Këshilli i Stabilizim Asocimit, Komiteti i Stabilizim Asocimit dhe shtatë nën-komitetet respektive. Komiteti dhe nën-komitetet do të merren me zbatimin e MSA-së ndërkohë që Këshilli monitoron zbatueshmërinë. Krijimi i Ministrisë së Integritimit Europian si një strukturë e re, puna e së cilës kishte një karakter ndër-ministerial në aspektin funksional, si dhe kishte si mision drejtimin teknik dhe bashkërendimin e politikave në lidhje me anëtarësimin, tregon për dimensionin e ri institucional që po merrte procesi i integritimit në Shqipëri.

3.1.3 MSA dhe Kriteret e Kopenhagenit

Edhe përpara nënshkrimit të MSA-së, marrëdhëniet ekonomike dhe përpjekjet për krijimin e një zone të tregtisë së lirë me BE-në dhe rajonin u zhvilluan në mënyrë intensive, ndërkohë që dimensionin institucional e veçanërisht përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis e BE* avancoi me ritme më të ngadalta. Sipas Vurmos (2008), në dekadën e parë të zhvillimit të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe BE-së përafrimi i legjislacionit ishte një kusht më pak i artikuluar e si rrjedhojë zbatueshmëria e tij ishte në plan të dytë. Një qasje më e strukturuar institucionale në drejtim të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* erdhi me miratimin në vitin 1998 të Strategjisë për Integritimin Europian dhe Euro-Atlantik (SIEE). Megjithatë, Shqipëria ndërmoi hapa seriozë në këtë drejtim vetëm në kuadrin e PSA-së dhe kornizës së re që ky proces i dha përgatitjes së vendit për anëtarësim. Sidomos nënshkrimi i MSA-së do ta vitalizonte procesin e përafrimit të legjislacionit në saj të kushteve specifike që detajonte marrëveshja. Kështu, MSA-ja në Titullin 4, Neni 70, pas njohjes në parim të rëndësisë së përafrimit të legjislacionit, shprehet se “Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e BE-së, duke siguruar më tej zbatimin korrekt dhe shtrirjen në të gjithë komponentët e marrëveshjes (Pika 1 dhe 2).

Duke u nisur nga PSA-ja e sidomos pas nënshkrimit të MSA-së, një seri planesh dhe strategjish detajuan programin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis*. Përpjekje serioze në këtë drejtim pati në vitin 2007 me miratimin e Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit (PKPL) e sidomos me miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) 2007-2012. Këto plane u pasuan nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim 2007-2013 (SKZI) e miratuar nga Këshilli i Ministrave në mars 2008, strategji e cila detajon më tej objektivat e përafrimit të legjislacionit duke vendosur pritshmëri konkrete në terma kohorë. Kjo strategji përcaktonte konkretisht pritshmëritë për realizimin e përafrimit të legjislacionit në dy faza 5-vjeçare. Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) 2012-2015 është pjesë e fazës së dytë të këtij përafrimi ku theksohet se ky plan:

ka si pikësypnim final prioritizimin, planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e përafrimit të plotë të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian si një kusht thelbësor për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian (PKZMSA, 2012-2015).⁵

⁵ Pavarësisht përqëndrimit të analizës së mësipërme tek përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së për shkak të vetë rëndësisë së kushtëzimit të BE-së, në këtë fushë nga njëra anë dhe mangësive të më hershme të legjislacionit shqiptar në anën tjetër; strategjitë dhe planet e lartpërmendura janë hapa të rëndësishëm në përpjekjet e Shqipërisë për të përbushur kriteret e anëtarësimit në shumë nivele. Kështu, Planet Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2007-2012 dhe 2012-2015 adresojnë të gjithë komponentët e MSA-së. Për më tepër, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe

Ndërkohë që në aspektin ekonomik dhe në përafrimin e legjislacionit kurba e progresit të Shqipërisë drejt BE-së ka pasur një trend relativisht në rritje pavarësisht intensitetit, përmbushja e kriterëve politike, sidomos të atyre që lidhen me nivelin e demokracisë në vend si dhe shtetin ligjor, kanë shfaqur lëkundje të vazhdueshme në varësi të atmosferës politike në vend. Kështu, ‘krizat parlamentare’ apo ‘krizat e zgjedhjes së presidentit’ në momente të ndryshme janë cituar vazhdimisht për efektet negative mbi demokracinë në Shqipëri (Progres Raportet, 2006; 2007; 2010; 2011). Gjithashtu, sistemi i drejtësisë, korrupsioni dhe krimi i organizuar raportohen në mënyrë të vazhdueshme si formëzueset e një *status quo*-je problematike. Një hap në këtë drejtim ishte miratimi në korrik 2013 i Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013-2020 dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016. Krahësuar me kriteret e tjera bazë të Kopenhagenit: tregtisë së lirë dhe përafrimit të legjislacionit; demokracia, sundimi i ligjit dhe kriteret politike në përgjithësi kanë qënë aspektet më problematike të përmbushjes së kriterëve të anëtarësimit të Shqipërisë (shiko Stern & Wohlfeld, 2012), fakt ky që konfirmohet edhe nga progres raportet e Komisionit Europian, të cilat kanë raportuar mungesë progresi në këtë fushë dhe në shumë raste edhe regres.

3.1.4 *Plotësimi i pyetësorit dhe heqja e regjimit të vizave*

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi e MSA-së si dhe përqasja e strukturuar institucionale e krijuar në funksion të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, bënë që Shqipëria të avanconte me hapa të tjerë në integritet europian. Pas dorëzimit të aplikimit për anëtarësim të Shqipërisë në BE në prill 2009 mbërrin në Tiranë Pyetëtori i Komisionit Europian. Pyetëtori i plotësuar u dorëzua në Bruksel në prill të vitit pasardhës. Ndërkohë, në qershor 2010 përfundoi edhe dorëzimi i pyetjeve shtesë të Komisionit Europian.

Ndërkohë, paralelisht u punua për heqjen e regjimit të vizave për Shqipërinë. Nga viti 2008 ekzistonte një marrëveshje me zonën Shengen për lehtësimin e procedurave të lëshimit të vizave. Pavarësisht se Parlamenti Europian miratoi raportin e eurodeputetes Tania Fajon mbi heqjen e vizave për vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria bashkë me Bosnje-Hercegovinën arritën të përjashtoheshin nga regjimi i vizave vetëm në dhjetor 2010. Kjo u realizua pas përmbushjes së pikave të nevojshme të roadmap-it të paraqitur nga BE-ja e sidomos pas kalimit të ligjit mbi anti-diskriminimin në shkurt 2010⁶ si dhe miratimit të disa masave për mbrojtjen e popullsisë rome, mungesa e të cilave ishte raportuar nga BE-ja si objektiva të pa përmbushura në verë të 2009-ës (Kacarska, 2012: 14).

3.1.5 *Statusi i vendit kandidat, fillimi i negociatave për anëtarësim dhe anëtarësimi në BE*

Shqipëria paraqiti zyrtarisht kërkesën për anëtarësim në BE më 28 prill 2009, pak javë pas hyrjes në fuqi të MSA-së. Këshilli i BE-së kërkoi opinionin e Komisionit Europian (KE) në nëntor të po të njëjtë vit. Opinioni i KE-së në dy vitet në vazhdim do të specifikonte si fushë problematike përmbushjen e kriterëve politike nga Shqipëria dhe vit pas viti do të kërkonte përpjekje të shtuara

Integrim 2007-2013 (SKZHI) përveç se adresonte disa nivele të MSA-së, e bënte integrimin për herë të parë pjesë të një kuadri më të gjërë zhvillimi (Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013).

⁶ Ligjit nr. 10221, datë. 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

në këtë drejtim. Kështu, në opinionin e vitit 2010, KE vë theksin mbi dymbëdhjetë pika kryesore të lidhura me kriterin politik që Shqipëria duhej të përmbushte përpara se KE të mund të propozonte dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë. Këto pika lidheshin me: funksionimin e rregullt të parlamentit dhe dialogut politik; miratimin e ligjeve të lëna pezull si pasojë e ngërçit parlamentar; emërimin e Avokatit të Popullit; përshtatjen e kuadrit legjislativ me sugjerimet e OSBE-ODIHR; zgjedhjet me standarte europiane; reformën në administratën publike; sundimin e ligjit dhe pavarësia e gjyqësorit; zbatimin e strategjisë anti-korrupsion; përf forcimin e luftës kundër krimit të organizuar; përgatitjen dhe zbatimin e një strategjie kombëtare për të drejtën e pronës; hapa të mëtijshëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sidomos të grave, fëmijëve dhe romëve; si dhe masa të reja kundër keqtrajtimit në paraburgim dhe burgje (COM (2010) 680). Për të adresuar këto prioritetë, në qershor 2011, Qeveria Shqiptare miratoi një Plan Veprimi⁷, efektshmëria e të cilit në përmbushjen e prioritetëve ishte e pjesshme (Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, 2011).

Ndërkohë që parlamenti shqiptar nuk funksionoi normalisht në periudhën e pas zgjedhjeve të 2009-ës, gjë që ndikoi në miratimin e reformave, Raport Progresi i 2011-ës raportoi ngërçin politik si dhe vlerësoi që progresi në përmbushjen e 12 prioritetëve ishte i kufizuar (SEC (2011) 1205 final). Për pasojë, as këtë vit Komisioni European nuk vlerësoi që Shqipëria ishte gati për marrjen e statusit të vendit kandidat. Ky vlerësim do të vinte me Raport Progresin e vitit 2012, ku KE raportonte se Shqipëria kishte përmbushur katër prioritetë: funksionim të parlamentit dhe dialog politik; miratimin e reformave; emërimin e Avokatit të Popullit; si dhe miratimin e reformës zgjedhore. Për më tepër, progres i konsiderueshëm raportohej në dy fusha: reforma e administratës publike dhe trajtimet në paraburgim dhe burgim. Progres i pjesshëm raportohej në fusha të tjera (SWD (2012) 334 final; COM (2012) 600 final). Kështu, KE propozoi dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë me kusht plotësimin e kriterëve të mbetura, duke vënë theksin tek parlamenti dhe administrata publike. Gjithashtu, KE propozoi hapjen e negociatave për anëtarësim, sërisht në varësi të kushteve, ndërkohë që theksoi rëndësinë e veçantë të suksesit të zgjedhjeve të vitit 2013 si provë për Shqipërinë (European Union Delegation to the United States of America, 2013). Këshilli i BE-së vlerësoi progresin e Shqipërisë duke theksuar nevojën e vazhdimin të përmbushjes së kriterëve (Council of the European Union, 2012).

Në vitin 2013, pritshmëritë dhe sfidat ishin të shumta. Në njërën anë, zgjedhjet e qershorit ishin përcaktuar tashmë si një provë e rëndësishme. Kjo u theksua vazhdimisht edhe nga vizitat e rëndësishme në Tiranë të Komisionerit Füle në shkurt dhe pastaj sërisht në mars të 2013-ës. Vizitat e tij u pasuan në prill nga ardhja në Tiranë e Përfaqësueses së Lartë të BE-së, Catherine Ashton e cila gjithashtu theksoi momentin delikat në të cilin ishte Shqipëria (Council of the European Union, 2012: Aneksi 5 dhe 6). Nga ana tjetër, mosmarrja e statusit të vendit kandidat në fund të 2012-ës rriti pritshmëritë për një vendim pozitiv në mbledhjen e ardhshme të Këshillit të BE-së në fund të 2013-ës.

Pavarësisht pritshmërive nisur edhe nga vlerësimet pozitive për zgjedhjet e qershorit si dhe rekomandimet e Komisionit European për dhënien e statusit të vendit kandidat, Këshilli i BE-së vendosi për shtyrjen e vendimit për në qershor 2014 (Council of the European Union, 2013: PRESSE 586), i cili rezultoi pozitiv. Progresi raporti i Komisionit European për vitin 2013

⁷ Plani i Veprimit për Plotësimin e 12 Rekomandimeve të Opinionit të Komisionit European për Shqipërinë (qershor 2011).

vlerësonte përmbushjen me sukses të shumicës së kriterëve të paraqitura në opinionin e vitit 2010, duke rekomanduar që Shqipërisë t'i jepej statusi i vendit kandidat sërish në varësi të progresit në fushat e mbetura. Kështu, KE vlerësonte se hapja e negociatave me Shqipërinë duhej kushtëzuar sërish në bazë të përmbushjes së pesë kushteve: vazhdimi i reformës së administratës publike; përpjekje më intensive për të garantuar pavarësinë e gjyqësorit; hapa të tjerë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; si dhe përpjekje për të garantuar të drejtat e njeriut, sidomos ato të popullsisë rome, dhe zgjerimin e politikave anti-diskriminuese (COM (2013) 700 final).

3.2 Dimensioni ekonomik i procesit të integritimit në Bashkimin Europian

3.2.1 Marrëveshjet e liberalizimit preferencial të njëanshëm: MSA (SAA) dhe statusi GSP (General System of Preferences)

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian u nënshkrua në qershor të vitit 2006 dhe hyri në fuqi në 1 prill të vitit 2009. Marrëveshja e Përkohshme, pjesë e MSA-së, parashikonte krijimin e një zone të lirë tregtare mes Shqipërisë dhe BE-së. Liberalizimi i plotë nga Shqipëria përfundoi në vitin 2011 ndërkohë që Bashkimi Europian, përveç disa produkteve bujqësore, i kishte liberalizuar krejtësisht barrierat tarifore me nënshkrimin e MSA-së në vitin 2006. Reduktimi i mëtejshëm nga ana e BE-së ndodhi në vitin 2006, kur u ulën në zero të gjitha barrierat tarifore për produktet industriale si kundër edhe për ato bujqësore që nuk ishin në mbrojtje.

Kështu, pas MSA-së mallrat e prodhuara në Shqipëri mund të futen në tregun e BE-së pa paguar doganë dhe pa u kufizuar në sasi. Në këtë mënyrë, një tregtar, shqiptar apo i huaj, mund të fusë në tregun europian aq mallra të prodhuara në Shqipëri sa ka mundësi të shesë në tregun europian dhe nuk duhet të paguajë doganë për to, me përjashtim të disa produkteve si disa lloje peshku e pijesh alkoolike. Duhet theksuar se, që mallrat shqiptare të mund të përfitojnë nga hapja e tregut europian duhet të respektojnë rregullat e origjinës – d.m.th. të vërtetohet se janë prodhuar ose përpunuar në Shqipëri mbi një masë të caktuar. Pra, me anë të MSA-së, Bashkimi Europian ka me Shqipërinë këtë marrëdhënie tregtare preferenciale vetëm për mallrat me origjinë shqiptare dhe jo edhe për ato që vijnë nga vende të treta.

Gjithashtu, nëse produktet shqiptare nuk respektojnë standardet e prodhimit dhe të tregtimit dhe nuk certifikohen sipas normave europiane, nuk do të mund të tregtohen as në tregun shqiptar, as në atë europian. E njëjta gjë ndodh edhe me tregtinë brenda vendeve anëtare të Bashkimit Europian – në qoftë se një mall i prodhuar në një vend anëtar nuk respekton normat europiane, kur ka të tilla, atëherë ai mall nuk përfiton nga tregtia e lirë. Për ta ndihmuar ekonominë shqiptare që të arrijë standardet europiane, BE-ja i trajton në mënyrë të privilegjuar mallrat shqiptare dhe ky privilegj do të vazhdojë gjatë një periudhe dhjetë vjeçare. Pas kësaj periudhe, mallrat shqiptare dhe ato europiane do të trajtohen njësoj në tregtinë ndërmjet palëve (BE –Shqipëri). Shqipëria, për të mbrojtur sektorë të veçantë të ekonomisë kombëtare, mund t'i mbrojë disa produkte – të quajtura “të ndjeshme” – duke mbajtur në fuqi kufizime ose doganë ndaj produkteve të ngjashme që vijnë nga BE-ja. Përfundimisht, që ekonomia shqiptare të mund të mbijetojë në kushtet e krijimit të këtij tregu të lirë me BE-në duhet të bëhet më konkurruese dhe duhet t'u përshtatet jo vetëm nevojave dhe shijeve të konsumatorit shqiptar, por edhe të atij rajonal dhe europian.

3.2.2 Modeli teorik për efektet e marrëveshjes së liberalizimit preferencial të njëanshëm

Marrëveshjet liberalizuese preferenciale të tregtisë, të tilla si marrëveshjet e llojit MSA, bashkimet doganore dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë, sjellin uljen e çmimeve dhe rritjen e sasisë së importeve të vendeve të përfshira, por sjellin edhe efektet diskriminuese të kërcimit të ofertës, dmth. rritjen e importeve me origjinë nga vendet që përfitojnë nga liberalizimi në dëm të vendeve të diskriminuara (Baldwin and Wyplosz, 2012).

Një numër i madh studimesh të kohëve të fundit në fushën ekonomike kanë shqyrtuar efektet e *shtimit*⁸ dhe *spostimit*⁹ të tregtisë që vijnë nga marrëveshjet tregtare preferenciale (PTA). Një përmbledhje e evidencës (Freund and Ornelas, 2010) tregon se pjesa më e madhe e studimeve gjejnë efekte të rëndësishëm të shtimit të tregtisë, por evidenca e spostimit të tregtisë është e dobët ose nuk egziston për pjesën më të madhe të PTA-ve. Magee (2008) përdor të dhënat nga fundi i shekullit të kaluar për vlerësimin e efekteve të shtimit dhe spostimit të tregtisë të 15 marrëveshjeve të llojit PTA, duke përfshirë NAFTA-n, zgjerimin e BE-së në vitin 1986, dhe PTA-të bilaterale midis BE-së dhe disa vendeve të Europës qendrore. Nga tetë PTA-të që u vlerësuan se ishin karakterizuar nga efekte pozitive në shtimin e tregtisë, vetëm dy ishin shoqëruar edhe nga spostimi i tregtisë. Ato dy ishin zgjerimi i BE-së i vitit 1986, dhe PTA-të bilaterale midis BE-së dhe disa vendeve të Europës qendrore në fillim të viteve 1990.

Një studim i fundit, që përdor të dhëna të shekullit të 21-të, vlerëson efektet e shtimit dhe spostimit të tregtisë të shumë marrëveshjeve të llojit PTA (Archarya et al., 2010). Vlerësimet e tyre tregojnë se pjesa më e madhe e PTA-ve duke përfshirë BE-në dhe EFTA-n kanë patur efekte pozitive në shtimin e tregtisë dhe efekte të kundërt (me të pritshmin) në spostimin e tregtisë, dmth. PTA-të rritën importet jo vetëm nga vendet partnerë por edhe nga vendet e papreferuara.

Baldwin & Wyplosz (2012), nxjerrin në pah efektet tregtare të bashkimit doganor të 6 vendeve themeluese të BE-së. Aty vihet re se ndërsa importet e brëndshme në EEC6 (6 vendet themeluese të BE-së) u rritën nga rreth 30% në vitin 1958 në rreth 45% në 1968, pjesa e importeve të EEC6 nga vendet e tjera u ul. Një pjesë e uljes i korrespondon importeve të ardhura nga vendet europiane jo-anëtare të EEC6 (Euro-6). Rënie më të theksuar pati pjesa e importeve të EEC6 të ardhura nga pjesa tjetër e botës, sidomos importet nga USA. Nga ana tjetër, Baldwin & Wyplosz (2012) konstatojnë se në vlerë absolute importet në EEC6 nga të gjitha burimet u rritën shumë gjatë kësaj periudhe. Pra kërcimi në ofertë (spostimi i tregtisë) duhet trajtuar si një gjë relative, dmth. sikur bashkimi doganor të mos formohej, importet në EEC6 nga vendet jo antare (të EEC6) do të ishin rritur edhe më shumë.

Integrimi europian do të kishte efekte në rritjen ekonomike të Shqipërisë në atë masë që ndikon akumulimin e kapitalit fizik, njerëzor dhe teknologjik. Teorikisht përcaktohen dy mekanizma, përmes të cilëve integrimi europian ndikon akumulimin e kapitalit: Së pari, në masën që integrimi europian e bën më eficientë ekonominë, dmth. i paraprin një efekti pozitiv shpërndarjeje të burimeve, sjell rritjen e prodhimit dhe kjo, më tej – duke supozuar një raport konstant investimesh kundrejt të ardhurave – çon në rritjen absolute të investimeve. Rezultati përfundimtar është një sasi

⁸ Rritet sasia e flukseve tregtare pas marrëveshjes

⁹ Rritet sasia e flukseve tregtare nga vendet e përfshira në marrëveshje në kurriz të vendeve të papërfshira (të diskriminuara)

më e madhe e kapitalit dhe e të ardhurave për frymë në ekuilibër. Së dyti, integrimi europian mund të sjellë edhe rritjen e raportit të investimeve kundrejt të ardhurave përmes uljes së rrezikut. Ashtu sikurse edhe në rastin më sipër, rezultati përfundimtar është një sasi më e madhe kapitali dhe të ardhurash për frymë.

Për vlerësimin e efekteve të integritit europian në investime dhe rritjen ekonomike, literatura është marrë sidomos me rastet e vendeve që i janë bashkuar BE-së gjatë rrugës në vite. Vende të tilla janë Portugalia, Spanja, vendet Balltike, Greqia, etj. Kështu, në Portugali (Baldwin and Seghezza, 1998) investimet në raport me PBB-në u rritën shumë dhe shpejt në përgjigje të perspektivës së anëtarësimit në BE. Edhe në Spanjë, pas anëtarësimit, investimet u rritën shumë duke mbështetur teorinë që lidh integrimin më të ngushtë me rritjen e investimeve dhe më tej me rritjen ekonomike.

3.2.3 *Vlerësim i efekteve në flukset tregtare të Shqipërisë 2006-2013*

Në këtë seksion bëhet një përpjekje për vlerësimin e efekteve tregtare të marrëveshjes MSA të Shqipërisë me BE-në, duke ndjekur në vija të trasha metodologjinë e studimit të përmendur në seksionin më lart. MSA e Shqipërisë me BE-në është marrëveshje preferenciale dhe teorikisht (shih më sipër) duhet të shohim efekte asimetrike në sasinë e eksporteve dhe importeve të mallrave. Kështu teoria na thotë se sasia e eksport-importeve shqiptare me BE-në duhet të rritet në përqindje të totalit. Për të vlerësuar këtë efekt analizojmë eksportet dhe importet e mallrave shqiptare në vlerë dhe në përqindje të totalit për periudhën 2006-2012.

Në këtë studim kemi zgjedhur si periudhë të analizës, atë që përmban në mes të saj datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes MSA. Më tej, të gjithë periudhën e kemi ndarë në dy nën-periudha të barabarta në kohë. Nën-periudha e parë, që supozojmë se i korrespondon *integritit më të ngadaltë*, fillon në Janar të vitit 2006 dhe përfundon në mes të vitit 2009; ndërsa nën-periudha e dytë, që supozojmë se i korrespondon *integritit më të shpejtë*, fillon në mes të vitit 2009 (kur hyri në fuqi MSA-ja) dhe përfundon në dhjetor 2012. Të dy nën-periudhat janë marrë me gjatësi të njëjtë për të bërë një krahasim të drejtë e me të njëjtën fuqi shpjeguese.

Në praktikë testimi i kësaj pike është i komplikuar, sepse duhen marrë parasysh procese apo ngjarje që ndodhin njëkohësisht me integrimin europian të Shqipërisë dhe që i ndikojnë (njëkohësisht me integrimin) flukset tregtare të Shqipërisë. Ndër këto procese e ngjarje përmendim recesionin e theksuar të partnerëve kryesorë tregtarë të Shqipërisë (Greqisë dhe Italisë) në kuadrin e krizës së eurozonës dhe asaj globale, ko incidencën e fillimit të efekteve të krizës me fillimin e zbatimit të plotë të marrëveshjes MSA Shqipëri – BE, integrimin rajonal të Shqipërisë në kuadrin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë, hapjen e vazhdueshme të ekonomisë shqiptare, etj.

Proceset e përmendura, po nuk u morën parasysh, mund ti ndikojnë në drejtimin e gabuar rezultatet e analizës. Kështu për shembull, po nuk u mor parasysh se kriza globale dhe ajo e eurozonës filloi të ndikojë ekonominë reale në vitin 2009, mundet që efektet e reduktimit të import eksporteve në periudhën 2009-2012 t'ja veshim gabimisht integritit të Shqipërisë me BE-në. Për më tepër, është e vërtetë që kriza i preku të gjitha vendet europiane, por recesioni i Italisë dhe Greqisë ishte mjaft më i thellë se në vendet e tjera. Një recesion i tillë do të ulte së tepërmi kërkesën për importe me

originë nga Shqipëria gjë që do të reflektohej gabimisht kundër efektit të pritur të shtimit të tregtisë së Shqipërisë me BE-në.

Për më tepër, kundër integritit me BE-në gabimisht “do të fliste” rritja e shkëmbimeve tregtare në kuadrin e marrëveshjeve liberalizuese preferenciale tregtare me vendet e rajonit apo me vendet e tjera të botës së paprekur ose të prekur pak nga kriza¹⁰. Rezultatet jepen në Tabelat 1 dhe 2 në vijim, si edhe illustrohen në Figurat 2/A deri 5/A të Aneksit.

Tabela 1: Shkëmbimet tregtare 2006-2013

Mesataret_milion_euro_me_bazë_vjetore				
Zona e origjinës/destinacionit	Importet 2006-2009	Importet 2009-2012	Eksportet 2006-2009	Eksportet 2009-2012
Z1_BE_joRajoni	488	687	44	150
Z2_Europë_joBE_joRajoni	295	220	3	28
Z3_BE_Rajoni_K	1274	1519	579	738
Z4_joBE_Rajoni	413	530	95	225
Z5_Row	422	569	33	112
Z6_BE_Rajoni_joK	109	128	6	20

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të autorëve

Në Tabelën 1 jepen *mesataret mujore (me bazë vjetore) në vlerë* të flukseve tregtare shqiptare të mallrave sipas dy nën-periudhave dhe sipas zonës destinacion për eksportet dhe asaj origjinë për importet. Nga Tabela shihet se, në nën-periudhën e dytë kundrejt të parës, me përjashtim të importeve nga Zona 2, ka rritje në vlerë të eksporteve dhe importeve shqiptare me të gjitha zonat e tjera. Pra, megjithëse fillimi i nën-periudhës së dytë koïncidon me fillimet e rënies ekonomike të shumicës së partnerëve tregtarë të Shqipërisë, përsëri ka rritje nominale në flukset eksportuese dhe importuese të vendit. Natyrisht për të matur efektet e integritit do të duhet të shprehim shifrat e Tabelës 1 në terma të përqindjes ndaj totalit të eksporteve dhe importeve. Kjo paraqitet në Tabelën 2 më poshtë.

¹⁰ 1. Zona e vendeve të BE-së që ndodhen gjeografikisht jashtë rajonit të Shqipërisë (emërtohet si *Z1_BE_joRajoni* në rezultatet e Tabelave 1 e 2 dhe në Grafikët 2 - 5 të Aneksit);

2. Zona e vendeve europiane jo të BE-së e që ndodhen gjeografikisht jashtë rajonit të Shqipërisë (emërtohet si *Z2_Europë_joBE_joRajoni* në rezultatet e Tabelave 1 e 2 dhe në Grafikët 2 - 5 të Aneksit);

3. Zona e vendeve të BE-së që ndodhen gjeografikisht në rajonin pranë Shqipërisë dhe që u prekën mjaft rëndë nga recesioni dhe nga kriza e eurozonës (emërtohet si *Z3_BE_Rajoni_K* në rezultatet e Tabelave 1 e 2 dhe në Grafikët 2 - 5 të Aneksit);

4. Zona e vendeve jo të BE-së që ndodhen gjeografikisht brenda rajonit të Shqipërisë (emërtohet si *Z4_joBE_Rajoni* në rezultatet e Tabelave 1 e 2 dhe në Grafikët 2 - 5 të Aneksit);

5. Zona e vendeve jo të BE-së që ndodhen gjeografikisht jashtë Europës (emërtohet si *Z5_Row* në rezultatet e Tabelave 1 e 2 dhe në Grafikët 2 - 5 të Aneksit) dhe

6. Zona e vendeve të BE-së që ndodhen gjeografikisht në rajonin pranë Shqipërisë dhe që nuk u prekën rëndshëm nga recesioni dhe nga kriza e eurozonës (emërtohet si *Z6_BE_Rajoni_joK* në rezultatet e Tabelave 1 e 2 dhe në Grafikët 2 - 5 të Aneksit).

Tabela 2: Shkëmbimet tregtare dhe efektet e integritimit

Mesataret_përqindje_të_totalit				
Zona e origjinës/destinacionit	Importet 2006-2009	Importet 2009-2012	Eksportet 2006-2009	Eksportet 2009-2012
Z1_BE_jeRajoni	16,3	18,8	5,6	11,5
Z2_Europe_jeBE_jeRajoni	9,9	6,0	0,4	2,0
Z3_BE_Rajoni_K	42,6	41,6	77,0	58,7
Z4_jeBE_Rajoni	13,6	14,5	12,2	17,2
Z5_Row	13,8	15,6	4,2	9,0
Z6_BE_Rajoni_jeK	3,8	3,6	0,7	1,6

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të autorëve

Nga Tabela 2 shihet se, në nën-periudhën e dytë kundrejt të parës, eksportet dhe importet e Shqipërisë me Zonën 1 të vendeve të BE-së të prekura më pak ose aspak nga kriza (**Z1_BE_jeRajoni**) janë rritur në përqindje të totalit respektivisht me 5.9% dhe 2.5%. Këto dominojnë rritjet respektive të flukseve të tregtisë së Shqipërisë me secilën nga zonat e tjera. Dy zonat më të afërta me të parën janë respektivisht në eksporte Zona 4 me 5% dhe Zona 5 me 4.8% dhe në importe Zona 5 me 1.8% dhe Zona 4 me 0.9%. Tërheq vëmendjen rënia drastike relative e eksporteve shqiptare (me 18.3% kundrejt totalit) drejt Zonës 3, që përfshin dy partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë (Itali dhe Greqi) që janë edhe më të prekurit nga kriza.

Figurat 2/A dhe 3/A të Aneksit ilustrojnë grafikisht Tabelat 2 dhe 1, kurse Figurat 4/A dhe 5/A ilustrojnë respektivisht trend-et e importeve dhe eksporteve shqiptare sipas zonave.

Në përfundim mund të themi se rezultatet e Tabelës 2 mbështesin efektet e *shtimit* të tregtisë së Shqipërisë me tre nga zonat (Zonat 1, 4 dhe 5) që nuk u prekën ose u prekën relativisht pak nga kriza globale dhe ajo e eurozonës. Mendimi ynë është se rritja në fjalë ka ardhur nga hapat integruar të Shqipërisë me BE-në (MSA) e me vendet e rajonit (në kuadrin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë), si edhe nga efektet e vazhdimit të hapjes së ekonomisë shqiptare. Megjithatë, nga ana sasiore, duket se mbështetet *shtimi relativisht më i lartë* i tregtisë së Shqipërisë me BE-në në nën-periudhën e integritimit më të lartë kundrejt asaj me integrim më të ulët.

Rezultati i mësipërm gjithësesi duhet marrë me rezervë të paktën për tre arsye në vijim: së pari, periudha e të dhënave të përdorura është relativisht e shkurtër; së dyti, nga ana statistikore rezultati i Zonës 1 nuk është i ndryshëm nga rezultatet e dy zonave të tjera të përafërta dhe së fundi, metoda e kontrollit për krizën është e përafërt.

Analiza më sipër do të pasurohej shumë nëse do të zbatohet edhe në nivel mikro, dmth. duke zbatuar të njëjtën metodologji për secilën kategori importesh dhe eksportesh. Kjo mund të jetë fushë e aktivitetit tonë në të ardhmen.

3.2.4 Vlerësim i efekteve në investimet e huaja direkte (IHD) 2006-2013

Në këtë seksion bëhet një përpjekje për vlerësimin e efekteve të integritimit europian në investimet e huaja direkte në Shqipëri. Teorikisht, anëtarësimi i ardhshëm në BE presupozon se Shqipëria duhet të ketë një rritje afatmesme relativisht më të lartë, sepse procesi i integritimit është argumentuar se

sjell rritjen e eficiencës së investimeve. Pra, teksa Shqipëria i afrohet BE-së, duhet të shohim rritje më të lartë të investimeve, qofshin ato të huaja apo vendase.

Por, ashtu sikurse edhe në seksionin më sipër, në këtë analizë duhet të marrim parasysh procese dhe ngjarje që e kanë ndikuar klimën e investimeve paralelisht me integrimin europian të Shqipërisë. Ndër to mund të përmendim, duke filluar nga viti 2004, privatizimet e ndërmarrjeve shtetërore si Banka e Kursimeve, Albtelekomi, ARMO, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, etj. Më pas, duke filluar nga viti 2009, përmendim hyrjen e Shqipërisë në NATO, krizën financiare globale, krizën e eurozonës, etj. Nëse privatizimet e rëndësishme shpërndahen gjatë gjithë periudhës 2006-2012 dhe prandaj mund të konsiderohen me ndikim minimal në rezultate, ndryshon puna me anëtarësimin në NATO që sigurisht ka ndikuar më shumë fluksin e investimeve të huaja direkte në Shqipëri nga viti 2009 e në vazhdim. Nga ana tjetër, pas vitit 2009, kriza globale dhe ajo e eurozonës, ashtu si edhe për vendet e tjera, duhet të ketë patur rol frenues në investimet drejt Shqipërisë.

Me këto në mendje, ne analizojmë fluksin e investimeve të huaja direkte në Shqipëri për dy nën-periudhat 2006-2009 dhe 2009-2012. Rezultatet jepen në Tabelën 3 dhe illustrohen në Figurën 6/A në Aneks.

Tabela 3: Flukset e investimeve të huaja direkte në Shqipëri në përqindje të PBB-së?

Periudha	Shqipëria	Serbia	Rumania	Bullgaria	BE	Maqedonia
2006-09	6.41	10.70	7.40	25.51	5.19	
2009-12	10.21	3.60	1.84	5.00	2.27	
2002-05						3.71
2005-08						6.04
2004-2006		9.83	8.27	16.14		
2007-2009		6.63	5.28	20.28		

Burimi i të dhënave: Banka Botërore dhe llogaritje të autorëve

Nga Tabela 3, vihet re qartë se në rastin e Shqipërisë ka një rritje të ndjeshme të nivelit të Investimeve të Huaja Direkte pas hyrjes në fuqi të MSA-së. Kështu, pavarësisht efekteve të krizës ekonomike, IHD-të u rritën në 10.21% e PBB-së pas vitit 2009. E njëjta gjë vihet re dhe në rastin e Maqedonisë ku IHD-të thuajse u dyshuan pas vitit 2005. Gjithësesi, me përjashtim të Shqipërisë, të gjitha vendet e rajonit përjetuan rënie të IHD-ve gjatë periudhës 2009-12.

A është rritja e IHD-ve në Shqipëri nga 6.41% e PBB-së (para MSA-së) në 10.21% (pas MSA-së) një shenjë se integrimi europian po fillon të nxisë investimet në Shqipëri? Ne mendojmë se po. Por, rezultati duhet marrë me rezervë ngaqë nuk duhet harruar se integrimi më i shpejtë i Shqipërisë në BE koinçidon me hyrjen e Shqipërisë në NATO, që duhet të ketë patur një efekt të padiskutueshëm pozitiv tek IHD-të në Shqipëri. Ashtu sikurse me rezultatet e seksionit paraardhës, edhe rezultatet e IHD-ve duhet të shërbejnë si një pikë e mirë nisjeje për hulumtime të mëtejshme në nivele më specifike.

3.2.5 Diskutim: Rritja ekonomike dhe efektet e integrit

Integrimi europian do të kishte efekte në rritjen ekonomike të Shqipërisë në atë masë që ndikon akumulimin e kapitalit fizik, njerëzor dhe teknologjik. Teorikisht përcaktohen dy mekanizma, përmes të cilëve integrimi europian ndikon akumulimin e kapitalit: Së pari, në masën që integrimi europian e bën më efikente ekonominë, dmth. i paraprin një efekti pozitiv shpërndarjeje të burimeve, sjell rritjen e prodhimit dhe kjo, më tej – duke supozuar një raport konstant investimesh kundrejt të ardhurave – çon në rritjen absolute të investimeve. Rezultati përfundimtar është një sasi më e madhe e kapitalit dhe e të ardhurave për frymë në ekuilibër. Së dyti, integrimi europian mund të sjellë edhe rritjen e raportit të investimeve kundrejt të ardhurave përmes uljes së rrezikut. Ashtu sikurse edhe në rastin më sipër, rezultati përfundimtar është një sasi më e madhe kapitali dhe të ardhurash për frymë.

Për vlerësimin e efekteve të integrimit europian në investime dhe rritjen ekonomike, literatura është marrë sidomos me rastet e vendeve që i janë bashkuar BE-së gjatë rrugës. Vende të tilla janë Portugalia, Spanja, vendet Balltike, Greqia, etj. Kështu, në Portugali (Baldwin dhe Seghezza, 1998) investimet në raport me PBB-në u rritën shumë dhe shpejt në periudhën para anëtarësimit në BE. Edhe në Spanjë, pas anëtarësimit, investimet u rritën shumë duke mbështetur teorinë që lidh integrimin më të ngushtë me rritjen e investimeve dhe më tej me rritjen ekonomike.

A e ka ndikuar procesi i integrimit europian rritjen ekonomike të Shqipërisë? Është e vështirë për tu përgjigjur. Kjo pyetje është e vështirë edhe për vetë vendet anëtare të BE-së. Teorikisht nuk ka dyshime se integrimi europian sjell, deri në terma afatmesme, një rritje më të lartë ekonomike për vendet që anëtarësohen në BE. Por, në fushën empirike rezultatet nuk janë aq bindëse. Gjithësesi, në përputhje me hipotezën e ngritur në këtë studim, ne nuk mendojmë se faza e tanishme, relativisht e hershme, e procesit të integrimit Shqipëri – BE ka lënë gjurmë në rritjen ekonomike të Shqipërisë apo në zhvillimet e tregjeve të saj financiare. Këto mbeten drejtime për tu eksploruar në të ardhmen teksa Shqipëria të avancojë në fazën e integrimit europian.

3.2.6 Përfundime dhe pista studimesh të mëtejshme në fushën e integrimit Shqipëri – BE

Në këtë studim bëhet një vlerësim sasior dhe cilësor i efekteve të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian. Ashtu sikurse sugjerohet në literaturë dhe pasi kontrollojmë për një sërë efektesh që nuk kanë të bëjnë me procesin e integrimit të Shqipërisë me Bashkimin Europian, vihet re se flukset tregtare të Shqipërisë me vendeve të BE- së të prekura më pak ose aspak nga kriza janë rritur në përqindje të totalit. Ajo që duket më e rëndësishme është se kjo rritje dominon rritjet respektive të flukseve të tregtisë së Shqipërisë me secilën nga zonat e tjera të botës.

Ne vemë gjithashtu re se në rastin e Shqipërisë gjatë periudhës së pas hyrjes në fuqi të MSA-së (2009-2012) ka një rritje të ndjeshme të IHD-ve, ndonëse periudha në fjalë koinçidon me ashpërsimin e krizës së borxheve sovraane në eurozonë, që është zona e origjinës së një pjese të konsiderueshme të IHD-ve për në Shqipëri. Por, rezultatet e mësipërme të flukseve tregtare Shqipëri – BE, ndonëse të qarta dhe interesante, duhet marrë me rezervë të paktën për tre arsye: së pari, periudha e të dhënave të përdorura është relativisht e shkurtër; së dyti, rritja e flukseve tregtare Shqipëri – BE, ndonëse më e larta, nuk është *statistikisht* e ndryshme nga rritja e flukseve me dy zonat e tjera më të afërta dhe së treti, metoda e kontrollit për krizën është e përafërt. Gjithashtu, evidenca e IHD-ve duhet marrë me rezervë, sepse periudha 2009-2012 koinçidon edhe

me futjen e Shqipërisë në NATO gjë që me të drejtë mendohet se ka ndikuar pozitivisht në rritjen e sigurisë dhe për pasojë edhe të IHD-ve në Shqipëri.

Në mendojmë se analiza e flukseve tregtare do të pasurohej shumë nëse do të zbatoheshin edhe në nivel mikro, dmth. duke zbatuar të njëjtën metodologji për secilën kategori importesh dhe eksportesh. Në gjithashtu mendojmë se efektet potenciale të integrimit evropian në rritjen ekonomike dhe në fushën e integrimit financiar do të materializohen më tej teksa Shqipëria ti afrohet anëtarësimit të plotë në BE. Studime të mëtejshme është mirë të fokusohen në këto drejtime.

3.3 Efektet e procesit të integrimit në fushën e konkurrencës

Ligji themelor në fushën e konkurrencës është ligji 9121 i vitit 2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i njohur si Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, i cili do të bënte diferencën sidomos në hapat e parë të përafrimit të legjislacionit shqiptar në këtë fushë me *acquis e BE-së*. Ky ligj kishte dispozita më specifike mbi mbrojtjen dhe garantimin e konkurrencës. Gjithashtu, ligji krijoi një organ të ri “publik, të pavarur në kryerjen e detyrave” (Neni 18),¹¹ që ishte Autoriteti i Konkurrencës. Krijimi i kësaj strukture ishte përgjigje direkte e dispozitave të MSA-së mbi konkurrencën dhe çështjet e lidhura me konkurrencën (Pikat 3 dhe 4, Neni 71). Në mënyrë që përafrimi me legjislacionin e BE-së të vazhdonte, Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës u amendua tri herë.¹² Ndërkohë, ligje të tjera u miratuan mbi ndihmën shtetërore dhe privatizimin e sektorëve strategjikë në mënyrë që këta sektorë të rregulloheshin nga ana përmbajtësore si dhe të uleshin shpenzimet, të kufizoheshin të drejtat e veçanta dhe të redukttoheshin monopolet në Shqipëri.

Të drejtat ekskluzive, apo të veçanta në Shqipëri akordohen për sektorë specifik si transporti, furnizimi me ujë, shërbimi postar, sektori i hidrokarbureve, menaxhimi i mbetjeve të ngurta, në fushën e të drejtave të autorit, si dhe në sektorin e energjisë. Sipas përgjigjeve të Shqipërisë në Pyetësin e BE-së¹³ të drejta speciale në sektorin e transporteve u janë dhënë kompanive si Hekurudha Shqiptare, SGS Automotive Albania Company si dhe Partnerët e Aeroportit të Tiranës. Në shërbimin postar, të drejta të veçanta ka Posta Shqiptare. Në sektorin e hidrokarbureve ka disa kompani që operojnë në kërkimin e burimeve të reja në territorin shqiptar, ndërkohë që mbi të drejtat e autorit, Ministria e Kulturës ka liçensuar katër Agjensi të Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Autorit.

Sektori i energjisë në Shqipëri, përveç të drejtave të veçanta, përfaqëson edhe monopolin e fundit në vend. Në këtë sektor, të drejta të veçanta në lidhje me transmetimin i janë akorduar Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), një njësi kjo shtetërore e miratuar me VKM në vitin 2003. Ndërkohë, të drejtat e veçanta për shpërndarjen e energjisë i janë dhënë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Në sektorin e elektricitetit në Shqipëri, i vetmi monopol shtetëror është OST. Edhe pse tregu është i liberalizuar në sektorin e prodhimit të energjisë, “struktura e tregut

¹¹ Ligji No. 9121 i 28 Korrik 2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
http://www.wipo.int/wipolex/en/text.jsp?file_id=239344.

¹² Amendimet: në prill 2006, Ligji nr. 9499 “Për disa ndryshime në ligjin numër 9121, të datës 28 korrik 2003”; në korrik 2006, Ligji 9584 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”; si dhe në shtator 2010, Ligji 10317.

¹³ Këshilli i Ministrave, Republika e Shqipërisë (2010). Përgjigjet e Shqipërisë ndaj Pyetësit të BE-së. Fq 809-812.

tregon se 99% e prodhimit të brendshëm të energjisë elektrike është në pronësi të KESH e cila është një kompani me 100% kapital shtetëror”.¹⁴

Në vazhdim të masave për përafrimin e legjislacionit dhe limitimin e të drejtave ekskluzive dhe monolopeve në favor të konkurrencës, Shqipëria është angazhuar tashmë për më shumë se një dekadë në procesin e privatizimit të sektorëve strategjikë sipas Ligjit 8306, të vitit 1998 “Për privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë”. Sipas këtij ligji, energjia përcaktohet si sektor strategjik bashkë me minierat, industrinë e gazit dhe naftës, postën, telekomunikacionin, pyjet dhe rezervat ujore, rrugët dhe hekurudhat, portet dhe aeroportet, transportin ajror dhe hekurudhor, bankat, etj (Neni 4). Ndërkohë që energjia është akoma në process privatizimi, sektorë si sigurimet (INSIG) dhe telekomunikacioni (Albtelecom) i janë nënshtruar tashmë një procesi privatizimi.

Ndërkohë që përafrimi i legjislacionit në fushën e konkurrencës dhe zbatimi i tij në Shqipëri ka hasur në vështirësitë përkatëse, rregullimi i konkurrencës në Shqipëri, përbën një hap të rëndësishëm në përcaktimin e ndërveprimit të tregut. Kontrolli i monopoleve, i të drejtave ekskluzive si dhe rregullimi i ndihmës shtetërore kanë qënë hapa të domosdoshëm. Për më tepër, rregullimi i aktivitetit dhe përcaktimi i të drejtave ekskluzive për disa sektorë strategjik dhe jetësorë për Shqipërinë ka qënë gjithashtu një hap pozitiv. Një ndër përfitimet kryesore është edhe Autoriteti i Konkurrencësi institucioni që garanton zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, që është një ligj anti-trust, i përputhur pothuajse në masë të plotë me të drejtën europiane të konkurrencës¹⁵. Megjithatë ekonomia e lirë e tregut dhe hapja ndaj tregjeve të tjera që me ndryshimet e fillim viteve '90-të si edhe me anëtarësimin në Organizatën Botërore të Tregtisë e kanë kushtëzuar qeverinë të punojë drejt ligjeve për mbrojtjen e konkurrencës. Në anën tjetër, ritmi i procesit të privatizimit dhe natyra e tij kërkojnë një hapësirë më të madhe për tu analizuar në detaj. Ndërkohë që vitet 2013-2014 e panë shtetin dhe qeverinë shqiptare në vështirësi në lidhje me negociatat me CEZ Shpërndarje, pyetje të mëtejshme shtrohen në lidhje me privatizimin, asetet kombëtare dhe të drejtat ekskluzive në Shqipëri.

3.4 Efektet e procesit të integritimit në lëvizjen e lirë të njerëzve, kapitalit dhe shërbimeve

Marrëveshja e Stabilizim Asocimit përcakton detyrimet kryesore të palëve në garantimin e lëvizjes së lirë të njerëzve, kapitalit dhe mallrave. Kështu, Shqipëria angazhohet në përafrimin e legjislacionit të vet me atë të BE-së si dhe zbatueshmërinë e këtyre ligjeve në lidhje me këto fusha. Për sa i përket lëvizjes së lirë të punëtorëve, Shqipëria po lëviz në dy plane kryesore: a) bashkërendimi i skemave të sigurimeve shoqërore me ato të vendeve të BE-së dhe garantimi i sigurimeve për shtetasit shqiptar që jetojnë e punojnë në këto vende; b) garantimi i kushteve të barabarta të punësimit të të huajve me ato të qytetarëve shqiptar në Shqipëri. Në lidhje me frontin e parë është operuar në bazë të marrëveshjeve dypalëshe për transferimin e kontributeve si ajo me Turqinë, Belgjikën, Hungarinë, Rumaninë, Maqedoninë, Republikën Çeke, si dhe me Luksemburgun, ndërkohë që po punohet për marrëveshjet me Italinë dhe Greqinë. Në lidhje me frontin e dytë, në bazë është ligji nr. 108 i vitit 2013 për të huajt i cili aktualisht lejon punësimin e qytetarëve të BE-së në Shqipëri pa leje punësimi.¹⁶

¹⁴ Ibid, fq 823.

¹⁵ Intervista me Kryetaren e Autoritetit të Konkurrencës, Prill 2014.

¹⁶ Plani Kombëtar Për Integrimin Evropian (2014). Fq. 119-120.

Në lidhje me lëvizjen e lirë të shërbimeve, Shqipëria aktualisht i trajton kompanitë e themeluar në BE sipas të njëjtave standarte me kompanitë shqiptare në të drejtën e vendosjes dhe ofrimit të shërbimeve.¹⁷ Ndërkohë që ka avancuar puna në formalizimin e kuadrit ligjor në lidhje me shërbimin postar dhe njohjen e kualifikimeve profesionale, punë e mëtejshme kërkohet për zbatimin.¹⁸

Në fushën e lëvizjeve të kapitalit, progresi kryesor është shënuar në “liberalizimin e transfertave dhe transaksioneve të llogarive korrente dhe kapitale, dhe transfertave unilaterale ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve”.¹⁹ Për më tepër, e drejta ekskluzive e Bankës së Shqipërisë për të kontrolluar flukset dalëse të kapitalit u shfuqizua, ndërkohë që një seri aktesh u kalua për të ndaluar pastrimin e parave.²⁰

Ndërkohë që në lidhje me lëvizjen e lirë të punëtorëve po punohet për bashkërendimin e skemave të sigurimeve për emigrantët shqiptarë dhe lehtësimin e punësimit për qytetarët e BE-së në Shqipëri, nxitja e punësimit të qytetarëve shqiptarë në vendet europiane nuk përmendet. Gjithashtu, qytetarët e BE-së mund të jenë të avantazhuar në terma joformalë në tregun shqiptar të punës si pasojë e kualifikimeve në universitet të mira perëndimore dhe eksperiencave të punës në vendet e origjinës. Në anën tjetër, bashkërendimi i skemave të sigurimeve për qytetarët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në vendet e BE-së përbën sigurisht një avantazh për mijëra qytetarë, ndërkohë që lehtëson kthimin e tyre në Shqipëri, përfitimin e pensioneve si dhe alternimin e periudhave të punësimit në vendet e BE-së.

Në lidhje me lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe kushtet e njëjta për kompanitë e vendeve të BE-së që të vendosen dhe ofrojnë shërbime njësoj si kompanitë shqiptare përfitimi kryesor lidhet me liberalizimin e tregut, rritjen e numrit të produkteve dhe shërbimeve në treg si dhe në kushtet e konkurrencës së ofrimit të shërbimeve/produkteve më të mira dhe/ose të lira për qytetarët shqiptarë. Në anën tjetër, konkurrenca për kompanitë shqiptare në cilësi dhe shërbime rritet ndërkohë që aftësia e tyre për tu kundërpërgjigjur nevojave të tregut është e ulët. Në këto kushte, një numër kompanish shqiptare me kapacitet më të vogël financiar se kompanitë e vendeve të BE-së mund të mos i mbijetojnë konkurrencës.

¹⁷ Ibid, fq. 124-125.

¹⁸ Për më shumë detaje shiko Ministria e Integritetit (2014) E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime: <http://www.integrimi.gov.al/al/prioritete/aftesia-per-te-perballuar-detyrimet-e-anetaresise-ne-be/e-drejta-e-vendosjes-dhe-liria-per-te-ofruar-sherbime>

¹⁹ Plani Kombëtar Për Integrimin Evropian (2014). Fq. 134.

²⁰ Ibid, fq 135.

3.5 Efektet e procesit të integrimit në sektorin e bujqësisë dhe sigurisë ushqimore

3.5.1 Bujqësia në procesin e integrimit në BE

Sektori i bujqësisë në Shqipëri është një nga sektorët më me rëndësi të ekonomisë shqiptare, duke pasur parasysh madhësinë dhe rëndësinë në treg (kontributi i bujqësisë në ekonominë kombëtare është vlerësuar rreth 18% të PBB-së në vitin 2013 (Banka e Shqipërisë, 2013) edhe pse ka rënë gradualisht nga 26% në vitin 2000), punësimin dhe komunitetin rural (familjet rurale vazhdojnë të mbizotërojnë ekonominë kombëtare, rreth 50% e popullsisë jeton në zonat rurale, dhe bujqësia është zgjedhja kryesore për punësim e njerëzve që jetojnë në këto zona) (MBUMK, 2011).

Sektori i bujqësisë shqiptare vazhdon të përballlet me një numër sfidash: kryesisht, toka bujqësore është e fragmentuar, me dominim të fermave të vogla mesatarisht 1.2 hektarë, në krahasim me 23 ha në BE-25 (DG Agriculture and Rural Development, 2014a). Sfida të tjera përfshijnë: konkurrueshmërinë dhe diversifikimin e prodhimit bujqësor, rritjen e përdorimit të teknikave të mekanizuara bujqësore; përmirësimin e standarteve të cilësisë, përmirësimin e marketingut të produkteve dhe zhvillimin e infrastrukturës (WTO, 2010: 85).

Në rrugën e procesit të integrimit në BE, objektivi kryesor i politikave bujqësore shqiptare është rritja e produktivitetit të sektorit, duke u fokusuar në fushat prioritare që lidhen me *acquis e BE-së* në fushën e bujqësisë. Partneriteti European me BE-në, miratuar në nëntor 2007, përcakton prioritetet kryesore për zhvillimin e politikës bujqësore. Neni 95 i MSA-së thotë se bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe BE-së duhet veçanërisht të synojë modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë shqiptare dhe të sektorit të agro-industriës duke u mbështetur në përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me atë të praktikave, rregullave dhe standardeve Komunitare (Council of the EU, 2006a: 86).

Prioritetet për bujqësinë shqiptare në përputhje me prioritetet dhe objektivat e përcaktuara në MSA, mund të përmbledhen si vijon: rritja e punësimit dhe mbështetje financiare për fermat; përmirësimi i infrastrukturës rurale; bizneset bujqësore dhe agro-përpunimit; menaxhimi i përmirësuar i ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore; ngritja e kapaciteteve të personelit; përmirësime në marketing; rritja e nivelit dhe cilësisë së teknologjive, informacionit dhe njohurive të fermerëve dhe agro-përpunuesit; cilësisë dhe sigurisë më të mirë; zhvillimi i strategjive për zhvillimin rural; diversifikimin e aktiviteteve të fermës dhe rritjes së konkurrueshmërisë në bujqësi (MBUMK, 2013).

Prioriteti kryesor i asistencës së BE-së në ndërtimin e institucioneve, IPA I, në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, është për të mbështetur adoptimin progresiv të standardeve të BE-së si më poshtë:

Forcimi i kapacitetit administrativ të administratave bujqësore, veçanërisht në fushën e hartimit të politikave bujqësore, analiza, zbatimi dhe kontrolli.

Zhvillimi i statistikave të besueshme bujqësore dhe regjistrat (e tokës, kulturave bujqësore kafshëve dhe fermerëve).

Ndërtimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e ardhshëm të masave të para-antarësimit të zhvillimit rural (IPARD). Kjo përfshin ndër të tjera: strukturat e pagesave të jenë akredituar sipas standardeve të BE-së, kushtet e qasjes në kredi të përballueshme nga fermerët / bizneset rurale, shërbimet këshilluese etj. (Drejtoria për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, 2014a).

Komponenti i V i IPA-s, IPARD, bëhet aktiv pasi Shqipëria merr statusin e kandidatit të BE-së, por ndërkohë MBUMK do të duhet të vazhdojë me përmbushjen e kushteve të caktuara të cilat janë të nevojshme para se të përfitohen këto fonde. Skemat e pagesave direkte u prezantuan për herë të parë nga MBUMK në vitin 2007 (MBUMK, 2011). Mbështetja e qeverisë është shtrirë në pagesa fikse si dhe ndihmë financiare apo stimuj për fermerët me skema të kredisë të ofruara përmes Agjencisë së Pagesave. Skemat e mbështetjes bujqësore për herë të parë kanë përdorur kriterin e zonave malore të pafavorizuara për të përfituar nga skema, si zona të diferencuara për shkak të kushteve gjeografike të papërshtatshme, klimës, infrastrukturës, etj (OBT, 2010).

3.5.1.1 Tregtia bujqësore midis Shqipërisë dhe BE-së

Në kuadër të nënshkrimit të MSA-së, në vitin 2006, Shqipëria nënshkroi gjithashtu marrëveshjen e ndërmjetme, e cila synon të krijojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë me BE-në gjatë një periudhe prej dhjetë vjetësh. Marrëveshja e Ndërmjetme dhe MSA-ja kanë vënë në kushtet kontraktuale preferencat sipas Masave Autonome të Tregtisë së aplikuar që nga viti 2000, nga të cilat produktet bujqësore shqiptare përfitojnë nga hyrja e lirë në BE. Bëjnë përjashtim: mishi i gjedhit, sheqeri dhe vera (Council of the European Union, 2006b).

Shqipëria mbetet një importues i ushqimit: BE-ja mbetet partneri tregtar kryesor i Shqipërisë duke përfaqësuar 65.8 për qind të importeve të Shqipërisë dhe rreth 80 për qind të eksporteve totale të vendit në vitin 2012. Eksportet drejt BE-së vazhdojnë të tregojnë norma pozitive rritjeje, megjithëse me ritme më të ulëta se në vitet e mëparshme. Përsa i përket eksporteve në vendet anëtare të BE-së, Italia është destinacioni kryesor për shumicën e eksporteve të Shqipërisë, e ndjekur nga Spanja si partneri i dytë i madh tregtar, një pozitë e mbajtur nga Greqia deri në vitin 2011. Marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe vendeve anëtare të CEFTA përbënte rreth 10.0% të totalit të shkëmbimeve në vitin 2012 (Bank of Albania, 2012). Rreth 75% të shkëmbimeve tregëtare në fushën e bujqësisë dhe ushqimit janë me BE-në, dhe volumi tregtar është rritur nga viti në vit, sidomos vitet e fundit janë ulur importet dhe janë rritur eksportet, kjo është tendenca kryesore (Misha, 2014). Deficiti tregtar për produktet bujqësore është në rënie, duke rezultuar në një eksport të përmirësuar me një normë 1:7 në vitin 2011 (DG Agriculture and Rural Development, 2014b).

3.5.1.2 Asistenca financiare e BE-së për bujqësinë në Shqipëri

Asistenca financiare para-anëtarësimit përfshin mbështetjen e BE-së ndaj Shqipërisë përmes Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA). Sipas IPA 2007, asistenca teknike për bujqësinë është fokusuar për të mbështetur drejtimin e statistikave shqiptare me standardet e BE. Një nga objektivat e këtij projekti është të krijojë një regjistër të përditësuar të fermës për të prodhuar statistika të besueshme bujqësore në përputhje me kërkesat e BE. Sipas IPA 2008, asistenca teknike është akorduar për Ministrinë e Bujqësisë, për të ngritur agjensitë administrative përgjegjëse për fondet IPARD (Agjencia e Pagesave dhe Autoriteti Menaxhues). Për më tepër, IPA 2009 dhe 2010 u zbatuan për të mbështetur konsolidimin e infrastrukturës institucionale dhe fizike të sistemit të sigurisë ushqimore në Shqipëri. Në kuadër të IPA 2011, projekti ka financuar rritjen e kapacitetit të aktorëve të përfshirë, ku agjensitë kombëtare në lidhje me ekspertizën e jashtme janë duke filluar thirrjet për të bashkë-financuar masat IPARD-like, pra investimet në shkallë të vogla dhe të mesme në sektorin agro-ushqimor. Në përputhje me këtë asistencë, nën IPA 2013 me ndarjen e financimit prej 95m €, Komisioni parashikon një ndërhyrje për të rritur më tej kapacitetet e strukturave kombëtare në funksion të zbatimit të një programi të ardhshëm IPARD, si dhe për të vazhduar zbatimin e masave IPARD-like (European Commission – DG for Enlargement, 2013a).

Komisioni është duke përgatitur Shqipërinë për të menaxhuar fondet nën komponentin IPA V. IPARD-like është një mbështetje nga Komisioni Europian nëpërmjet IPA 2011 i cili është fokusuar tek:

- Rritja e kapacitetit dhe përfitimit ekonomik për fermerët dhe agrobizneset;
- Kapaciteti i këshillimit dhe konsulencës së shërbimeve për të ofruar informacion të mjaftueshëm dhe këshilla mbi skemat e Grantit të bujqësisë dhe zhvillimit rural zbatohet në përputhje me IPARD-Like;
- Konsolidimi i procedurave dhe përgatitja e strukturës operative për të menaxhuar programin IPARD (MBUMK 2011: 6).

Për sa i përket çështjeve të Raport Progresit 2013, qeveria akordoi rreth 6.8 milion euro në 2013 për mbështetjen e drejtpërdrejtë dhe skemat kombëtare të investimit në bujqësi dhe agropërpunim (Komisioni Europian, 2013). Jane akorduar deri tani rreth 12 milion Euro (Gjeci, 2014). Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (2014) do të bashkëfinancojë programin e IPARD nga buxheti kombëtar nga viti 2014 e në vazhdim. Buxheti i vlerësuar i IPARD II për 2014-2020 gjendet në tabelën e mëposhtme. Buxheti për 2014-2020 IPARD II vlerësohet si më poshtë:

Tabela 4: Buxheti për 2014-2020 IPARD II/ milion euro

Buxheti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
IPARD iBE	15,50	15.81	16.12	16.43	16.74	17.05	17,36
Bashkëfinancim kombëtar për IPARD	5.17	5.27	5.37	5.48	5.58	5.68	5.79

Total buxheti	20.67	21.08	21.49	21.91	22.32	22.73	23.15
----------------------	--------------	--------------	--------------	--------------	--------------	--------------	--------------

Burimi: Sektorit i Buxhetit i Ministrisë së Bujqësisë

Procesi i përafrimit të legjislationit bujqësor me *acquis* të BE-së dhe zbatimi i standardeve të BE-së në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, është një nga pjesët më të vështira dhe me kosto për një vend aspirant²¹. Kapitulli bujqësor dhe rural i BE përfshin një numër të madh të rregullave të detyrueshme. Zbatimi i duhur dhe efektiv i këtyre rregullave nga një administratë publike efikase është e domosdoshme për funksionimin e PPB (Prodhimin e përgjithshëm bruto). Kjo përfshin ligjet që rregullojnë sistemet e menaxhimit të tilla si Agjensinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) dhe Administrimin dhe Kontrollin e Sistemit të Integruar (Integrated Administration and Control System IACS), dhe gjithashtu kapacitetin për të zbatuar veprimet e zhvillimit rural (DG Agriculture and Rural Development, 2014a). Qëllimi themelor i asistencës financiare të BE është që kuadri kombëtar rregullator do të përafrohet plotësisht me kërkesat e BE deri në fund të vitit 2020.

3.5.1.3 Zhvillimet institucionale për bujqësinë

Zbatimi, menaxhimi dhe kontrolli i PPB kërkon krijimin, modifikimin dhe forcimin e strukturave të duhura administrative (p.sh. Agjencia e Pagesave dhe IACS). Në disa raste, *acquis* përcakton specifikimet e detajuara për strukturat e nevojshme administrative (DG Agriculture and Rural Development, 2014b). Përafrimi me ligjin e BE do të kërkojë ngritjen e një drejtorie të zhvillimit rural në Ministrinë e Bujqësisë, e cila duhet të jetë e akredituar nga BE-ja dhe do të jetë përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe programeve për përdorimin e fondeve të zhvillimit rural. Përveç kësaj, dixhitalizimi i informacionit bujqësor është një element jetik dhe një nevojë urgjente në procesin e integritimit në BE (WTO, 2010). Nga viti 2009 përgjegjësia dhe vëmendja e ndryshimeve institucionale me ndikim në sektorin bujqësor dhe rural vlerësohen në kuadër të kërkesës për të qenë një vend kandidat i BE-së. Drejtoria e Integritimit në MBZHRAU, është një drejtori e unifikuar e ngritur në bazë të kërkesave të Komisionit Europian për të patur drejtori të tilla në të gjitha ministrinë e linjës dhe në të gjitha institucionet qendrore. Funksionimi kryesor i saj është koordinimi i procesit të integritimit europian, por edhe fondet e IPA të Komisionit Europian (Misha, 2014).

Strukturat operacionale IPARD, AZHBR ose Agjencia e Pagesave dhe Autoritetit Menaxhues janë konsideruar si një prioritet për Qeverinë në procesin e përafrimit me *acquis* e BE-së të BE. Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural ose Agjencia e Pagesave, themeluar nga MBUMK ngarkohet për zbatimin e masave të politikave bujqësore, duke përfshirë edhe administrimin e fondeve nga shteti dhe donatorët ndërkombëtarë. Ngritja e kësaj agjencie është kërkuar nga BE-ja, në mënyrë që Shqipëria të përfitojë nga fondet e BE (Komponenti V IPA (IPARD)). AZHBR është

²¹Për legjislationin në fushën e bujqësisë në Shqipëri, shih Aneks IV.

ngritur menjëherë pas miratimit të ligjit për zhvillimin rural në vitin 2007²², funksionon akoma dhe sigurisht është perfeksionuar në vite dhe ka 102 punonjës. Synimi kryesor i përgatitjes së kësaj agjensie është që ajo në të ardhmen të jetë e gatshme për të lëvruar fondet e BE-së (Misha, 2014).

Drejtoria e Programimit dhe Vlerësimit të Politikave Rurale në MBZHRAU, kryen Rolin e Autoritetit menaxhues për strukturat e IPARD. Proceset e integritetit europian kanë nxitur ngritjen dhe funksionimin e kësaj strukture. Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për menaxhimin e programit IPARD në përputhje me parimin e efikasitetit dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve IPA. Ky institucioni është njëra nga strukturat operationale për zbatimin e Komponentit të V të IPA-s(IPARD) (Gjeci, 2014).

3.5.1.4 Vlerësimi i progresit në sektorin e bujqësisë

Gjatë vitit 2012 bujqësia ka regjistruar një normë pozitive rritjeje prej 5.5%, kjo normë më e lartë se rritja mesatare historike prej 3.8% (Banka e Shqiperise, 2012). Në bazë të statistikave të fundit sipërfaqja e tokës bujqësore e shfrytëzuar është rritur me 24,000 ha ose 6% gjatë periudhës 2007-2011 pjesërisht përmes mbështetjes për 15,000 ha plantacione të reja frutore, agrume, ullinj, arrorre si dhe vreshta. 64% e totalit të tokës bujqësore është shfrytëzuar, por në mënyrë të konsiderueshme më shumë hektarë janë të nevojshme për tu shfrytëzuar në vitet që vijnë. Madhësia mesatare e fermës është rritur nga 1.14 ha për fermë në 2007, në 1.26 ha për fermë në vitin 2011(MBUMK, 2013: 12). Kjo është rritje pozitive, por ende larg nivelit të nevojshëm në mënyrë që një familje të disponoj të ardhura mesatare nga bujqësia, dhe shumë larg nga mesatarja e BE.

Eksportet e produkteve bujqësore janë rritur me 8.5% dhe një pjesë e mallrave të importit janë zëvendësuar me prodhimin vendas gjatë vitit 2012. Një sfidë për ekonominë shqiptare është të përmirësojë aftësisë konkurruese në sektorin e bujqësisë dhe për të mbajtur qëndrueshmërinë e deficitit korent tregtar. Edhe pse shumica e produkteve bujqësore shqiptare (rreth 95%) kanë akses pa taksa në BE, deficitit tregtar Shqipëria nuk ka përfituar mjaftueshëm nga marrëveshja e tregtisë së njëanshme me BE-në.

Progres është arritur me miratimin e një ligji të ri për ushqimin në përputhje me standardet e BE, strategjisë për përdorimin e tokës duke krijuar një treg të tokës dhe diversifikimin e aktiviteteve të fermerëve. Progres është bërë në ngritjen dhe ndërtimin e strukturave operuese (Agjensisë së Pagesave dhe Autoritetit Menaxhues) për të menaxhuar dhe kontrolluar fondet e zhvillimit rural në kuadër të Komponentit V IPARD. Ndërkohë duhen akredituar strukturat operative në përputhje me kriteret e akreditimit të BE-së si dhe të zhvillohen më tej aftësitë e AZHBR për t'u bërë Agjensia e pagesave të PPB pas anëtarësimit.

Gjatë periudhës Tetor 2012 deri në Mars 2013, Strategjia Ndër-sektoriale Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2013-2020 filloi të përgatitet, por nuk është finalizuar deri tani. Në lidhje me bujqësinë organike, janë dhënë subvencione përmes skemave të drejtpërdrejta si edhe

²²Ligjit nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

trajnime mbi prodhimin organik. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për zhvillimin rural, për një ligj për bujqësinë organike, krijimin e regjistrimit të tokës dhe përcaktimin e prioriteteve strategjike për bujqësinë dhe shfrytëzimin e tokës. Gjithashtu duhet të bëhet më shumë progres për krijimin e kornizës ligjore për cilësinë dhe origjinën e produkteve në përputhje me kërkesat e BE (PDO/PGI, produktet tradicionale) si dhe ndryshimet e ligjit për pronësinë industriale në lidhje me treguesit gjeografikë (MBUMK, 2013).

3.5.2 Kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit në sektorin e bujqësisë

Qëllimi i kësaj analize është të identifikojë kostot dhe përfitimet e pritura në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë të procesit të integrimit të Shqipërisë në BE në fushën e bujqësisë. Aderimi në BE paraqet përfitime afatgjata si dhe sfida të theksuara afatshkurtra. Për të sjell ndryshim, Börzel and Risse (2003) identifikojnë dy kushte kryesore: duhet të ketë një diferencë midis politikave kombëtare kundrejt atyre të komunitetit ku aspirohet aderimi me qëllim krijimin e përshtatjes, si dhe duhet të ketë kushte të qarta për të nxitur këtë ndryshim. Pas një pamje racionaliste, mundësia e ndryshimit të brendshëm do të rritet përmes "rishpërndarjes së burimeve dhe fuqizimit efektiv të aktorëve vendas" (ibid: 58). Më tej është argumentuar se pajtueshmëria nuk është vetëm një çështje e vullnetit apo përkushtimit ndaj reformave të BE, por më tepër një çështje e kapacitetit politik për të zbatuar kërkesat e BE (Pridham, 2007). Kjo analizë është synuar drejt integrimit të bujqësisë shqiptare, si dhe sfidat e saj dhe progresin deri më sot.

3.5.2.1 Kostot e procesit të integrimit në sektorin e bujqësisë

Shumica e kostove vijnë nga ndryshimet mes strukturave kombëtare ekzistuese institucionale dhe atyre strukturave dhe normave në BE. Kostot kryesore të para-anëtarësimit në fushën e bujqësisë janë të lidhura me përafrimin dhe miratimin e politikave kombëtare të *acquis* eBE-së, me kërkesat dhe pasojat e ndërtimit të institucioneve dhe kapaciteteve administrative. *Acquis* bujqësor është një nga pjesët më të vështira dhe të kushtueshme të harmonizimit me legjislacionin dhe kërkesat e BE-së. Në kuadrin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2012 – 2015, vendi ka marrë angazhime duke punuar për hartim ligjesh, por edhe për kuadrin rregullator dhe akte nënligjore të shumta. Rregulloret dhe direktivat kombëtare po plotësohen në mënyrë të vazhdueshme gjithmonë brenda kuadrit të MSA-së në një shkallë përafrimi të detyruar për tu zbatuar, përpara se të merret statusi i vendit kandidat (Misha, 2014).

Zbatimi i *acquis* nënkupton investim të konsiderueshëm në bujqësi, transport dhe në përgjithësi, investimet në ata sektorë ku Shqipëria është më pak e zhvilluar në krahasim me vendet e tjera. Përvoja e kohëve të fundit me përgatitjen e Programit IPARD dhe ngritjen e marrëveshjeve institucionale për zbatimin e skemës IPARD-like tregoi një numër të kostove në lidhje me zbatimin e duhur të akteve të miratuara ligjore (European Commission DG Enlargement, 2013b). Për më tepër ngritja e kapaciteteve dhe më shumë njohuri janë të nevojshme në organet teknike kombëtare për të vlerësuar projektet e investimeve të përfituesve potencialë në përputhje me standardet e BE. Ngritja e institucioneve specifike si Agjensia Kombëtare për Zhvillim

Bujqësor dhe Rural është një institucion që pjesërisht shfrytëzohet për skemat kombëtare, por pjesa tjetër është e tëra e dedikuar për investimet e BE-së, kështu që në një kuptim kjo paraqet një kosto në rrugën e integrimit në BE (Misha, 2014).

Kostot e tjera lidhur me përshtatjen dhe zbatimin e standardeve dhe politikave të përcaktuara nga BE-ja, janë kërkesat graduale të BE për rregullimin e tregjeve, standardet e shëndetit dhe higjienës, modernizimin e infrastrukturës, standardeve të punës, mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e mjedisit etj. Drejtimi me standardet e komunitetit në fushën e higjienës, shëndetit dhe sigurisë në punë, mjedisit dhe mirëqenies së kafshëve, kërkon investime të rëndësishme në modernizimin e forcës së punës, njohurive dhe aftësive (MBUMK, 2013).

Kostot buxhetore të integrimit janë edhe kostot e buxhetit të MBUMK për personelin, shpenzimet operative dhe investimet e brendshme, të cilat janë planifikuar të rriten me 3% në vit për shkak të rritjes së nevojshme të personelit në mënyrë që të përballen me procesin e integrimit në BE (Cuko, 2014). MBUMK do të duhet të bashkë-financojë programin IPARD me 5.17 milion euro nga buxheti kombëtar më 2014 (shih Tabela 4). Parakusht për një proces të integrimit më të suksesshëm është edhe angazhimi i qeverisë i cili duhet të reflektohet në perspektivën e buxhetit, por ky angazhim është komprometuar shpesh për shkak të mungesës së fondeve në dispozicion, edhe pse në parim është rënë dakord për të rritur buxhetin e bujqësisë për shkak të kërkesave të procesit të integrimit në BE. Përveç kësaj, qeveria shqiptare duhet të krijojë një sistem monitorimi për të kontrolluar përparimin në zbatimin e politikave sektoriale.

Disa kosto ekonomike për bujqësinë shqiptare gjatë procesit të integrimit në BE janë ndryshimi midis kërkesave të procesit të integrimit dhe qëllimeve zhvillimore të vendit, të ardhurat më të ulëta nga tarifatat doganore, në kushtet që edhe kapaciteti absorbues për fondet në dispozicion është i ulët. Megjithatë ka përfituar nga trajtimi i favorshëm tregtar, Shqipëria ka një deficit të konsiderueshëm tregtar në produktet bujqësore me BE-në. Megjithatë tregtia me BE, nuk duhet të konsiderohet vetëm si një kosto e integrimit në BE, për shkak se reformat janë të nevojshme si pjesë e tranzicionit në një ekonomi tregu, me ose pa procesin e integrimit në BE.

Prodhuesit vendas do të duhen të përballen me problemin e rritjes në mënyrë të konsiderueshme të çmimeve të prodhimit, e cila do të dëmtojë konkurrencën e tyre ndërkombëtare. Dihet se kur Shqipëria të bëhet anëtare e BE, ajo do të humbasë mundësinë e trajtimit preferencial për prodhuesit vendas në tregun e brendshëm. Prodhimi bujqësor do të përballë me sfida të mëdha, kryesisht për shkak se ky sektor nuk është akoma gati: subvencionet bujqësore deri tani kanë pasur një karakter më tepër social se sa ekonomik. Nga vetë Drejtoria e Integrimit në Ministrinë e Bujqësisë, cilësohet si kosto më e madhe e integrimit procesi i ristrukturimit të sektorit të Bujqësisë (Misha, 2014).

3.5.2.2 Përfitimet e procesit të integrimit në sektorin e bujqësisë

Përfitimet tradicionale të procesit të integrimit të bujqësisë shqiptare janë rritja e burimeve financiare për sektorin, përshpejtimi i reformave dhe mbështetje për politikat bujqësore të

vendit. Në mënyrë të veçantë përfitimi kryesor i procesit të integrimit në BE për bujqësinë është mundësia që prodhimet shqiptare jo vetëm të furnizojnë plotësisht nevojat e tregut vendas, por përmes zbatimit të vazhdueshëm të kritereve të PPB, për produkte si mish, djathë dhe qumësht, fruta dhe perime, për të hyrë në tregjet ndërkombëtare dhe në BE. Liberalizimi i tregtisë së produkteve bujqësore ka ndikuar edhe pozitivisht në uljen e çmimeve të disa produkteve bujqësore (Gjeci, 2014).

Përfitimet financiare për sektorin e bujqësisë nga procesi i integrimit në BE janë të shumta. BE ka financuar rreth 22 milion euro për infrastrukturë në zonat rurale. Një tjetër avantazh është se përgatitjet për programin IPARD kanë prodhuar një seri të analizave dhe praktikave të mira për pjesë të ndryshme të sektorit. Sipas komponentit I të IPA-s, me fokus në bujqësi, vendi ka përfituar 18 milion euro, nga të cilat 2 milion euro për ndërtimin dhe përgatitjen për akreditim të strukturave Komponenti IV, 10 milion euro për dhënien e skemës së subvencionimit të drejtpërdrejtë për fermerët për të investuar në fermë dhe agrobiznes. BE ka siguruar fonde për një total prej 9.6 milion euro, për vitin e fundit të skemës së granteve IPARD-like.

Përfitime ka patur për sektorin e statistikave bujqësore si edhe prodhimi dhe eksportet e produkteve bujqësore janë rritur. Procesi i para-anëtarësimit për Shqipërinë deri më tani ka përfituar më shumë fonde për mbështetjen e investimeve në pronat bujqësore dhe përpunimin e ushqimit, diversifikim ekonomik, zhvillimin e infrastrukturës rurale, përmirësimin e standardeve të cilësisë dhe teknologjike etj. Bashkëpunimi, ndërmjetësimi dhe koordinimi midis ministrive të vendit është lehtësuar si dhe ka patur përfitime në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve, me trajnime dhe asistencë teknike (Misha, 2014).

Përfitimet sociale dhe ekonomike të sjella nga agjensia e pagesave për sistemin e menaxhimit të financimit të BE janë në mënyrë eksponenciale më të larta se sa kostot. Performanca e sektorit bujqësor është rritur nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve dhe përfitimit të fondeve shtesë. Përfitime të tjera përfshijnë fonde grant për fermerët dhe përpunuesit shqiptar, trajnime për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e programeve në mënyrë të decentralizuar, rritje të shkëmbimit të eksperiencave me vendet e rajonit si dhe më e rëndësishmja, rritje të standardeve të produkteve bujqësore (Gjeci, 2014). Gjatë vitit 2011, skemat e mbështetjes për herë të parë kanë përdorur kriteret lehtësuese për zonat malore të pafavorizuara për të përfituar nga skema, si zona të diferencuara për shkak të kushteve gjeografike të papërshtatshme, klimës, dhe infrastrukturës, etj.

Përfitim i drejtpërdrejtë është që bujqësia është e tëra në një përjasje krejt të re të organizuar dhe që do të çojë patjetër drejt thithjeve sa më shumë të fondeve të cilat do shkojnë direkt për mbështetje të fermerëve dhe të bizneseve (Misha, 2014).

3.5.2.3 Skicimi i së ardhmes së sektorit të bujqësisë në anëtarësimin në BE

Në procesin e integrimit bujqësor të Shqipërisë në BE, përafrimi me *acquis* do të vazhdohet dhe prioritet do t'i jepet shqyrtimit dhe zbatimit të kërkesave rregullative të detyrueshme nën IPARD. Statusi kandidat dhe hapja e negociatave për anëtarësim do të sjellin nevojën për të

harmonizuar krejtësisht politikat bujqësore me *acquis* të BE.²³ Procesi i përafrimit të legjislacionit dhe të instrumenteve politike kombëtare me *Acquis* të BE-së si dhe zhvillimin e mëtejshëm të institucioneve për zbatimin e tij do të jenë prioriteti kryesor për periudhën 2014-2020. Gjithashtu prioritetet e tjera pritet të ngrihen gjatë hapjes së negociatave me BE-në.

Duke patur parasysh sfidat e sektorit (si parcelat e fragmentizuara, etj.) pritet që prodhuesit bujqësorë që i kapërcejnë këto sfida, ata të orientuar drejt tregut të jenë përfituesit e anëtarësimit, ndërsa fermerët të cilët punojnë në parcela të vogla dhe të fragmentarizuara, jo-konkurruese dhe pa ristrukturim mund të jenë humbësit e mundshëm. Deficiti tregtar duhet të pakësohet ndjeshëm duke rritur kapacitetet e eksportit në mënyrë që të mos ketë një ndikim negativ në stabilitetin makroekonomik. Për këtë arsye, reformat duhet të fokusohen në përmirësimin e mjedisit të biznesit, përmirësimin e infrastrukturës, sundimin e ligjit dhe kapacitetin e prodhimit në mënyrë që të mund mbajë një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Vizioni për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale në Shqipëri mund të përmbledhet si përpjekje për të nxitur një praktikë me cilësi të lartë për prodhimin e ushqimit, duke zhvilluar një sektor agro-ushqimor konkurrues dhe inovativ në gjendje për të mbështetur presionin konkurrues në tregjet e brendshme dhe të BE-së dhe përmbushjen e standarteve dhe kërkesave të tregut të BE. Mbështetja financiare të konceptohet në dispozicion për sektorin e bujqësisë dhe agro-përpunimit dhe operatorëve në zonat rurale, në mënyrë për të ristrukturuar dhe modernizuar prodhimin, rritjen e aftësisë konkurruese, për të siguruar një shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve dhe të gjenerojë mundësi të të ardhurave alternative. Skemat përkatëse të cilësisë të përfshijnë produkte organike, produktet si Markat e Mbrojtura të Origjinës dhe mbrojtje gjeografike, si dhe produkte tipike lokale. Skemat kombëtare të mbështetjes gjatë periudhës 2014-2020 gradualisht do të duhet të përshtaten me kërkesat e PPB në drejtim të prezantimit të instrumenteve nën organizimin e përbashkët të tregut dhe pagesat direkte. Ky duhet të jetë një proces i vazhdueshëm ku politikat kombëtare të zhvillimit bujqësor dhe rural të përshtaten gradualisht me PPB dhe masat IPARD. Gjithashtu është e rëndësishme për të zhvilluar më tej kapacitetet institucionale në të njëjtën kohë me futjen e kërkesave të reja rregullatore për të siguruar zbatimin e plotë dhe respektimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Potencial për të ardhmen, për të diversifikuar aktivitetet ekonomike në fushën e bujqësisë në Shqipëri, janë disa fusha të mundshme për tu marrë parasysh si p.sh: produktet si frutat e egra si manaferrat, kërpudha dhe bimët medicinale aromatike; prodhimi i ushqimit tradicional; turizmi rural; aktivitetet rekreative; marketingu i produkteve; aktivitetet tradicionale si p.sh. zanate tradicionale (Ministry of Agriculture, Food and Consumer Protection, 2013).

²³ Harmonizimi i plotë me politikat e BE-së dhe kërkesat e rregulloreve është një parakusht për anëtarësimin në BE.

Në të ardhmen puna për krijimin e një sistemi elektronik bujqësor (regjistri i fermave, regjistri i kafshëve, etj.) duhet të intensifikohet, me qëllim që të krijohet një bazë për menaxhimin e shëndoshë financiar të asistencës kombëtare dhe asistencës së BE-së. Parimi themelor është që kuadri kombëtar rregullator do të përafrohet plotësisht me kërkesat e BE, të cilat do të zbatohen deri në fund të vitit 2020. Përfshirja e madhe e fermerëve konkurrues në treg është e nevojshme në vitet që vijnë. Nevojiten përpjekje të mëtijshme për të trajnuar personelin me procedurat e duhura dhe për të ndërtuar deri kapacitetin administrativ të të gjitha strukturave të përfshira në procesin e akreditimit.

Procesi i integritetit europian nuk vjen pa kosto, sidomos për sektorin e bujqësisë, por janë kosto të domosdoshme për përtëritjen ekonomike të sektorëve si bujqësia që kanë nevojë për reforma të tilla rrënjësore në përafrimin me Politikën e Përbashkëta Bujqësore të BE. Përfitimet e integritetit do të jenë të dukshme në një periudhë afatgjatë, ndërsa sfidat përfaqësojnë një faktor afatshkurtër dhe ato do të jenë të nevojshme në kuadër të procesit të tranzicionit edhe pa patur perspektivën e BE-së

3.5.3 Siguria ushqimore në procesin e integritetit në BE

Një nga prioritetet e qeverisë shqiptare është që të garantojë shkallën më të lartë të sistemit të kontrollit të sigurisë ushqimore, duke synuar në krijimin e një sistemi funksional të plotë të sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit dhe prodhimeve me parimin “nga ferma në tavolinë”, në përputhje me Standardet e BE (MBZHRAU, 2014). Përafrimi i standardeve aktuale të sigurisë ushqimore, shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve, mbrojtja e mjedisit, kontrolli dhe sistemi i inspektimit, zhvillimi i infrastrukturës administrative në përafrim me atë të BE-së, me qëllim zbatimin e legjislacionit, janë pjesë e politikës së sigurisë ushqimore që rrjedh nga Neni 76, MSA (f. 73), si më poshtë:

Forcimi i sistemit të sigurisë së ushqimit dhe sistemeve të mbrojtjes së konsumatorit dhe të kontrollit që lidhen me të.

Të arrihen përmirësime të konsiderueshme në aspektin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit dhe kërkesave veterinare dhe fitosanitare, në përputhje me standardet e KE-së.

Gjithashtu, Neni 95 (f. 86) i MSA-së, parashikon se bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe BE do të synojnë në modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë shqiptare dhe sektorit agro-industrial, si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit dhe praktikave për rregullat dhe standardet komunitare. Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet:

Forcimit të sistemit institucional të sigurisë së ushqimit dhe kontrollit të lidhur me të,

Forcimit të kapaciteteve laboratorike për sigurinë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare,

Përmirësimit të legjislacionit për sigurinë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare dhe zbatimin e tij (Council of the European Union, 2006a).

Krijimi i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) në Shqipëri u bazua në prioritetet strategjike të përcaktuara në dokumentin e Komisionit Europian "Letrës së Bardhë për Sigurinë e Ushqimit" dhe sanksionuar në ligjin e ri të Ushqimit të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në Janar 2008. Roli primar i AKU-së do të jetë zbatimi i detyrueshëm i rregulloreve të lidhura me sigurinë ushqimore, ndërsa detyra të tjera në lidhje me zhvillimin e politikave, përgatitjen e legjislacionit dhe menaxhimin e krizës do të ndahen me ministritë e tjera përgjegjëse (AKU, 2014).

Standardet e sigurisë ushqimore mbulojnë një gamë të gjerë të parametrave, duke përfshirë substancat e dëmshme në ushqim (aditivët, mbetje pesticidesh, mbetjeve të ilaçeve veterinarë dhe ndotësve të tjerë) dhe mbetjeve në ushqim të kafshëve. Standardet e procesit (vendimi se si prodhohet ushqimi, përgatitja, trajtimi, dhe shitja) përfshihen në standardet për higjienën e ushqimit, etiketimin, paketimin, organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ) dhe kërkesat për gjurmueshmërinë (AKU, 2014). Në fushën e sigurisë së ushqimit, menaxhimi i mbetjeve është një shqetësim serioz. Në këtë drejtim, një problem i madh mjedisor në Shqipëri është mungesa e fabrikave të riciklimit. Ekziston një nevojë e theksuar për të përmirësuar mbrojtjen e mjedisit, duke ndërtuar riciklimin, duke investuar në pajisje dhe objekte për ri-përpunimin të produkteve të ndërmjetme dhe trajtimin e mbeturinave dhe deponimin e mbeturinave, dhe pajisje për mbeturinat e ujit në thertoret dhe qendrat e përpunimit të mishit (European Commission-Enlargement, 2013b).

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) është përgjegjës për kryerjen e testeve të sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare. ISUV ka nevojë për të forcuar menaxhimin e cilësisë në përputhje me standardet e BE-së dhe rregullat e akreditimit. Gjithashtu laboratorët përkatës të ISUV duhet të përmirësohen në mënyrë që të plotësojnë kërkesat e ISO 17025 akreditimit. Projektet e ndryshme të BE kanë për qëllim të forcojnë Ministrinë e Bujqësisë dhe AKU, me mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve për kryerjen e testeve të sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare nga ISUV dhe laboratorët rajonalë (European Commission-Enlargement, 2013b).

SKZHI 2007-2013 dhe politika e sigurisë ushqimore e qeverisë është në përputhje me objektivin e përgjithshëm të vendit drejt integritit në BE (Department of Strategy and Donor Coordination, 2013). Shtojca 4, neni 3.8.1 që i referohet sigurisë ushqimore në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (2009-2014) parashtron prioritetet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të Shqipërisë në procesin e integritit europian duke u fokusuar veçanërisht në: Zbatimin e angazhimeve të

ndërmarra në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, prioritetet për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së, Përcaktimi i kapaciteteve administrative të nevojshme për zbatimin e angazhimeve të MSA-së sipas fushave; Përcaktimi i kostove financiare për zbatimin e angazhimeve të MSA-së, në përputhje me programimin e buxhetit afatmesëm dhe shpenzime të tjera financiare të përcaktuara në strategjitë sektoriale (Ministria e Integritit European, 2007).

Objektivi i Planit Indikativ Shumëvjeçar për Shqipërinë (2011-2013) për sigurinë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare synon në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative të sistemeve të kontrollit të ushqimit përmes mbështetjes së kapaciteteve laboratorike, miratimi i legjislacionit veterinar dhe fitosanitar, përmirësimi në eliminimin e sëmundjeve të kafshëve dhe identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e lëvizjeve të tyre (European Commission, 2011b). Seksioni që mbulon bujqësinë në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrit 2007-2013 (SKZHI) përmend nevojën për të rinovuar kuadrin ligjor dhe infrastrukturën përkatëse fizike për inspektimin zyrtar të ushqimit në përputhje me standardet e BE (MBUMK, 2007).

Procesi për të përgatitur gradualisht sektorët agro-ushqimorë shqiptarë dhe zonat rurale për anëtarësimin në BE, duke futur gradualisht kërkesat e BE për rregullimin e tregjeve, shëndetin dhe standardeve të higjienës, mbrojtjen e mjedisit, si dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale, në të njëjtën kohë me futjen e kërkesave të reja rregullatore për të siguruar zbatimin e plotë dhe respektimin e kërkesave ligjore në fuqi. Si rezultat, një nga sfidat kryesore në projektimin e sistemeve, dhe gjurmueshmërinë e ushqimit, duke siguruar pjesëmarrjen e fermerëve të vegjël, është zhvillimi i standardeve të përshtatshme të sigurisë ushqimore.

Siguria ushqimore është e lidhur direkt me produktet ushqimore dhe një nga prioritetet e MBZHRAU është eksporti i këtyre produkteve në vendet e BE-së. Por që të eksportosh në BE do të thotë të arrish standartet e tyre dhe të gjitha këto janë brenda procesit të integritit, dhe duhet punuar në këtë drejtim, në hartimin e të gjitha politikave për nxitjen e eksporteve të vendit, përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së për sigurinë ushqimore dhe pastaj planifikimin e mënyrës për të arritur këto standarte (Cuko, 2014).

Sfidat në realizimin e mbrojtjes së konsumatorëve në aspektin e standardeve të sigurisë ushqimore janë:

Një nivel i lartë i sigurisë ushqimore nuk është arritur ende.

Ekziston një mungesë e besimit nga ana e konsumatorëve.

Komunikimi dhe dialogu me konsumatorët mbi çështjet e sigurisë ushqimore nuk është konsoliduar ende.

Arsimi dhe trajnimi në aspektin e cilësisë dhe të sigurisë ushqimore për personelin e institucioneve të kësaj fushe është e nevojshme.

Kontrolle më të specializuara për të siguruar që standardet e pranueshme të sigurisë së BE-së janë arritur.

Gjurmimi i produkteve në të gjithë zinxhirin ushqimor duhet themeluar plotësisht.

Kontrolli dhe inspektimi duhet përmirësuar. (*Consumer Complaints Management System CCMS* 2007: 10)

3.5.3.1 Asistenca financiare e BE-së për sigurinë ushqimore

Ndihma e BE-së nën financimin IPA 2008, ka mbështetur Shqipërinë në luftën kundër sëmundjeve zoonotike. Për më tepër, IPA 2009 dhe 2010 ka dhënë mbështetje për konsolidimin e infrastrukturës institucionale dhe fizike të sistemit të sigurisë ushqimore në Shqipëri (European Commission, 2011b). IPA 2009 "Konsolidimi i sistemit të sigurisë ushqimore në Shqipëri", kishte për qëllim forcimin dhe konsolidimin e strukturave administrative përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të masave të sigurisë ushqimore në përputhje me ato të BE-së. Një nga rezultatet më të rëndësishme është dokumenti strategjik për sistemin e laboratorëve të sigurisë ushqimore në përputhje me standardet e BE.

Objektivi i përgjithshëm i projektit projekti IPA 2009 gjatë periudhës 2011 – 2014 me një financim prej 2.2 milion euro, është që mbrojtja e konsumatorit në Shqipëri nga sëmundjet të transmetueshme nga ushqimi, të përmirësohet si rezultat i zbatimit të standardeve të përmirësuara të sigurisë ushqimore. Qëllimi i projektit është që kapaciteti administrativ i MBZHRAU dhe AKU për zbatimin e politikës kombëtare të sigurisë ushqimore të jetë i konsoliduar si dhe zbatimi i legjislacionit në përputhje me *acquis* të BE-së.

Projekti IPA 2010 kishte për qëllim mbështetjen e sigurisë ushqimore dhe infrastrukturës veterinare në Shqipëri, me ndërtimin dhe rehabilitimin e AKU, laboratorëve dhe zyrave rajonale si dhe laboratorin veterinar qendror në ISUV. Ndikimi kryesor i projektit do të jetë mbi prodhuesit dhe tregtarët për të përmirësuar cilësinë dhe sigurinë e ushqimit të prodhuar në përputhje me standardet dhe për konsumatorët për të përfutur nga një nivel i lartë i mbrojtjes ushqimore (European Commission, 2013b). Kontributi i BE-së ka qenë 4 milion euro për mbështetje për infrastrukturën e sigurisë ushqimore në Shqipëri (European Commission DGENlargement, 2013b). Drejtoria e Sigurisë Ushqimore është duke përgatitur planin e përmirësimit dhe një nga prioritetet është që me mbështetjen e IPARD-it të përmirësohen standartet e operatorëve të bizneseve ushqimore (Cuko, 2014).

Në kuadër të projektit IPA, Autoriteti European i Sigurisë Ushqimore (EFSA, 2014) po zbaton programin me titull: "Masat përgatitore për pjesëmarrjen e vendeve kandidate dhe vendeve kandidate potenciale në EFSA". Gjithashtu, Organizata Botërore e Shëndetësisë ka mbështetur një projekt katër-vjeçar (prill 2009-maj 2013) për të forcuar infrastrukturën e sigurisë ushqimore në Shqipëri. Një objektiv kryesor i projektit ishte për të lidhur prodhimin e vendit me kërkesat e sigurisë të Komisionit European, të dyja për të mbrojtur shëndetin e konsumatorëve dhe për të mbështetur tregtinë shqiptare (WHO, 2014).

Objektivat e SKZHI 2007-2013 përfshijnë ndërhyrje strategjike në sektorët kyç të ekonomisë shqiptare duke mbështetur Qeverinë e Shqipërisë në përpjekjet e saj për përmirësimin e prodhimit, përpunimit dhe marketingut dhe për modernizimin e sigurisë ushqimore, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, pajtueshmërinë me BE-në, dhe Codex Alimentarius, duke rritur perspektivat e saj për anëtarësimin përfundimtar në BE (Departamenti i Strategjisë dhe Koordinimit të Donatorëve, 2013).

Aktualisht në fushën e sigurisë ushqimore ka mbi 100 akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aspekte të ndryshme të kësaj fushe dhe marrëdhëniet e saj me fushat e tjera (MBZHRAU, 2014). Duhet të bëhen përpjekje në mënyrë që standardet të njihet plotësisht nga prodhuesit e ushqimit. Kjo qasje do të sigurojë që prodhuesit të njohin cilat standarde janë të detyrueshme dhe duhet të plotësohen në mënyrë që të prodhojnë me cilësi më të lartë dhe produkte ushqimore më të sigurta që mund të pranohen në tregjet e BE-së, duke krijuar kështu mundësi më të mëdha për eksport.

Në lidhje me cilësinë dhe sigurinë e produkteve, Shqipëria po përgatit një bazë të plotë legjislative në përputhje me legjislacionin përkatës të BE. Në fushën e përafrimit të legjislacionit për futjen e mekanizmave dhe rregullave të tregut të përbashkët CMO Common Market Organisation (CMO), një ligj i rëndësishëm është miratuar kohët e fundit. Ligji nr 87/2013 “Për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit” hyrë në fuqi në shkurt 2013 me objektivin kryesor për të vendosur rregullat për kategorizimin e prodhimit, etiketimit dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit në Republikën e Shqipërisë, për të përshtatur kërkesat dhe standardet e tregut ndërkombëtar (MBUMK, 2013).

MBZHRAU, në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor, është duke u përgatitur një draft Plan Veprimi për përmirësimin e çështjeve të sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare. Plani i veprimit është i bazuar në vlerësimin e kryer mbi sistemin ekzistues dhe do të përfshijë propozime për rregullimin/rishikimin e planit të përafrimit me acquis të BE-së në vitin 2020, planin për ngritjen e kapaciteteve të menaxhimit të përgjithshëm të kontrollit të ushqimit dhe përmirësimin e rrjetit laboratorik (MBUMK, 2013)²⁴.

3.5.3.2 Zhvillimet institucionale për sigurinë ushqimore

²⁴Për legjislacionin në fushën e sigurisë ushqimore në Shqipëri, shih Aneks V.

Një nga institucionet kryesore të sigurisë ushqimore përgjegjëse për hartimin e politikave dhe strategjive të sigurisë ushqimore si dhe përgatitjen e legjislacionit sektorial në vend është Drejtoria e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (DPSUMK) e krijuar në vitin 2005 dhe riorganizuar në vitin 2010. Institucionet përgjegjëse të përfshira në menaxhimin e politikave të sigurisë ushqimore në Shqipëri dhe zbatimin e legjislacionit në këtë fushë janë MBZHRAU, AKU, ISUV, Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Pushteti vendor (MBZHRAU, 2014). Në kuadër të procesit të integritimit në fushën e ushqimit DPSUMK është institucioni kryesor në politikë-bërje dhe ka për detyrë hartimin e politikave në fushën e sigurisë ushqimore, legjislacionit dhe strategjive në këtë fushë (Cuko, 2014).

AKU është krijuar pas miratimit të ligjit të ri të Ushqimit nga Kuvendi i Shqipërisë në janar 2008²⁵. Organizimi dhe funksionimi i AKU-së është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në Tetor 2009, ndërsa agjensia u bë operative nga 1 shtator 2010. Sot ky institucion është i shtrirë në të 12 qarqet me departamentet e saj në të gjithë vendin. Në përputhje me Urdhërin e Ministrit Nr. 262, datë 25.08.2010, AKU filloi menjëherë të zbatojë detyrat e saj në lidhje me kontrollin zyrtar mbi të gjitha institucionet e ushqimit, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesave të konsumatorëve (AKU, 2014). Ngritja dhe fuqizimi i AKU është mbështetur tërësisht nga fondet e BE-së. Për këtë qëllim ekziston tashmë një institucion me rreth 450 punonjës me zyrat në Tiranë dhe në të gjitha rajonet ku janë të shpërndarë inspektorët, të cilët kryesisht kanë funksione të inspektimit për të parë se si zbatohet ligjshmëria në fushën e sigurisë ushqimore, të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve dhe një sërë ndryshimesh të tjera që lidhen me shërbimin veterinar, shërbimin këshillimor dhe të ekstensionit (Misha, 2014).

Për të rritur efikasitetin e funksioneve të tij, një projekt i IPA 2010 po mbështet AKU-në me ristrukturimin e zyrave të nevojshme dhe hapësirave laboratorike në 11 qarqet e vendit. Vënia në zbatim e legjislacionit kërkon planifikimin e kontrolleve zyrtare në përputhje me informacionin e vlerësimit të rrezikut. Kontrolle të tilla përfshijnë edhe marrjen e mostrave të produkteve ushqimore (shtazore ose me origjinë bimë) dhe analizat e tyre në laboratorët rajonalë (European Commission DGENlargement, 2013b).

3.5.3.3 Vlerësimi i progresit për sigurinë ushqimore

Progres ka pasur me krijimin e institucionit të AKU si pjesë e një programi për të krijuar sistemin e sigurisë ushqimore në Shqipëri. AKU ka për qëllim të sigurojë cilësinë e produkteve ushqimore, të mbrojtë qytetarët si dhe të ndërtojë besimin e tyre. Gjithashtu ka patur progres me politikën veterinarë në identifikimin dhe regjistrimin e bagëtive të imëta. Komisioni Europian pranoi në

²⁵ LIGJ Nr.9863, datë 28.1.2008 “PËR USHQIMIN”

raportin e progresit 2013 (f. 34-35) se Shqipëria ka bërë progres në përmirësimin e praktikave të sigurisë ushqimore, si dhe cilësia e inspektimeve të objekteve ushqimore është përmirësuar gradualisht. Megjithatë, raporti thekson se "Në fushën e sigurisë ushqimore të përgjithshme, kapacitetet e vlerësimit të riskut ende nuk janë ngritur, pavarësisht se është hedhur hapi i parë me Vendimin e Ministrisë së Bujqësisë për ngritjen e një Komiteti Shkencor të posaçëm".

Në fushën e hedhjes në treg të ushqimit për kafshët dhe njerëzit dhe të nënprodukteve shtazore ka patur progres me ritëm të ngadaltë, me përjashtim të përditësimit dhe çertifikimit të databazës së stabilimenteve ushqimore (AKUnet) që tani ka të regjistruara 17,800 njësi. Nuk ka përparim në garantimin e gjurmueshmërisë së ushqimit, për shkak se mungon imponimi i rregullave, raportimi në kohë dhe informacioni i përditësuar i lëvizjeve të kafshëve. Baza e të dhënave shëndetësore të kafshëve është zhvilluar dhe është përmirësuar regjistrimi dhe vaksinimi i tyre kundër brucelozës. Futja e procedurave dhe standardeve të reja me qëllim përafrimin me *acquis*, duhet të shoqërohet me fushata intensive sensibilizuese dhe informuese për operatorët agro-usqimorë. Me gjithë progresin e arritur në fushën e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare gjatë dhjetë viteve të fundit, shumë çështje mbeten për t'u zgjidhur. Këto janë ndër çështjet e tjera të identifikuar në Raportin e Progresit të Komisionit Europian 2012-2013.

Përveç kësaj, Rregullorja EC 854/2004 thekson në mënyrë të qartë rëndësinë e laboratorëve si pjesë thelbësore e të gjithë rrjetit kombëtar të sigurisë ushqimore dhe kontrollit në vend. Aftësia e veprimtarive të sigurisë ushqimore varet në mënyrë të konsiderueshme nga performanca dhe efektiviteti i punës laboratorike. Procesi i përafrimit të legjislacionit dhe zhvillimit të kapaciteteve institucionale në fushën e sigurisë ushqimore, veterinare dhe politikës fitosanitare, duhet të rritet duke futur një qasje më të integruar për përafrimin me *acquis*. Për sa i përket rregullave të sigurisë ushqimore, ekziston nevoja e përafrimit gradual me *acquis* të legjislacionit për kriteret bakteriologjike të qumështit të papërpunuar.

3.5.4 *Kostot dhe përfitimet e procesit të integritit për sigurinë ushqimore*

3.5.4.1 *Kostot për sigurinë ushqimore*

Përafrimi me *acquis* në sektorin bujqësor është një nga pjesët më të vështira dhe të kushtueshme të harmonizimit me legjislacionin dhe kërkesat e BE-së. Harmonizimi i legjislacionit vendas me *acquis* të BE-së dhe përafrimin me standardet e Komunitetit në fushën e higjenës, shëndetit dhe sigurisë në punë, mjedisit dhe mirëqenies së kafshëve, kërkon investime të rëndësishme në modernizimin e objekteve, forcës së punës, njohurive dhe aftësive. Një numër problemesh janë identifikuar në lidhje me zbatimin e duhur të akteve ligjore të miratuara në aspektin e standardeve minimale kombëtare të sigurisë ushqimore veterinare dhe fitosanitare - mungesa e informacionit dhe njohurive të standardeve minimale kombëtare nga fermerët dhe përpunuesit e ushqimit në një anë dhe kapaciteti i pamjaftueshëm i autoriteteve përkatëse për të kontrolluar respektimin e parimeve kombëtare minimale në anën tjetër. Për më tepër, ka nevojë për rritjen e kapaciteteve të

organeve teknike kombëtare për të vlerësuar projektet e investimeve të përfituesve potencialë në përputhje me standardet e BE. Një tjetër problem është se vetëm një pjesë e inspektorëve në terren janë trajnuar në përdorimin e sistemit dhe janë duke bërë përpjekje për të rritur përdorimin e saj dhe cilësinë e hedhjes së të dhënave (MBUMK,2013).

Zbatimi i standardeve të miratuara të sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare nuk është i plotë për shkak të dobësive të kapaciteteve të zbatimit dhe kapaciteteve të pamjaftueshme administrative për të kryer inspektimet dhe kontrollat e nevojshme. Ekziston një nevojë për të zhvilluar më tej kapacitetet për të inspektuar objektet dhe për të kontrolluar përputhshmërinë me standardet e BE-së në kuadër të zbatimit të programit IPARD II. Për më tepër duhet të punohet në vitet në vijim për të siguruar se futja e standardeve të reja të sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare, do t'i japi kohë të mjaftueshme operatorëve privatë për të përmbushur standardet dhe se inspektimet e nevojshme dhe kapacitetet e auditimit të jenë funksionale për të siguruar zbatimin efektiv. Kërkesat e rrepta të sigurisë ushqimore dhe të gjurmimit shkaktojnë një seri kostosh të reja të transaksionit për prodhuesit e vegjël pa investime të mjaftueshme të kapitalit dhe infrastrukturës publike. Shumë nga vështirësitë që prodhuesit e vegjël duhet të hasin në aplikimin e standardeve të sigurisë ushqimore kanë të bëjnë me gjurmimin ku standardet e sigurisë ushqimore kalojnë rekomandimet Codex (Codex Alimentarius Commission, 2010). Kostot e lidhura me zbatimin e sistemeve të gjurmueshmërisë përfshijnë investimet në kapital dhe infrastrukturë, mbajtjen e një arkive me të dhëna dhe përmirësimet në përpunim. Kaptullit 12 i acquis ku përfshihet siguria ushqimore, pjesa më e vështirë gjatë negociimeve është arritja e standartit. Përgatitja e standardeve të ngjashme me vendet e BE-së janë kosto shtesë në vetvete (Cuko, 2014).

Sistemet e gjurmimit janë në përgjithësi njëdrejtimshme dhe vendet eksportuese duhet të kenë sisteme të ndryshme për verifikimin dhe kontrollin nga vendet më të mëdha importuese. Kjo situatë rrit barrën administrative dhe kostot e pajtueshmërisë (Codex Alimentarius Commission, 2009).

Kosto tjetër përfaqëson mungesa e burimeve financiare kombëtare për sigurinë ushqimore (ose *problemet me përthithjen e financimit për këtë sektor*) të nevojshme për veprimet kryesore të zhvillimit të kapaciteteve që kanë të bëjnë me procesin e integritetit - të tilla si zbatimi i vazhdueshëm i trajnimeve të shërbimit civil, përkthime ligjore dhe analiza rregullatore, informimit të publikut për integrimin evropian, etj. Kosto shikohet momenti që siguria ushqimore përkthehet në kërkesa buxhetore dhe fakti që gjithmonë buxheti është i pamjaftueshëm është kostoja më e madhe e fushës. Edhe pse siguria ushqimore ka qenë gjithmonë dhe është prioritet i qeverisë nuk ka patur një rritje të buxhetit as për vitin 2014 (Cuko, 2014).

3.5.4.2 Përfitimet për sigurinë ushqimore

Përfitimet nga procesi i integrimit në BE për sigurinë ushqimore janë të shumta. Përfitim është rritja e eksporteve për shkak të përmirësimit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore, gjë që mund të ndryshojë strukturën e prodhimit dhe përpunimit drejt veprimtarive fitimprurëse. Prodhuesit dhe përpunuesit e ushqimit kanë përmirësuar praktikën e sigurisë ushqimore dhe të teknologjisë duke rritur aksesin e produkteve ushqimore shqiptare në tregjet ndërkombëtare të eksportit. Zbatimi i legjislacionit të BE në këtë fushë, ndihmon parandalimin e hyrjes ose daljes të produkteve ushqimore të pakontrolluara, duke parandaluar rreziqet shëndetësore për konsumatorët.

Përfitime të konsiderueshme nga procesi i integrimit në BE, ka patur për rritjen e kapaciteteve dhe trajnimet për personat që punojnë për sigurinë ushqimore. Përfitimet e integrimit do të jenë të dukshme në një periudhë afatgjatë, ndërsa kostot përfaqësojnë një faktor afatshkurtër. Megjithatë, investimet në sistemet e gjurmimit ofrojnë përfitime të qëndrueshme dhe stimuj për aktorët në zinxhirin e furnizimit, duke përfshirë këtu tërheqje të shpejtë të ushqimit jo të sigurt, çmimi premium për ushqime të sigurta, të qëndrueshme dhe të gjurmueshme, dhe besim më të madh të konsumatorit, ndër të tjera. Përbën shumë progres fakti që në fushën e sigurisë ushqimore është ndarë politik-bërja nga zbatimi dhe kjo ka ardhur pas miratimit të ligjit të ushqimit²⁶ që ka qenë i gjithi përafrim i rregullores europiane për ushqimin që ndau inspektimin nga politik-bërja (Cuko, 2014).

Përsa i përket burimeve njerëzore ka patur përmirësim në rritjen e kapacitetit, personeli të trajnohet në nivel ndërkombëtar nga ekspertë të huaj. Një mbështetje e madhe është programi TAIEEX (Technical Assistance and Information Exchange) i cili përgatit çdo vit plane vjetore trajnimi dhe këtë vit plani që është miratuar për ne është më i madhi nga të gjitha vitet e tjera dhe janë planifikuar gjithashtu që ekspertë të tyre të vijnë të punojnë në ministri duke rritur kështu dhe cilësinë e punës (Cuko, 2014).

3.5.4.3 Skicimi i së ardhmes për sigurinë ushqimore

Tregtia e produkteve kryesisht bujqësore me BE-në do të jetë e mundur vetëm nëse garantohet siguria ushqimore, por kjo është një sfidë shumë e madhe pasi jo të gjitha produktet bujqësore janë në gjendje për të përmbushur kërkesat e BE. Shqetësimi kryesor në këtë drejtim është sistemi i të ashtuquajturave "pikat e therjes" (kasapëve në oborrin e shtëpisë ose pranë rrugëve).

²⁶ Ligj Nr.9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin"

Shqipëria, si dhe vendet e tjera në rajon, po punon të përmbushë dhe të demonstrojë përputhshmërinë me rregulloret e sigurisë ushqimore të BE-së dhe kërkesave sanitare dhe fitosanitare. Edhe pse ky proces ka hapur mundësi të reja për të promovuar zhvillimin ekonomik nëpërmjet tregtisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore, dobësitë e brendshme në sistemin e kontrollit të ushqimit e kufizojnë seriozisht këtë potencial.

Një hap në të ardhmen, do të jetë sigurimi i një rrjeti funksional të laboratorëve të sigurisë ushqimore si pjesë e sistemit të kontrollit të ushqimit, organizuar dhe përshtatur me nevojat e BE-së. Kjo përfshin akreditimin, sigurimin e rrjetit laboratorik të cilësisë për të krijuar një rrjet të laboratorëve të sigurisë së ushqimit, përhapur në të gjithë Shqipërinë duke marrë në konsideratë dallimet gjeografike dhe për të shmangur mbivendosjen e aktiviteteve. Përafrimi i plotë i legjislacionit të vendit me kapitujt 11 dhe 12 të *acquis* të BE dhe zbatimi nga institucionet përgjegjëse është një tjetër hap i rëndësishëm në procesin e integritetit në BE.

Në të ardhmen, objektivi kryesor për sektorin shqiptar të bujqësisë dhe ushqimit dhe nivelin e mbrojtjes së konsumatorëve do të jetë përgatitja dhe organizimi për anëtarësimin në BE. Duhet të përgatiten zinxhirët shqiptarë agro-ushqimor për gjurmueshmërinë e plotë të të gjitha llojeve të ushqimit. Sektori bujqësor, veçanërisht pjesa e prodhimit të përgjithshëm për eksport duhet të jetë plotësisht në përputhje me rregullat e BE-së. Pjesa e produkteve bujqësore dhe ushqimore të përpunuara për eksport, duhet të rritet në mënyrë të qëndrueshme si edhe ka shumë rëndësi fuqizimi i mëtejshëm i institucioneve përgjegjëse për sigurinë ushqimore.

Duhet trajnuar edhe konsumatori që pavarësisht se ka marrë një produkt të shëndetshëm dhe të sigurtë, nëse nuk e ruan në kushte të sigurta dhe nuk e trajton ashtu siç duhet para konsumimit, atëherë, nuk ka më produkt të sigurtë. Fushatat e ndërgjegjësimit janë mjaft të rëndësishme, që të mos blihen produkte të pakontrolluara (Cuko, 2014). Gjithashtu duhet të bëhet ndërgjegjësimi i operatorëve të biznesit të ushqimeve me rregullat e reja higjienike, dhe harmonizimi i ushqimit dhe stabilizimit të ushqimore me standardet e BE. Këto janë disa nga sfidat e të ardhmes së këtij sektori.

3.6 Perceptimet dhe shpjegimet e aktorëve të përfshirë: Një analizë cilësore

3.6.1 Perspektivat e sektorit privat për kostot dhe përfitimet e procesit të integritetit

Ky seksion paraqet përmbledhjen e perceptimeve dhe shpjegimeve të përfaqësuesve të sektorit privat sa i takon kostove dhe përfitimeve të procesit të integritetit të mbledhura përmes intervistave

të thelluara²⁷. Përfaqësuesit e sektorit privat në Shqipëri argumentojnë se përfitimet e procesit të integrimit europian deri më tani kanë qenë kryesisht në këto drejtime kryesore: përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullues; të mirat dhe shërbimet; puna dhe kapitali; efica e kompanive si dhe kërkimi dhe inovacioni. Në të njëjtën kohë, analiza tregon se procesi i integrimit europian dhe perspektiva për anëtarësimin në Bashkimin Europian merret si e vetmja alternative zhvillimi në këndvështrimin e sektorit privat dhe si e tillë është e nevojshme të pranohen si përfitimet edhe kostot që vijnë me të. Megjithatë, vlerësohet se deri më tani është herët të shfaqen plotësisht kostot e procesit të integrimit europian, të cilat do të ndihen më shumë me thellimin e procesit dhe me fillimin e negociatave për anëtarësim. Për këtë arsye, një nga rekomandimet e sektorit është zhvillimi i kapaciteteve të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe informimi i plotë i sektorit për efektet dhe sidomos kostot e marrjes së statusit kandidat dhe përfundimisht të anëtarësimit në BE.

Në perspektivën e sektorit privat disa nga përfitimet kryesore të procesit të integrimit janë së pari përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullues në vend përmes përafrimit të legjislacionit dhe vendosjes së të njëjtave standarde si në BE. Megjithatë, standardet e përbashkëta nuk ofrojnë vetëm përfitime për funksionimin e sektorit dhe efica e kompanive, por nënkuptojnë edhe kosto të larta për tu përballuar. Për më tepër vetë procesi i përafrimit të legjislacionit është i kushtueshëm dhe ajo çka është vënë re është një përgatitje e legjislacionit në letër dhe sfida me zbatimin praktik. Një element tjetër përfitimi është edhe rregullimi i funksionimit të tregut, liberalizimi dhe përcaktimi i politikës së konkurrencës së lirë si dhe mbrojtja e saj përmes ligjeve dhe standardeve të BE-së. Megjithatë liberalizimi i tregut nuk lidhet vetëm me MSA-në dhe efektet e saj, por së pari me nënshkrimin e marrëveshjes me OBT-në në vitin 2000. Në këtë drejtim kostot kanë të bëjnë me lehtësinë e hyrjes në treg të konkurrentëve, përballja me tregje të konsoliduara dhe standarde shumë të larta. Gjithashtu, analiza tregon se një nga kostot në këtë drejtim është mospërputhja mes liberalizimit të tregut dhe përafrimit të legjislacionit me standardet e jetesës si dhe me vizionin e zhvillimit të shoqërisë shqiptare. Megjithatë më tepër sesa kostot e procesit të integrimit, këto janë kufizime të brendshme të kontekstit politik dhe social në vend.

3.6.2 Perspektivat e politikbërësve për kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit

Në mënyrë të ngjashme me sektorin privat, analiza e intervistave të thelluara me përfaqësues të institucioneve qeveritare²⁸ sa i takon kostove dhe përfitimeve të procesit të integrimit europian, tregon se ky proces është i mirëpranuar si e vetmja alternativë për modelin politik dhe ekonomik në vend dhe si i tillë duhet pranuar që mbart krahas përfitimeve edhe kosto. Në një vlerësim të përgjithshëm për të gjithë procesin, përfaqësuesit e institucioneve qeveritare argumentojnë se procesi i integrimit europian ka pasur më shumë përfitime sesa kosto, të paktën deri në këtë fazë. Sa i takon përfitimeve, analiza e të dhënave tregon se procesi i integrimit europian ka shërbyer si një shtysë e fortë për zhvillimin e institucioneve në vend; koordinimin ndërinstitutional; ngritjen e institucioneve të reja që sigurojnë ruajtjen e standardeve të përbashkëta me BE-në; përafrimin e

²⁷ Shih Aneks VII Perceptimet e sektorit privat për kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit

²⁸ Shih Aneks VIII Perceptimet e sektorit publik për kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit

legjislationit; hapjen e vendimmarrjes përkundrejt aktorëve të tjerë shoqërorë dhe rritjen e llogaridhënies; përmirësimin e burimeve njerëzore dhe shtimin e kapaciteteve përthithëse të fondeve.

Sa i takon kostove të procesit të integritimit, përfaqësuesit e institucioneve qeveritare identifikojnë si koston më të lartë koston financiare të përafrimit të legjislationit dhe përputhshmërinë me kontekstin shqiptar, ngritjen e instrumentave për zbatueshmërinë e legjislationit dhe zhvillimin e kapacitetit njerëzor. Megjithatë, analiza e plotë e procesit tregon se një pjesë e mirë e kësaj kostoje është mbartur financiarisht nga Komisioni Europian përmes programeve të asistencës si PHARE, CARDS, EURALIUS, PAMECA dhe IPA. Një kosto tjetër e identifikuar nga përfaqësuesit e institucioneve qeveritare është krijimi i varësisë ndaj kushtëzimeve të BE-së duke çenuar kështu krijimin e një kulture qëndrueshmërie dhe të qenësishme të hartimit të politikave dhe proceseve që burojnë nga brenda dhe jo të kushtëzuara nga presioni i jashtëm.

3.6.3 Qasja kritike për kostot dhe përfitimet e procesit të integritimit nën optikën e ekspertëve

Analiza e perceptimeve të ekspertëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile²⁹ që janë të angazhuar në veprimtarinë e tyre në proceset e integritimit europian mbështet qëndrimin e sektorit privat dhe publik se integrimi europian është tashmë ‘*e vetmja lojë në qytet*’, ose ndryshe ‘*alternativa e vetme e zhvillimit të Shqipërisë*’ dhe si i tillë për të gjithë aktorët si edhe për qytetarët duhet të jetë e qartë se loja luhet sipas rregullave të BE-së dhe si e tillë mbart edhe kosto për të cilat është e nevojshme zhvillimi i aftësive negociuese të Shqipërisë si dhe informimi i plotë i të gjithë sektorëve lidhur me efektet e procesit si dhe të anëtarësimit. Edhe pse ky projekt kërkimor nuk ndalet në dinamikën e ligjërimit politik rreth integritimit europian dhe as në pasojat që vijnë duke e konsideruar perspektivën e anëtarësimit si ‘*alternativën e vetme të zhvillimit të Shqipërisë*’, autorët paraqesin një analizë kritike të procesit për të mos e marrë si të mirëqenë. Gjithashtu, në ndryshim nga perspektiva e sektorit privat dhe institucioneve qeveritare, ekspertët dhe/ose përfaqësues të shoqërisë civile paraqesin një tablo më kritike dhe më të thellë të kostove dhe përfitimeve të procesit të integritimit. Analiza e tyre nuk ndalet vetëm tek kostot dhe tek përfitimet, por edhe tek disa kufizime të brendshme të kontekstit politik, social, kulturor dhe ekonomik në Shqipëri. Kështu disa nga problematikat e identifikuar nuk janë aq kosto të procesit të integritimit europian, sesa problematika të qenësishme të mënyrës sesi funksionon sistemi politik në Shqipëri, tregu dhe shoqëria.

Në mënyrë të ngjashme me analizën e gjetjeve të perspektivave të sektorit privat dhe institucioneve qeveritare, edhe në këtë rast argumentohet se përfitimi i parë dhe i drejtpërdrejtë i procesit të integritimit është kuadri ligjor përmes: përafrimit të legjislationit; vendosjen e standardeve të përbashkëta; asistencës financiare dhe ndërtimin e kapaciteteve për çështjet e brendshme dhe të sigurisë. Kostoja më e madhe këtu është ajo e përafrimit të legjislationit dhe dinamika e zbatueshmërisë dhe përputhjes me kontekstin.

²⁹ Shih Aneks IX Perceptimet e ekspertëve/shoqërisë civile për kostot dhe përfitimet e procesit të integritimit

Një drejtim tjetër në të cilin Shqipëria ka përfituar nga procesi i integrimit është ai i funksionimit të institucioneve në terma të: zhvillimit të kapaciteteve institucionale dhe njerëzore përmes programeve të asistencës; koordinimin ndërinstitutional më të plotë; shtysën për pavarësinë e institucioneve; intensitetin dhe shpejtësinë e përmirësimit të cilësisë së funksionimit të institucioneve dhe kapacitetin e tyre teknik. Në këtë drejtim edhe kostot janë të larta si: komunikimi i brendshëm institucional është çënuar nën presionin e kryerjes së proceseve shpejt e shpejt e sipas kushteve të BE-së; ndërlidhja e qenësishme mes vullnetit dhe vendimmarrjes politike me proceset teknike e politikëbërëse në nivele të tjera institucionale; procesi i integrimit si më shumë teknik dhe ekzekutiv dhe mund të çënojë balancën dhe pavarësinë e institucioneve nëse instrumentalizohet nga aktorët politik. Sfidat në funksionimin e institucioneve shoqërohen jo vetëm me kostot e procesit të integrimit, por edhe me kufizime të brendshme si: qëndrueshmëria e kapaciteteve njerëzore në institucione me rotacionet politike e cila çënon edhe qëndrueshmërinë e investimit nga BE-ja përmes programeve të asistencës; pa shtysën e procesit të integrimit, intensiteti dhe shpejtësia nuk do kishin qenë në të njëjtin ritëm, por nga ana tjetër këto ndryshime nuk vijnë si kërkesë e brendshme, por si presion nga jashtë; prioritetet politike nuk përkthehen në investime reale, politike, as buxhetore, as administrative brenda këtyre institucioneve.

Sa i takon demokratizimit dhe dialogut politik, Shqipëria vlerësohet të ketë përfituar nga procesi i integrimit në këto aspekte: fuqizimi i aktorëve politik; përmirësim i proceseve demokratike (zgjedhjet) dhe ndërmjetësim në zgjidhjen e situatave të polarizuara; vendosjen e një kornize bazë për llogaridhënien dhe transparencën në vendimmarrje; procesi ka shërbyer si nxitës i reformave për dialogun politik; integrimi europian ofron modelin e zhvillimit politik, institucional, ekonomik dhe shoqëror; komunikimi dhe hapja me Europën dhe rritja e ndjesisë së përkatësisë në vlerat europiane i kanë shërbyer zhvillimit të shoqërisë shqiptare; integrimi europian është proces i vazhdueshëm kushtëzimi, negocimi, përafrimi dhe thellimi që ndihmon demokratizimin. Kostot kryesore sa i takon demokratizimit dhe dialogut politik janë: kushtëzimi politik krijon varësi të aktorëve dhe institucioneve kundrejt atyre të BE-së; Parlamenti Europian (grupim politik) nuk ka dalë gjithmonë me një qëndrim të përbashkët dhe kjo ka thelluar polarizimin në arenën politike në Shqipëri. Megjithatë, problematika më e madhe këtu nuk vjen nga kostot në vetvehte, sesa nga instrumentalizimi i procesit nga aktorët politik, komunikimi politik i personalizuar dhe në llogore të ndryshme, fitimi i një farë 'imuniteti' ndaj kushtëzimit të BE-së.

Sa i takon cilësisë së politikëbërjes, vendimmarrjes dhe llogaridhënies vlerësohen si përfitime shtysat dhe presioni i BE-së për të krijuar institucionet, kuadrin ligjor dhe mekanizmat për procese konsultimi me aktorët e tjerë në shoqëri. Përfitime në këtë drejtim janë: proces konsultativ nën shtysën e BE-së sa i takon politikave/strategjive – konsultim dhe monitorim; zgjidhja e krizave të brendshme përmes ndërmjetësimit të institucioneve të BE-së; shtysa pozitive për përgatitjen e dokumentave strategjikë; rritja e aksesit në informacion për qytetarët dhe krijimi i kulturës dhe praktikës së punës së llogaridhënies; përforsim i rolit të aktorëve të shoqërisë civile në kërkesat për llogaridhënie përmes instrumentave formalë dhe jo formalë; rritja e vetëdijes së qytetarëve për kufinj të institucioneve dhe rritjen e kërkesës së llogaridhënies; strukturat formale për zhvillimin e integruar në nivel vendor. Megjithatë, presioni i jashtëm i realizimit të proceseve konsultative dhe monitoruese ka sjellë një mungesë të pronësisë së tyre, e cila do të ishte më e qartë nëse proceset do kishin ndodhur gradualisht dhe si një nevojë e brendshme. Gjithashtu, konsultimi me grupet e interesit dhe shoqërinë civile shpesh nuk është i qenësishëm, por i bërë shpejt e shpejt për shkak të pranisë së përfaqësuesve të BE-së apo nevojës për të raportuar.

I. KAPITULLI PËRMBYLLËS

4.1 Përfundimet e projektit kërkimor

Projekti kërkimor bën një analizë të kostove dhe përfitimeve politike dhe ekonomike të procesit të integrimit në Bashkimin European për Shqipërinë, duke u ndalur në fusha specifike si tregtia e lirë, konkurrenca, rritja ekonomike, bujqësia dhe siguria ushqimore si dhe në pikëpampjen politike dhe institucionale. Projekti kërkimor ofron një analizë sistematike të bazuar në kombinimin e qasjes metodologjike sasiore dhe cilësore në fushat e përzgjedhura për tu studiuar. Kështu projekti ndihmon në rritjen e informimit dhe ekspertizës vendase për çështjet e integrimit dhe fushat specifike. Kjo do të sjellë një përmirësim dhe orientim të debatit publik si dhe do të nxisë ritmin e reformave integruese.

Kostot dhe përfitimet në aspektin politik dhe institucional nuk mund të shihen veçse në terma afatmesëm dhe afatgjatë në lidhje me atë që është tashmë *‘e vetmja lojë në qytet’*, ose ndryshe *‘alternativa e vetme e zhvillimit të Shqipërisë’*— integrimi në BE. Kur flitet për PSA-në, MSA-në, lëvizjen e lirë në zonën Shengen, apo marrjen e statusit të vendit kandidat, përveç simbolikës që lidhet me momente dhe data të caktuara, në terma politik është procesi ai që fiton rëndësi. Në këto kushte, procesi i integrimit në BE i ka ndikuar institucionet, demokratizimin, dialogun politik dhe politikbërjen në Shqipëri në aspektin formal dhe përmbajtësor si në terma kostosh ashtu dhe përfitimesh.

Përfitimet:

Në terma formal, sidomos gjatë intervistave të thelluara, u vu re se aktorët e përfshirë në proces nënvizuan anën normative të procesit, sidomos përmirësimin e kuadrit legjislativ; vendosjen e standardeve të përbashkëta; asistencës financiare dhe ndërtimin e kapaciteteve për çështjet e brendshme dhe të sigurisë. Në aspektin normativ, përafrimi i legjislacionit është ndoshta dhe arritja më e matshme në terma sasior, ndërkohë që përshtatja me kontekstin vendor dhe zbatueshmëria e tij ka përbërë dimesnionin më problematik të kuadrit legjislativ.

Po në aspektin formal, procesi është shoqëruar edhe me një sofistikim të aspektit burokratik (në kuptimin e drejtpërdrejtë dhe pa konotacion negativ) duke qënë se procesi është shoqëruar me ngritjen e një serie strukturash dhe institucioneve të reja në shërbim si të qytetarëve dhe aktorëve të përfshirë në proces (shoqëria civile, grupet e interesit, etj) por edhe në shërbim të koordinimit ndërinstitutional dhe mbarëvajtjes së vetë procesit. Shembulli më konkret është ngritja e Ministrisë së Integrimit European dhe të gjithë strukturave që lidhen me integrimin në BE nëpër institucione të tjera.

Në terma përmbajtësor, analiza e të dhënave tregon se procesi i integrimit european ka shërbyer si një shtysë e fortë për zhvillimin e institucioneve në vend; koordinimin ndërinstitutional; ngritjen e institucioneve të reja; hapjen e vendimmarrjes përkundrejt aktorëve të tjerë shoqërorë dhe rritjen e llogaridhënies; përmirësimin e burimeve njerëzore dhe shtimin e kapaciteteve përthithëse të fondeve.

Një drejtim tjetër në të cilin Shqipëria ka përfituar nga procesi i integrimit është ai i funksionimit të institucioneve në terma të: zhvillimit të kapaciteteve institucionale dhe njerëzore përmes programeve të asistencës; koordinimin ndërinstitutional më të plotë; shtysën për pavarësinë e

insitucioneve; intensitetin dhe shpejtësinë e përmirësimit të cilësisë së funksionimit të institucioneve dhe kapacitetin e tyre teknik.

Sa i takon demokratizimit dhe dialogut politik, Shqipëria vlerësohet të ketë përfituar nga procesi i integrimit në këto aspekte: fuqizimi i aktorëve politik; përmirësim i proceseve demokratike (zgjedhjet) dhe ndërmjetësim në zgjidhjen e situatave të polarizuara; vendosjen e një kornize bazë për llogaridhënien dhe transparencën në vendimmarrje; procesi ka shërbyer si nxitës i reformave për dialogun politik. Integrimi evropian ofron modelin e zhvillimit politik, institucional, ekonomik dhe shoqëror. Komunikimi dhe hapja me Europën dhe rritja e ndjenjës së përkatësisë në vlerat europiane i kanë shërbyer zhvillimit të shoqërisë shqiptare; integrimi evropian është proces i vazhdueshëm kushtëzimi, negocimi, përafrimi dhe thellimi që ndihmon demokratizimin.

Sa i takon cilësisë së politikëbërjes, vendimmarrjes dhe llogaridhënies vlerësohen si përfitime shtysat dhe presioni i BE-së për të krijuar institucionet, kuadrin ligjor dhe mekanizmat për procese konsultimi me aktorët e tjerë në shoqëri. Përfitime në këtë drejtim janë: proces konsultativ nën shtysën e BE-së sa i takon politikave/strategjive – konsultim dhe monitorim; zgjidhja e krizave të brendshme përmes ndërmjetësimit të institucioneve të BE-së; shtysa pozitive për përgatitjen e dokumentave strategjikë; rritja e aksesit në informacion për qytetarët dhe krijimi i kulturës dhe praktikës së punës së llogaridhënies; përforsim i rolit të aktorëve të shoqërisë civile në kërkesat për llogaridhënie përmes instrumentave formalë dhe jo formalë; si dhe ngritja e strukturave formale për zhvillimin e integruar në nivel vendor.

Kostot:

Sa i takon kostove të procesit të integrimit, përfaqësuesit e institucioneve qeveritare identifikojnë si koston më të lartë koston financiare të përafrimit të legjislacionit dhe përputhshmërinë me kontekstin shqiptar, ngritjen e instrumentave për zbatueshmërinë e legjislacionit dhe zhvillimin e kapacitetit njerëzor.

Një kosto tjetër e identifikuar nga përfaqësuesit e institucioneve qeveritare është krijimi i varësisë ndaj kushtëzimeve të BE-së duke çenuar kështu krijimin e një kulture qendrueshmërie dhe të qenësishme të hartimit të politikave dhe proceseve që burojnë nga brenda dhe jo të kushtëzuara nga presioni i jashtëm.

Nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, një seri kostosh janë identifikuar si: komunikimi i brendshëm institucional është çenuar nën presionin e kryerjes së proceseve në mënyrë të përshpejtuar sipas kushteve të BE-së; është çenuar ndërlidhja e qenësishme mes vullnetit dhe vendimmarrjes politike me proceset teknike e politikëbërëse në nivele të tjera institucionale; procesi i integrimit si më shumë teknik dhe ekzekutiv dhe mund të çenojë balancën dhe pavarësinë e institucioneve nëse instrumentalizohet nga aktorët politik.

Kostot kryesore sa i takon demokratizimit dhe dialogut politik janë: kushtëzimi politik krijon varësi të aktorëve dhe institucioneve kundrejt atyre të BE-së; Parlamenti Evropian (grupim politik) nuk ka dalë gjithmonë me një qëndrim të përbashkët dhe kjo ka thelluar polarizimin në arenën politike në Shqipëri. Megjithatë, problematika më e madhe këtu nuk vjen nga kostot në vetvehte, sesa nga instrumentalizimi i procesit nga aktorët politikë, komunikimi politik i personalizuar dhe në llogore të ndryshme, fitimi i një farë ‘imuniteti’ ndaj kushtëzimit të BE-së.

Në lidhje me politikëbërjen, vendimmarrjen dhe llogaridhënien, presioni i jashtëm i realizimit të proceseve konsultative dhe monitoruese ka sjellë një mungesë të pronësisë së tyre lokale, e cila do të ishte më e qartë nëse proceset do kishin ndodhur gradualisht dhe si një nevojë e brendshme. Gjithashtu, konsultimi me grupet e interesit dhe shoqërinë civile shpesh nuk është i qenësishëm, por i bërë shpejt e shpejt për shkak të pranisë së përfaqësuesve të BE-së apo nevojës për të raportuar.

Përmbledhje e përfitimeve dhe kostove të procesit të integritimit në BE në fushën ekonomike



Rritja e volumeve tregtare me vendet e BE-së dhe ulja relative e çmimit;

Rritja e investimeve të huaja dhe të vendit;

Rritja e efikasitetit dhe e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare;

Një rritje më e lartë ekonomike në terma afatmesme disa vjet para dhe pas hyrjes në BE;

Reforma të kushtueshme për ristrukturimin e industrive inefficente;

Papunësi në sektorët që ristrukturohen;

Shpenzime të larta buxhetore për pagesa papunësie dhe rikualifikim;

Rritje e volumeve tregtare në disa raste me vende që prodhojnë me kosto më të larta;

Lëvizja e lirë e shërbimeve




Përmirësim i klimës së biznesit si dhe lehtësim të procedurave dhe mekanizmave të regjistrimit etj.;

Lëvizja e lirë e shërbimeve përfshin edhe marrësit e shërbimeve dhe si rrjedhojë shtimi i turistëve të huaj do të jetë në përfitim të sektorit të turizmit edhe ekonomisë;


Rritja e konkurrencës që do të sjell cilësi më të mirë të shërbimeve dhe çmime më të ulta;

Hapja e tregut të shërbimeve do të ekspozojë kompanitë shqiptare ndaj konkurrentëve të huaj (kompani më të mëdha dhe risku mund të jetë i lartë i mos përballimit me sukses të kompanisë)

Lëvizja e lirë e kapitalit



Konkurrenca



Përmbledhje e përfitimeve dhe kostove të procesit të integritimit në BE në fushën e bujqësisë



Më shumë fonde për bujqësinë nga BE-ja që çon në zhvillim dhe rritje investime në bujqësi; Përqasja në tregun e brendshëm të BE-së dhe përmirësim i standardeve; Zhvillim i kapaciteteve dhe burimeve njerëzore si dhe shtim i Know How me BE-në; Produkte më cilësi më të mira, të sigurta dhe sipas standardeve europiane; Procedura efikase të prodhimit në bujqësi;	Rritja e shpenzimeve për modernizimin e prodhimit; Kostot e krijuara nga zbatimi i standardeve europiane dhe ndërtimi i institucioneve specifike; Riparimi i një sërë standardesh minimale kombëtare në procesin drejt standardeve të BE. Kërkesat për infrastrukturë dhe objekte për sektorin e bujqësisë Liberalizimi i tregtisë dhe konkurrencë për produktet vendase)
--	--

Shënim:

Fondet në bujqësi varën nga kapaciteti përthithës në vend si dhe njohuritë dhe aftësia e personelit, thelbësore për suksesin e procesit të integrimit Europian.

Përmbledhje e përfitimeve dhe kostove të procesit të integrimit në BE në sigurinë ushqimore



Rritja e fondeve nga BE-ja dhe projekte të tjera në vazhdim; Zhvillimi e kapaciteteve vendase; Mbështetja ndërkombëtare për sigurinë ushqimore; Adoptimi i standardeve të ushqimit të BE-së, pra produkte më të sigurta; Mundësohet gjurmueshmëria e produkteve ushqimore; Qasja me tregjet ndërkombëtare (përmirëson standardizimin).	Aplikimi i standardeve të sigurisë ushqimore sjell kosto për prodhuesit vendas; Tregtia bujqësore has në vështirësi në përballimin e konkurrencës dhe rritjes së standardeve e rrjedhimisht kostove; Gjurmueshmëria përfshin investime në kapital dhe infrastrukturë dhe shton kostot; Kapaciteti absorbues i fondeve nga autoriteteve duhet të garantohet.
--	---

Shënim: Kapacitete të pamjaftueshme administrative për zbatimin e acquis dhe standardeve europiane si dhe kosto të larta legjislativë dhe institucionale të krijuara nga nevoja për të zbatuar acquis sikurse edhe në fushat e tjera.

4.2 Kërkimi i mëtejshëm

Kjo analizë e paraqitur më sipër nuk është e zauruesë dhe tërësore, përkundrazi paraqet një përpjekje për të studiuar në mënyrë sistematike, rigorozë e bazuar në metodologji kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit, pra është një analizë, ndërkohë që mund dhe duhet të bëhen shumë të tjera në vazhdim. Kështu, ky projekt sugjeron se analiza e kostove dhe përfitimeve të procesit të integrimit duhet të përfshijë kontrollin për rolin e aktorëve shtetërorë, jo shtetërorë dhe qytetarët; kontrollin për mekanizmat dhe instrumentat e BE-së; konteksti ekonomik, politik dhe socio-kulturor në Shqipëri; kostot e përafrimit të legjislativës; ndikimi i liberalizimit me OBT-në dhe kontrolli për efektet e globalizimit. Për më tepër ashtu sikurse tregojnë edhe gjetjet e projektit, është e nevojshme të analizohen edhe kufizimet e brendshme të mjedisit politik, social dhe ekonomik pasi jo të gjitha kostot i atribuohen domosdoshmërisht procesit të integrimit.

Në fushën ekonomike, ky raport sugjeron disa pista studimesh të mëtejshme, si më poshtë: analiza e flukseve tregtare do të pasurohet shumë nëse do të zbatohet edhe në nivel mikro, dmth. duke zbatuar të njëjtën metodologji për secilën kategori importesh dhe eksportesh. Efektet potenciale të integrimit evropian në rritjen ekonomike dhe në fushën e integrimit financiar do të materializohen më tej teksa Shqipëria t'i afrohet anëtarësimit të plotë në BE, prandaj studime të mëtejshme është mirë të fokusohen në këto drejtime. Do të ishte me shumë vend një studim i thelluar për procesin M&A dhe ristrukturimin industrial të Shqipërisë si edhe për efektet e këtij procesi në konkurrueshmërinë e sektorëve të ekonomisë shqiptare. Nga ana tjetër problematika e sektorëve, industrive dhe firmave që mbyllen për shkak të procesit të M&A meriton studime të mëtejshme.

BIBLIOGRAFIA

Acharya, R., J.-C. Crawford, M. Maliszewski and C. Renard (2011) 'Landscape', chapter in J.-P. Chauffour and J.-C. Maur (eds) *Preferential Trade Agreement Policies for Development: A Handbook*, World Bank Publications, Washington, DC.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit AKU (2013). Marrë nga: http://www.aku.gov.al/aku/?page_id=156

Anastasakis, O. and D. Bechev (2007). EU Conditionality in South East Europe: Bringing Commitment to the Process. *South East European Studies Programme, European Studies Centre, University of Oxford*, 2007.

Bank of Albania (2012), Annual Report 2012. The Albanian Economy. Tirana: Bank of Albania, 2012. Available from: http://www.bankofalbania.org/web/Annual_Report_2012_6609_2.php Accessed [18 December 2013]

Bank of Albania (2012), Annual Report 2012., H. (2005) 'Growth effects of economic integration: evidence from the EU member states'

Badinger states', *Weltwirtschaftliches Archiv*, 141 (1): 50–78.

Badinger, H. (2008) 'Technology- and investment-led growth effects of economic integration: a panel cointegration analysis for the EU-15 (1960–2000)', *Applied Economics Letters*, 15 (7):557–61.

Badinger, H. (2005) 'Growth effects of economic integration: evidence from the EU member states'

Badinger, H. (2007) 'Has the EU's Single Market programme fostered competition? Testing for a decrease in mark-up ratios in EU industries', *Oxford Bulletin of Economics and Statistics*, 69 (4): 497–519.

Baldwin, R. (1989) 'The growth effects of 1992', *Economic Policy*, 9: 247– 82.

Baldwin, R. and E. Seghezza (1998) 'Regional integration and growth in developing nations', *Journal of Economic Integration*, 13 (3): 367–99.

Baldwin, R. and C. Wyplosz (2012) 'Ekonomiksi i Integritimit Europian', botim i Mediaprint, Tiranë, Prill 2013.

Börzel, T., and Risse, T. (2003) *Conceptualising the Domestic Impact of Europe* In K. Featherstone and C. M. Radaelli (eds), *The Politics of Europeanization*, Oxford, Oxford University Press.

Consumer Complaints Management System CCMS (2007) *Strategy on Consumer Protection and Market Surveillance 2007-2013*. Available from: http://www.kmk.al/cpcEN/pdf/Consumer%20Protection%20Strategy%20of%20Albanian%20Government_2007-2013_English.pdf

Council of the European Union (2006a). Stabilisation and Association Agreement between the European Communities and their Member States, of the one part, and the Republic of Albania, of the other part, 22 May 2006. Brussels. Available from: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/st08164.06_en.pdf

Council of the European Union (2006b) Interim agreement on trade and trade-related matters between the European community, of the one part, and the Republic of Albania, of the other part, Brussels, 22 May 2006 8154/06 COWEB 73 Available from: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/st08154.06_en.pdf

Council of the European Union (2006). *Interim Agreement on Trade and Trade-Related Matters between the European Community, of the one Part, and the Republic of Albania, of the other Part*, 22 May. Brussels.

Commission (1996) The 1996 Single Market Review: Background Information for the Report to the Council and European Parliament, Commission Staff Working Paper, Brussels. Shkarkojeni nga http://europa.eu.int/comm/internal_market/en/update/impact/index.htm

(Codex Alimentarius Commission)2009. Report CAC/32 INF/14. “International Seminar on Setting Food Safety Standards, Effects on International Trade, Particularly for Developing Countries: The Hague, The Netherlands, June 9–12, 2008.” Rome.

(Codex Alimentarius Commission)2010. “Considerations of the Impact of Private Standards.” 33rd Session of the Codex Alimentarius Commission, Geneva, July 5–9, 2010.

Cuko, L (2014). Interviste me Drejtorine e Sigurise Ushqimore ne Ministrine e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Tirane

Department of Strategy and Donor Coordination (2009). National Strategy for Development and Integration 2007-2013. Available from: <http://www.dsdc.gov.al/?crd=0,3,0,0,7&ln=Lng2>

Department of Strategy and Donor Coordination. (2013) Revised draft of NSDI 2014-2020 – 2013 Available from: http://www.dsdc.gov.al/dsdc/pub/130729_ndsi_2014_2020_version_5_1595_1.pdf

DG Agriculture and Rural Development (2014a), Albania. Agriculture and Enlargement country profile. Available from: http://ec.europa.eu/agriculture/enlargement/countries/albania/profile_en.pdf

DG Agriculture and Rural Development (2014b) Agriculture and Rural development Albania - Agriculture and Enlargement country profile. Available from: <http://ec.europa.eu/agriculture/enlargement/countries/albania>

EFSA (2012). IPA - Pre-accession programme. Available from: <http://www.efsa.europa.eu/en/networks/euenlargement.htm>

European Commission (2011). Albania 2011 Progress Report and Enlargement Strategy and Main Challenges 2011-2012. Brussels.

European Commission (2012). Commission Implementing Decision on adopting a National Programme for Albania under the IPA -Transition Assistance and Institution Building component for the year 2012. Available from: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/ipa/2012/ipa_national_programme_albania_2012.pdf

European Commission - Enlargement (2009). Countries Available. from: http://ec.europa.eu/enlargement/countries/index_en.htm

European Commission (n/a). *EU-Albania Relations*. Nga http://ec.europa.eu/enlargement/potential-candidate-countries/albania/eu_albania_relations_en.htm.

European Commission - Enlargement (2013a). Enlargement Instrument for Pre-accession assistance (IPA) Albania - financial assistance. Available from: http://ec.europa.eu/enlargement/instruments/funding-by-country/albania/index_en.htm

European Commission-Enlargement (2013b), Commission Implementing Decision adopting a National Programme for Albania under the IPA Transition Assistance and Institution Building Component for the year 2013. Available from: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/ipa/2013/centralised/ipa_2013_024190_national_programme_for_albania.pdf

European Commission (2011a). Albania 2011 Progress Report and Enlargement Strategy and Main Challenges 2011-2012. Brussels.

European Commission (2011b). Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA) Multi-annual Indicative Planning Document (MIPD) 2011-2013 Albania http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/mipd_albania_2011_2013_en.pdf

European Commission EC (2007) Instrument for Pre-accession Assistance (IPA)Albania Multi-annual Indicative Planning Document 2007 – 2009. Decision On a multi-annual indicative planning document (MIPD) 2007-2009 for Albania C(2007)2245 of 31/05/2007 Available from: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/mipd_albania_2007_2009_en.pdf

European Economy (2001) Supplement A, No. 12, December. Kjo përmban shumë fakte në lidhje me procesin e M&A. Shkarkoheni nga http://europa.eu.int/comm/economy_finance/publications/supplement_a_en.htm

FAO (2012). Pan-European Conference on Food Safety and Quality Food Quality and Safety Activities in Albania. Available from: <http://www.fao.org/docrep/meeting/004/ab503e.htm>.

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (2011). Raporti i Monitorimit Qytetar 2011: Plan i Veprimit për adresimin e 12 prioritetëve të opinionit të Komisionit Evropian. Nga <http://www.soros.al/2010/foto/uploads/File/Raporti%20Final%20-%202012%20Prioritetet%20-%20Shqip.pdf>.

Gjeci, G (2014). Interviste me Drejtorin e Autoritetit Menaxhues në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Tirane

Gruda, S. and P. MELANI (2010). Some Challenges of Competition Authorities of Small Countries toward European Integration: The Case of Albania. *The Western Balkans Policy Review*, 1 (1), pp 185-206.

Gugu, A. (2010). Competition and State Aid in Albania. *Institute for Contemporary Studies/Albanian Centre for International Trade (ISB/ACIT)*. Nga http://www.westernbalkans.info/htmls/save_pdf2.php?id=555.

Hoffmann, J. (2005). Integrating Albania: the Role of the European Union in the Democratization Process. *Albanian Journal of Politics*, I (1): 55-74.

Kacarska, S. (2012). Europeanisation through mobility: visa liberalisation and citizenship regimes in the Western Balkans. *CITSEE Working Paper 21*. University of Edinburgh.

Këshilli i Ministrave [AL], (2007). Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013.

Këshilli i Ministrave [AL] (2012). Plan i Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2007-2012.

Këshilli i Ministrave [AL] (2012). Plan i Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2012-2015.

Komisioni Europian (2012). Raporti i Progresit Shqipëri 2012 dhe Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2012-2013. Bruksel.

Komisioni Europian (2013). Raporti i Progresit Shqipëri 2013 dhe Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2013-2014. Bruksel.

Ministria e Integritimit (2007). Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (2009-2014). Tirane

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave MBZHRAU (2014). Siguria Ushqimore. Tirane

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (2014) Legjislacion. Tirana. Marrë nga: <http://www.bujqesia.gov.al/al/legjislacion/legjislacion>

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (2014) Sektorit i Buxhetit i Ministrisë së Bujqësisë. Tirane

Ministry of Agriculture, Food and Consumer Protection (MoAFCP) (2007). Agriculture and Food Sector Strategy 2007-2013. Tirana: MoAFCP

Ministry of Agriculture, Food And Consumer Protection (MoAFCP) (2011). Albanian Agriculture Fact Sheet. Available from: http://www.mbumk.gov.al/Botime/Albanian%20Figures%20%202011_Final.pdf Accessed [10 January 2014]

Ministry of Agriculture, Food and Consumer Protection (MoAFCP) (2013). Inter-sectoral strategy for agriculture and rural development in Albania. Draft version 1, 28 January 2013. Tirana.

Ministry of Agriculture, Food And Consumer Protection (MoAFCP) (2007). Agriculture and Food Sector Strategy 2007-2013. Tirana: MoAFCP

Misha, A. (2014). Interviste me Drejtorinë e Integritimit Europian në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Tiranë

Pere, E. (2008). "Economic trade relation in focus of regional integration of West Balkans Countries". *1st International Conference on Balkan Studies (ICBS)*, Epoka University, pp. 167-183.

Pridham, G. (2007) The Effects of the European Union's Democratic Conditionality: The Case of Romania during Accession. *Journal of Communist Studies and Transition Politics*, 1743-9116, Volume 23, Issue 2, 2007, Pages 233 – 258

SEED - Southeast Europe Enterprise Development (2005): Survey on Albanian enterprises of food and beverages processing.

Stern, U. dhe Wohlfeld, S. (2012). Albania's Long Road into the European Union: Internal political power struggle blocks central reforms. *DGAP Analyse, no 11*. Nga <https://dgap.org/en/article/getFullPDF/22245>.

Vurmo, G. (2008). Relations of Albania with the EU. *Center for EU Enlargement Studies*, CEU. Nga http://idmalbania.org/sites/default/files/publications/albania_eu_relations_vurmo.pdf.

WHO (2014). Strengthening food control institutions in Albania. Nga <http://www.euro.who.int/en/countries/albania/areas-of-work/strengthening-food-control-institutions-in-albania>


WHO (2006): FAO/ WHO Guidance to Governments on the Application of HACCP in Small/ or Less-Developed Food Businesses. FAO Food and Nutrition Paper 86.

WTO (2010). Trade policy review-Albania. United States: Bernan Press

ANEKSE


Aneks I Grafik

Figura 1A: Mesatarja e eksport-importeve shqiptare sipas Zonave (Në përqindje të totalit)




Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të autorëve

Figura 2A: Mesatarja e eksport-importeve shqiptare sipas zonave (Në vlerë)




Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të autorëve

Figura 3A: Importet shqiptare të mallrave sipas zonës së origjinës




Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të autorëve

Figura 4A: Eksportet e mallrave shqiptare sipas destinacionit (zonës)



Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të autorëve

Figura 5A: Investimet e huaja direkte në Shqipëri (në përqindje të PBB-së)



Burimi i të dhënave: Banka Botërore dhe llogaritje të autorëve

Aneks II – Kampioni i projektit kërkimor

Tabela 5: *Kampioni i studimit për intervistat e thelluara*

Nr.	I/e intervistuari/ja	Institucioni	Njësia/Departamenti
1	Grigor Gjeci	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ujrave	Drejtoria e Programimit dhe Vleresimit të Politikave Rurale
2	Luljeta Cuko	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ujrave	Drejtoria e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
3	Arjana Misha	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ujrave	Drejtoria e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
4	Rezart Fshazi	Ministria e Mjedisit	Drejtoria e Politikave Mjedisore
5	Elkida Sinani	Ministria e Mjedisit	Drejtoria e Projekteve
6	Gentian Elezi	Ministria e Integrimit Europian	Zv/Ministër
7	Ilirjan Xhezo	Ministria e Integrimit Europian	Drejtoria e Politikave Sektoriale
8	Pranvera Kastrati	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
9	Denis Gila	Kuvendi i Shqipërisë	Njësia për Përafrimin e Legjislacionit në Kuvendin e Shqipërisë
10	Lindita Lati	Autoriteti i Konkurrencës	Drejtor
11	Nikolin Jaka	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë	Kryetar
12	Ilir Zhilla	Bashkimi i Dhomave të Tregtisë	Kryetar
13	Bardhi Sejdarasi	Business Albania	President
14	Gjergji Gjika	Dhoma e Fasonëve të Shqipërisë	Kryetar
15	Gledis Gjipali	European Movement Albania - EMA	Drejtor Ekzekutiv

16	Alba Çela	Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare -ISSN	Zv/Drejtor
17	Gjergji Vurmo	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim - IDM	Drejtor Programi
18	Dori Hyseni	National Democracy Institute - NDI	Programme Officer
19	Geron Kamberi	Oxfam	Policy Research Officer

Aneks III Linjat e pyetjeve për intervistat e thelluara

Linjat e pyetjeve për institucionet qeveritare

1. Prezantim i institucionit/organizatës që përfaqësohet dhe ndjeshmëria ndaj procesit të integritetit;
 - 1.1 A mund të përmbledhni shkurtimisht profilin e institucionit/departamentit/zyrës suaj?
 - 1.2 Cili është roli juaj?
 - 1.3 Cili është roli i institucionit/departamentit/zyrës suaj në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE?
 - 1.3.1 Në hartimin e politikave?
 - 1.3.2 Në zbatimin e politikave?
 - 1.3.3 Në administrimin e procesit?
 - 1.3.4 Nëse institucioni/departamenti/zyra juaj nuk ka rol domethënës në procesin e integritetit, sa është e ndjeshme institucioni/departamenti/zyra juaj ndaj procesit të integritetit të Shqipërisë në BE?
2. Në çfarë mase dhe mënyre proceset e integritetit e kanë ndikuar funksionimin e aktivitetit të institucionit/departamentit/zyrës?
 - 2.1 Si ka ndikuar procesi i integritetit në performancën e institucionit/departamentit/zyrës nga pikëpamja e rritjes së përfitimeve, zhvillimit të burimeve njerëzore, punësimit, ndërlidhjes me institucione të tjera, bashkëpunimi rajonal, efikasitet?
3. Si e vlerësoni ndikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit në fushën përkatëse që mbulon institucioni juaj?
4. Në fushën që mbulon institucioni juaj, a vëhet re një asimetri e procesit të integritetit? Nëse po, si?

Linjat e pyetjeve për sektorin privat

1. Sa është ndikuar organizata/sektori juaj nga procesit të integrimit të Shqipërisë në BE?
2. A ka ndikuar procesi i integrimit në kuadrin ligjor në të cilin vepron organizata/sektori juaj? Si?
3. A ka ndikuar procesi i integrimit në kuadrin financiar në të cilin vepron organizata/sektori juaj? Si?
4. A janë lehtësuar procedurat dhe ndërlidhjet me institucionet qeveritare?
5. Si ka ndikuar procesi i integrimit në shkëmbimet me jashtë sipas fushës së veprimtarisë së organizatës/sektorit suaj?
6. Si është ndikuar organizata/sektori juaj nga investimet e kompanive të huaja në Shqipëri?
7. Si ka ndikuar procesi i integrimit në performancën e organizatës/sektorit suaj nga pikëpamja e zhvillimit të burimeve njerëzore?
8. Si ka ndikuar procesi i integrimit në performancën e organizatës/sektorit nga pikëpamja e punësimit?
9. Cilat janë kostot e procesit të integrimit për sektorin tuaj?
10. Cilat janë përfitimet e procesit të integrimit për sektorin tuaj?

Linjat e pyetjeve – ekspertët

1. Prezantimi i ekspertit dhe përfshirja e tij/saj në analiza/hulumtime/projekte në lidhje me integrimin e Shqipërisë në BE.
 - 1.1. Cili ka qënë angazhimi juaj gjatë këtyre viteve dhe në çfarë aspekti e keni parë/analizuar procesin e integritit të Shqipërisë në BE?
 - 1.1.1. Cili ka qënë roli juaj në raport me institucionet në Shqipëri?
 - 1.1.2. Cili ka qënë roli juaj në raport me aktorë të tjerë vendimmarrës/pjesëmarrës në procesin e integritit?
2. Si e gjykoni efektin e proceseve integruese në institucionet shqiptare?
 - 2.1. Si e gjykoni efektin e proceseve integruese në funksionimin e institucioneve?
 - 2.2. Si e gjykoni efektin e proceseve integruese në efikasitetin e institucioneve?
 - 2.3. Si e gjykoni efektin e proceseve integruese në koordinimin ndër-institucional?
 - 2.4. Si e gjykoni efektin e proceseve integruese në pavarësinë e institucioneve?
3. Si i gjykoni efektet e procesit të integritit të Shqipërisë në BE në këto fusha (sipas ekspertizës së ekspertit):
 - 3.1. Në flukset tregtare?
 - 3.2. Në lëvizjen e lirë: njerëz, kapital, mallra, shërbime?
 - 3.3. Në konkurrencë dhe tregun e lirë?
 - 3.4. Në sigurinë ushqimore?
 - 3.5. Në Mjedis?
4. Si e gjykoni efektin e proceseve integruese në institucionet dhe ekonominë shqiptare në raport me vendet e rajonit?
5. Në çfarë raporti qëndrojnë pritshmëritë dhe realiteti/status-quoja në lidhje me efektet e proceseve integruese në institucionet dhe ekonominë shqiptare?
 - 5.1. Sa përputhen efektet aktuale në institucionet dhe ekonominë shqiptare të procesit të integritit me pritshmëritë ndaj procesit?
 - 5.1.1. Nëse realiteti aktual nuk përputhet me pritshmëritë ndaj procesit, a mund të konsiderohet kjo si kosto e proceseve integruese?
 - 5.2. Në çfarë mase inputet e përfshira në proces kanë justifikuar outputet e përftuara nga procesi?
 - 5.3. Në çfarë mase mjetet kanë justifikuar qëllimet gjatë procesit të integritit të Shqipërisë në BE?

Aneks IV: Legjislacioni shqiptar për bujqësinë

Ligjet dhe rregulloret kryesore që rregullojnë sektorin bujqësor në Shqipëri janë si më poshtë:

- Ligji për ushqimin në vitin 2008, i cili në pjesën më të madhe të tij është i harmonizuar me legjislacionin e BE-së.
- Ligji për bujqësinë dhe zhvillim rural në vitin 2008 i cili rregullon programimin e skemave kombëtare mbështetëse për sektorin agro-ushqimor, krijoi Agjensinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) për zbatimin e mbështetjes kombëtare dhe prezanton monitorimin dhe vlerësimin e skemave mbështetëse kombëtare;
- Ligji për Bashkëpunim bujqësor në vitin 2012, i cili prezantoi kooperativat bujqësore;
- Themelimi i institucioneve për programimin dhe zbatimin e asistencës Zhvillimit Rural të para-pranimit, përkatësisht Autoriteti Menaxhues në MBUMK dhe Agjencisë së IPARD, AZHBR.
- Programi IPARD për Shqipërinë për periudhën 2011-2013, i cili është përdorur si kornizë për përgatitjen e skemës së madhe IPARD-like.
- Skema e Grantit IPARD-like në vitin 2012 në kuadër të projektit IPA 2011 "Mbështetje të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural", me objektivin kryesor të rritjes së vetëdijes dhe kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në zhvillimin rural dhe lehtësimin e zhvillimit të sektorit agro-ushqimor dhe cilësi bujqësi. (Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, 2014)

Procesi i integritimit do të vazhdojë me iniciativat e mëposhtme:

- Regjistrimi i fermerëve në regjistrin e fermave dhe regjistrat e tjerë relevant (regjistrin e kafshëve, LPIS, etj). Nxitjet për fermerët për tu regjistruar dhe vepruar në përputhje me ligjet dhe standardet kombëtare do të sigurohet nëpërmjet masave mbështetëse. Vetëm fermerët që veprojnë sipas këtyre dispozitave do të jenë të ligjshëm për mbështetje.
- Strukturat Operative IPARD - *MA dhe ARDA* – duhen akredituar në përputhje me kriteret e akreditimit të BE-së për të filluar zbatimin e Programit sa më shpejt të jetë e mundur pas vitit 2014.
- Në perspektivë afatmesme, prioritet është që të zhvillohen më tej aftësitë e AZHBR për t'u bërë Agjensia e pagesave të PPB pas anëtarësimit.
- Miratimi i *Ligjit për konsolidimin e tokës*, në vitin 2014,
- Korniza ligjore për cilësinë dhe origjinën e produkteve në përputhje me kërkesat e BE (PDO / PGI, produktet tradicionale) (MoAFCP, 2013: 33-34).

Aneks V: Legjislacioni shqiptar për sigurinë ushqimore

Procesi i përafrimit të legjislacionit dhe zhvillimit të kapaciteteve institucionale në fushat e sigurisë ushqimore, veterinarë dhe politikës fitosanitare, do të rritet duke futur një qasje më të integruar për përafrimin me *acquis*. Korniza ligjore për produkte të cilësisë do të zhvillohet në përputhje me kërkesat e BE (Organics, PDO / PGI, produktet tradicionale) (MOAFCP, 2013).

Ligjet kryesore në Shqipëri që krijojnë kuadrin ligjor për sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve janë si më poshtë:

- Ligji nr 9863 dt. 28.01.2008 "Për Ushqimin" i cili në më të shumtën e tij është i harmonizuar me *acquis* e BE-së në fushën e sigurisë së ushqimit. Me këtë Ligj Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është krijuar dhe u bë operacional më 1 shtator 2010;
- Ligji nr. 10,465, datë 29.09.2011, Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë dhe ngritjen e kapaciteteve në fushën e mirëqënies së kafshëve dhe shëndetit, identifikimin e kafshëve dhe sistemin e regjistrimit dhe kontrollet.
- Urdhër nr. 168 datë 2012/05/24 "Për aprovimin e PIK-ve, ku inspektimet veterinarë dhe fitosanitare për ushqimin janë kryer, në Republikën e Shqipërisë".
- Urdhër nr.178 datë 04,06. 2012 "Për miratimin e rregullores" Për listën e kafshëve dhe produkteve që duhet të nënshtrohen kontrolleve të Inspektimit Kufitar ", bazuar në Vendimin e Komisionin 2007/275/EC.
- Urdhër nr.209, Data 15.06.2012 "Për miratimin e rregullores" Mbi metodat e mostrimit, analizave për kontrollin zyrtar të niveleve të plumbi, kadmiumi, mercuri, kallajit inorganik, 3-MCPD dhe Benzo (a) pyrene në produktet ushqimore ", bazuar në rregulloren 333/2007/EC.
- Urdhëri nr.226 date 02.07.2012 "Për përcaktimin e procedurës së notifikimit pranë Organizatës Botërore të Tregtisë, të projektakteve të iniciuara nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit".
- Ligji nr 9308 i datës 04.11.2004 "Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar",
- Ligji nr 9362 i datës 24.03.2005 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", ndryshuar në vitin 2008,
- Dispozitat e veçanta të përcaktuara në vendimet e ndryshme të Këshillit të Ministrave dhe urdhërat e ministrit në lidhje me sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve, mbrojtjen e bimëve etj,
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1081 , data 21.10.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit ",
- Strategjia Sektoriale për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve ,

- Neni 70 "Për përafrimin e legjislacionit shqiptar" dhe neni 76" Për Mbrojtjen e Konsumatorit "e MSA-së, prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme të përcaktuara në vendimin e Këshillit 2008/210/EC të datës 18 shkurt 2008 për parimet, prioritetet dhe kushtet e përmbajtura në Partneritetin Evropian me Shqipërinë,
- Plan i Kombëtar për zbatimin e MSA-së, pika 3.8.1. (Siguria Ushqimore), Plan i Indikativ Shumëvjeçar për Shqipërinë për periudhën 2009-2011,
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, Këshilli i Ministrave (MBZHRAU, 2014)

Për të siguruar që operatorët e bizneseve ushqimore të përmbushin detyrimet e tyre ligjore për sigurinë e ushqimit në treg, dhe për zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për të arritur këtë qëllim, duhe marrë disa masa si më poshtë:

- Forcimi i sistemeve të kontrollit të bazuar në parimet e HACCP, duke përfshirë përgatitjen e udhëzimeve dhe listat kontrolluese.
- Përmirësimi gradual i bizneseve të prodhimit të ushqimit për të identifikuar boshllëqet dhe prioritetet për përmirësimin drejt standardeve të BE-së, përgatitja e një plani veprimi për përputhje me standardet e BE dhe për të rritur ndërgjegjësimin e mundësive për të aplikuar për mbështetje në Programin II të IPARD.
- Sigurimi i monitorimit në të gjitha nivelet e zinxhirit ushqimor gjatë prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes të ushqimit.
- Ngritjen e kapaciteteve dhe organeve përgjegjëse të trajnimit për personelin rregullator.
- Informacioni dhe komunikimi me publikun.

Aktivitetet kryesore për periudhën në fushën e veterinarisë, shëndetit të kafshëve dhe mirëqenies do të jenë:

- Intensifikimi i procesit të përshtatjes së legjislacionit në fushën e veterinarisë.
- Vendosë kontrollin e plotë të gjendjen epizootike mbrojtjen e shëndetit të kafshëve nga sëmundjet ngjitëse dhe të dëmshme
- Sigurinë që në vitin 2018 vendi të ketë një brez imunitar të kafshëve, për të hapur rrugën për eksportin e mishit të deleve dhe dhive në tregjet e BE-së.
- Garantimi i sigurisë së produkteve ushqimore me origjinë shtazore për konsumatorët,
- Realizimin e programit kombëtar për monitorimin e produkteve dhe molusqeve bivalve.
- Finalizimi i një sistemi efektiv të menaxhimit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave bujqësore.
- Ndërtimi i kapaciteteve, duke përfshirë rritjen e trajnimit për personelin në të gjitha nivelet.

Aktivitetet kryesore për të ardhmen në fushën e çështjeve fitosanitare, dhe mbrojtjen e bimëve:

- Intensifikimi i procesit të përafrimit të legjislacionit në bazë të planit të detajuar të veprimit, duke përfshirë miratimin e një ligji të ri që ka për qëllim kuadrin ligjor për mbrojtjen e bimëve me acquis të BE.
 - Përmirësimi i strukturës organizative dhe shtimin e personelit të administratës fitosanitare, laboratorët fitosanitare, dhe për të krijuar një regjistër të prodhuesve dhe tregtarëve të bimëve dhe produkteve me origjinë bimore.
 - Krijimi i një zone të lirë nga sëmundjet virale dhe bakteriale, për prodhimin e farave dhe fidanëve në 5 Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore.
- (Ministry of Agriculture, Food and Consumer Protection, 2013)

Aneks VI Marrëdhëniet Shqipëri-BE në fushën e tregtisë

Marrëdhëniet tregtare kanë qenë pionerët e marrëdhënieve Shqipëri-BE. Me liberalizimin e tregut dhe tregtisë së jashtme shqiptare në fillim të viteve '90, BE si entitet dhe vendet e veçanta brenda BE-së u bënë synimi kryesor i Shqipërisë në lidhje me zhvillimin e partneriteteve ekonomik. Hapi i parë në vendosjen e marrëdhënieve ekonomike dhe në përfshirjen e Shqipërisë në regjimet preferenciale tregtare të BE-së ishte nënshkrimi dhe hyrja në fuqi në dhjetor 1992 e Marrëveshjes për Tregti dhe Bashkëpunim (MTB). Pas nënshkrimit të MTB-së pasoi Regjimi Autonom Preferencial me BE-në, zgjerimi i tregjeve europiane për produktet shqiptare si dhe nënshkrimi i Partneritetit European për Shqipërinë në vitin 2004 (Komisioni European, Marrëdhëniet Shqipëri-BE). Pavarësisht benefiteve fillestare në afrimin me BE-në, bashkëpunimi në fushën e tregtisë do të përshpejtohej me fillimin e Procesit të Stabilizim Asocimit (PSA) dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA). Në lidhje me ekonominë e tregut, tregtinë e lirë dhe bashkëpunimin rajonal, kërkesat kryesore të MSA-së lidhen me tri fusha: “(i) krijimi i një Zone të Tregtisë së Lirë me vendet e rajonit dhe BE-në; (ii) përmbushja e kërkesave dhe detyrimeve të OBT-së; (iii) adoptimi i *acquis* për tregun e përbashkët në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave, punëtorëve, shërbimeve dhe kapitalit” (Mancellari, 2004: 5).

Ndërmjet nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të MSA-së, një Marrëveshje e Përkohshme do të rregullonte marrëdhëniet Shqipëri-BE, me fokus të veçantë në liberalizimin e tregut. Marrëveshja përcaktoi bazën e bashkëpunimit duke theksuar se “Komuniteti dhe Shqipëria duhet të krijojnë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë përgjatë një periudhe maksimale 10-vjeçare duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes” (Marrëveshja e Përkohshme, Neni 3). Një seri përfitimesh për Shqipërinë ishin listuar si “tarifat doganore për mallrat industriale shqiptare që hyjnë në tregun european reduktohen në zero. I njëjti rregull aplikohet edhe për mallrat bujqësor ndërkohë që tarifat doganore për lloje të tjera produktesh do të reduktohen gradualisht deri në eliminim” (Crimson Capital, n/a: 16). Me hyrjen në fuqi të MSA-së pati një ndryshim në natyrën kontraktuale të marrëdhënies midis Shqipërisë dhe BE-së duke qënë se u prezantua perspektiva e anëtarësimit (Vurmo, 2008: 22).

Marrëveshjet rajonale kuadër në fushën e tregtisë

Edhe pse marrëdhëniet Shqipëri-BE kanë një dimension të mirëpërcaktuar dypalësh (BE e marrë si entitet i vetëm në këtë rast), qasja e BE-së kundrejt vendeve të veçanta në Ballkan ecën paralel me një kuadër rajonal sidomos në lidhje me tregtinë. Në këto kushte, vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, duhet të zhvillojnë një partneritet të konsiderueshëm bashkëpunimi ekonomik me vendet fqinje dhe më gjërë në mënyrë që të mund të avancojnë me hapat e anëtarësimit. Si pasojë, vendet e Ballkanit Perëndimor janë angazhuar në disa marrëveshje rajonale në lidhje me tregtinë e lirë.

Fillimisht, bashkëpunimi ekonomik rajonal u zhvillua përmes Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë (FTA) dypalëshe. Shqipëria nënshkroi FTA-në e parë me Maqedoninë në vitin 2002 e cila u pasua nga FTA me Kosovën dhe Kroacinë në vitin 2003 dhe me Serbinë & Malin e Zi dhe Bosnien & Hercegovinën në vitin 2004. Edhe pse të vlefshme, këto marrëveshje dypalëshe dhe Memorandumi i Mirëkuptimit për Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë që u parapriu nuk qenë të mjaftueshme në krijimin e një zone të tregtisë së lirë në rajon (Pere, 2008:170). BE-ja e adresoi këtë shqetësim përmes vendimit për të përfshirë vendet e Ballkanit Perëndimor në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Europës Qëndrore (CEFTA). Kështu, Shqipëria së bashku me pjesën tjetër të Ballkanit Perëndimor plus Moldavia u bënë pjesë të CEFTA-s në vitin 2006. Duke iu referuar këtyre zhvillimeve Vurmo (2008: 29) argumentonte se “operatorët ekonomik shqiptar tashmë duhet të adoptojnë një qasje më të qëndrueshme si në përfitimin nga tregjet fqinje ashtu dhe në përballjen me presionin e ekonomive rajonale dhe asaj të Bashkimit European”. Për më tepër, në dhjetor 2009, Shqipëria firmosi një FTA edhe me EFTA duke zgjeruar kështu zonën e tregtisë së lirë ku vendi përfshihej.

Legjislacioni shqiptar dhe dizajni institucional në lidhje me çështjet e tregtisë

Në lidhje me tregtinë dhe çështjet tregtare ka një seri ligjesh, ku më të rëndësishmit lidhen me mbikëqyrjen e tregut, përputhshmërinë e produkteve, si dhe mbi standardizimin, metrologjinë dhe akreditimin. Baza ligjore për përputhshmërinë e produkteve dhe mbikëqyrjen e tregut përcaktohet nga Ligji 9779 i vitit 2007 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve jo ushqimore”. Baza ligjore për standardizimin, metrologjinë dhe akreditimin përcaktohen respektivisht në: Ligjin 9870 i vitit 2008 “Për standardizimin”; Ligjin 9875 i vitit 2008 “Për metrologjinë”; dhe Ligji 9824 i vitit 2007 “Për Akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.³⁰

Ky kuadër legjislativ procesohet dhe zbatohet përgjatë ministrive të linjës si dhe drejtorive specifike në këto ministri. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është ministria kryesore kordinuese në lidhje me tregtinë dhe çështjet tregtare si dhe është përgjegjëse për pjesën më të madhe të vendimarrjes mbi produktet dhe aktivitetet e mbikëqyrjes së tregut. Për sa u përket drejtorive, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) është struktura shtetërore e standardizimeve që përgjigjet për “zhvillimin, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve në të gjithë sektorët, përveç atyre në fushën e telekomunikacionit” (Përgjigjet e Shqipërisë ndaj Pyetësorit të BE-së, 2010: 368). Në funksionet të ngjashme për akreditimin dhe metrologjinë qëndrojnë dy drejtoritë respektive: Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM).

³⁰ Për detaje të tjera mbi bazën ligjore referohu Përgjigjeve të Shqipërisë ndaj Pyetësorit të BE-së (2010: 377-8).

Aneks VII Perceptimet e sektorit privat për kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit

Tabela 6: Përmbledhja e perceptimeve të sektorit privat

Sektori privat: biznesi dhe sipërmarrja	Përfitimet nga procesi i integrimit europian	Kostot nga procesi i integrimit europian
Kuadri ligjor dhe rregullues	Përafrimi i legjislacionit me BE-në; Përcaktimi i politikës së konkurrencës së lirë dhe ruajtja e balancave në treg; Lehtësime në legjislacion për biznesin/regjistrimin/funksionimin e sipërmarrjeve të reja; Ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të institucioneve koordinuese dhe monitoruese; Përmirësim i komunikimit me institucionet qeveritare;	Kosto financiare të përafrimit të legjislacionit; Grumbullim i legjislacionit ‘në letër’ në raport me zbatueshmërinë; Mospërputhje mes përshtatjes së legjislacionit dhe vizionit për zhvillimin e shoqërisë shqiptare; Më shumë legjislacion i përshtatur nuk do të thotë domosdoshmërisht më shumë cilësi në standardet e jetës së qytetarëve; Plotësimi i kushteve të përcaktuara nga BE-ja, shpesh lë jashtë procesin e konsultimit me sektorin privat në vendimmarrje;
Të mirat dhe shërbimet	Vendosja e standardeve të përbashkëta me BE-në; Rritja e konkurrencës; Gjetja e tregjeve të reja për eksportim; Ekonomitë e shkallës; Shkëmbimet ndër-kufitare, rajonale dhe me BE-në si në të mira dhe shërbime;	Hyrje në treg më lehtë e konkurrentëve; Përballja me tregje më të avancuar e konsoliduar; Konkurrenca e çmimeve sidomos tek shërbimet; Tregtia e lirë mund të rrezikojë sektorë të caktuar të ekonomisë shqiptare që nuk e përballojnë konkurrencën;
Puna	Njohje e kualifikimeve; Mundësi më të larta për arsimimin dhe kualifikim profesional në vendet e BE-së;	Lëvizshmëria e krahut të punës është e ulët gjatë procesit;

Kapitali	Investimet e huaja direkte; Kosto më të ulta kapitale; Diversifikim i burimeve të kapitalit; Shkëmbimet ndër-kufitare, rajonale dhe me BE-në të kapitalit; Ndërtimi i partneriteteve (mergers) mes firmave vendase dhe të huaja pasi është rritur besimi dhe siguria për investimet në vend;	Ndërvlerësia për sigurimin e kapitalit lidhet ngushtë me risqet e përbashkëta; Sistemi jo-i-harmonizuar i taksimit;
Kërkimi dhe inovacioni	Programet e inovacionit dhe kërkimit të Komisionit Europian Lëvizshmëria akademike dhe programet e mbështetjes së arsimit të lartë dhe profesional; Intensifikim i shkëmbimeve mes sipërmarrjeve në rajon dhe me BE-në sa i takon përmirësimit të teknologjisë dhe praktikave të inovacionit;	Vështirësi dhe kosto financiare në sigurimin e patentave të BE-së; Vetë tregu europian është i fragmentuar sa i takon kërkimit dhe inovacionit; Përfitime konkrete financiare në zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionit për sipërmarrjen të ulta në raport me pritshmëritë (përfjashtojë bujqësinë)
Efienca e kompanive	Zhvillim i kapaciteteve njerëzore të kompanisë; Përmirësim i standardeve të punës, etikës profesionale dhe komunikimit; Formalizimi, struktura dhe ndërtimi janë përmirësuar sipas standardeve europiane, sidomos për sektorin e fasonëve.	Rritja e kostos së punës për kompanitë me detyrimin për rritjen e pagës minimale.

Aneks VIII Perceptimet e sektorit publik për kostot dhe përfitimet e procesit të integrimit

Tabela 7: Përmbledhja e perceptimeve të sektorit publik

Institucionet publike (politikëbërje; koordinim; të pavarura)	Përfitimet nga procesi i integrimit europian	Kostot nga procesi i integrimit europian
Kuadri ligjor dhe rregullues	Liritë, garancitë dhe të drejtat e qytetarëve europianë; Standardet dhe kuadri ligjor europian; Llogaridhënia dhe kapaciteti përthithës i fondeve të BE-së;	Kostot financiare të përafrimit;
Funksionimi i institucioneve	Koordinimi ndërinstitucional; Qëndrueshmëria institucionale; Ndërtimi i institucioneve për garantimin e standardeve të përbashkëta: - Autoriteti i Konkurrencës - institucioni i cili garanton zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës; - Agjencia Kombëtare e Ushqimit; - Agjensia e Pagesave dhe Autoritetit Menaxhues.	
Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore	Fuqizimi i institucioneve kombëtare dhe kapitalit të tyre njerëzor përmes programeve mbështetëse dhe të financimit;	Kushtëzimi politik si ‘pushtet mbi’ institucionet kombëtare;
Demokratizimi dhe dialogu politik	Cilësia e politikëbërjes, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë përmirësuar;	

Aneks IX Perceptimet e ekspertëve/shoqëria civile për kostot dhe përfitimet e procesit të integritetit

Tabela 8: Përmbledhja e perceptimeve të ekspertëve/shoqëria civile

Ekspertët/shoqëria civile	Përfitimet nga procesi i integritetit evropian	Kostot nga procesi i integritetit evropian	Kufizime të brendshme
Kuadri ligjor dhe rregullues	Përafrimi i legjislacionit; Vendosja e standardeve të përbashkëta; Asistencë financiare dhe ndërtim kapacitetesh për çështjet e brendshme dhe të sigurisë: Euralius, Pameca, Cards, PHARE, IPA, etj.;	Kostot financiare të përafrimit të legjislacionit;	
Funksionimi i institucioneve	Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore përmes programeve të asistencës; Koordinimi ndërinstitutional më i plotë; Ministria e Integritetit Evropian – si institucion koordinues i procesit dhe ndërlidhës mes institucioneve në Shqipëri dhe institucioneve të BE-së; Shtypa për pavarësinë e institucioneve; Intensiteti dhe shpejtësia e përmirësimit të cilësisë së funksionimit të institucioneve dhe kapacitetit teknik;	Komunikimi i brendshëm institucional është çënuar nën presionin e kryerjes së proceseve shpejt e shpejt e sipas kushteve të BE-së; Ndërlidhja e qënësishme mes vullnetit dhe vendimmarrjes politike me proceset teknike e politikëbërëse në nivele të tjera institucionale; Procesi i integritetit si më shumë teknik dhe ekzekutiv dhe mund të çënojë balancën dhe pavarësinë e institucioneve nëse instrumentalizohet nga aktorët politik;	Qëndrueshmëria e kapaciteteve njerëzore në institucione – qëndrueshmëria e investimit nga BE-ja Pa shtysën e procesit të integritetit, intensiteti dhe shpejtësia nuk do kishin qenë në të njëjtin ritëm; Prioritetet politike nuk përkthehen në investime reale, politike, as buxhetore, as administrative brenda këtyre institucioneve;
Demokratizimi dhe	Fuqizimi i aktorëve	Kushtëzimi politik	Instrumentalizimi i

dialogu politik	politik; Përmirësim i proceseve demokratike (zgjedhjet) dhe ndërmjetësim në zgjidhjen e situatave të polarizuara; Kornizë bazë për llogaridhënien dhe transparencën në vendimmarrje; Nxitëse e reformave për dialogun politik; Ofron modelin e zhvillimit politik, institucional, ekonomik dhe shoqëror; Komunikimi dhe hapja me Europën dhe rritja e ndjesisë së përkatësisë në vlerat europiane; Proces i vazhdueshëm kushëtizimi, negocimi, përafrimi dhe thellimi që ndihmon demokratizimin;	krijon varësi të aktorëve dhe institucioneve kundrejt atyre të BE-së; Parlamenti European (grupim politik) nuk ka dalë gjithmonë me një qëndrim të përbashkët dhe kjo ka thelluar polarizimin;	aktorëve politik i kushtëzimeve të BE-së; Funksionimi i partive politike në Shqipëri; ‘Elefanti në dhomë’ – administrata publike; Komunikim politik i personalizuar dhe qëndrime në llogore të ndryshme; Kushtëzimi për zgjedhjet jo gjithmonë i qëndrueshëm dhe i fortë – ndarje mes OSBE-së dhe institucioneve të BE-së; Marrëdhëniet ndërmjet pushteteve; <i>‘Na është bërë faqja rrogoz’</i> - imuniteti ndaj kushtëzimit
Cilësia e politikëbërjes, vendimmarrja dhe llogaridhënia	Proces konsultativ nën shtysën e BE-së sa i takon politikave/strategjive – konsultim dhe monitorim Zgjidhja e krizave të brendshme përmes ndërmjetësimit të institucioneve të BE-së Shtysa pozitive për përgatitjen e dokumentave strategjikë; Rritja e aksesit në informacion për	Kushtëzimi politik krijon varësi të aktorëve dhe institucioneve kundrejt atyre të BE-së; Presioni i jashtëm i realizimit të proceseve konsultative dhe monitoruese ka sjellë një mungesë të pronësisë së tyre, e cila do të ishte më e qartë nëse proceset do kishin ndodhur gradualisht dhe si një nevojë e brendshme; Konsultimi me grupet e interesit dhe shoqërinë	Mungon ‘control factor’ për të arsyetuar nëse këto ndryshime do të ndodhnin gjithësesi edhe pa shtysat e BE-së; Procese jo të qënësishme, por të realizuara në nxitim e sipër nën presionin e vizitave të BE-së; dërgimit të raporteve etj.; Jo vetëm procese institucionale dhe kuadër ligjor e procedural, por edhe kulturë, sjellje dhe

	qytetarët dhe krijimi i kulturës dhe praktikës së punës së llogaridhënies; Përforcim i rolit të aktorëve të shoqërisë civile në kërkesat për llogaridhënie përmes instrumentave formalë dhe jo formalë; Rritja e vetëdijes së qytetarëve për kufinj të institucioneve dhe rritjen e kërkesës së llogaridhënies; Strukturat formale për zhvillimin e integruar në nivel vendor;	civile shpesh nuk është i qenësishëm, por i bërë shpejt e shpejt për shkak të pranisë së përfaqësuesve të BE-së apo nevojës për të raportuar;	pratika pune të cilat ndryshojnë më me vështirësi; Hendeku midis pritshmërive, kërkesave dhe gadishmërisë për të vepruar si nga ana e qeverisë, elitës dhe qytetarisë;
Shteti i së drejtës	Të drejtat e njeriut ▪ LGBT; ▪ Spitali psikiatrik për të burgosurit ▪ Shtysat për anti-korrupsionin Reformimi i funksionimit të policisë së shtetit – institucionet e paraburgimit; policimi në komunitet; gjinia dhe moshat e reja si shtysë për respektimin e të drejtave të njeriut; Zhvillimi i kapaciteteve të shoqërisë civile; Asistenca përmes EURALIUS, PAMECA;	Barazimi në adresim i prioritetëve politike me mekanizmat afatgjatë të qëndrueshëm institucionalë; prioritetet politike kërkojnë aktorë, kohë, pritshmëri dhe matje të rezultateve të ndryshme nga politikat konkrete publike dhe mekanizmat institucional;	Përdorimi i fondeve të BE-së jo sipas destinacionit – manaxhimi i fondeve; Çështje e pjekurisë së shoqërisë, së klasës politike, administratës shqiptare, se sa është problem i përfaqësjes së Bashkimit Europian kundrejt Shqipërisë
Administrata dhe shërbimet publike	Standarde të profesionalizimit të administratës publike dhe shërbimeve;		Funksionimi i administratës publike – meritokracia – ndërvlerësia politike

	Ulje e vendimeve arbitrave dhe praktikave korruptive; Akses në informacion dhe shërbime më cilësore;		
Sipërmarrja	Liberalizimi i tregut dhe rritja e konkurrueshmërisë; Formalizimi i standardeve në produkte dhe shërbime Standardet në sigurinë ushqimore; Përthithja e fondeve pas marrjes së statusit kandidat sipas kapaciteteve dhe jo automatikisht; Bujqësia si sektori që ka përfituar më shumë nga liberalizimi i tregut, marrëveshja asimetrike e tregtimit pa tarifa doganore; asistenca përmes programeve IPARD-it;	Rritja e standardeve me intensifikimin e procesit të asocimit sjell rritje të kostove për biznesin;	Informim i plotë për sektorin privat sa i takon kushtëzimit, standardeve dhe kostove që pritet me intensifikimin e procesit të asocimit, me statusin kandidat dhe më pas me anëtarësimin; Zhvillimi i kapaciteteve të fshatarit/fermerit për të aplikuar, zbatuar dhe raportuar sipas grantit të marrë; Zonat rurale nuk janë uniforme dhe kanë specifika të ndryshme; Fondet e garancisë së qeverisë për fermerët për përfitim nga fondet e BE-së për bujqësinë; Liberalizimi i tregut me marrëveshjen me OBT në 2000-s, negociimi, nënshkrimi dhe hyrja në fuqi e MSA-së jo tërësisht e re; MSA-ja, që është tipike një marrëveshje asimetrike që ofron më shumë përfitime për palën shqiptare se sa për palën europiane, por kjo është në letër;

			Nuk kemi patur dhe ende janë pak ato biznese të cilat mund të jenë konkurrese, apo të kenë standarde e të jenë të certifikuara për të hyrë në tregun e BE-së.
Arsimi	Pjesëmarrja në programet për arsimin e lartë: Tempus, Erasmus		

Aneks X Rast studimor: Fermer në blegtori

Me përfaqësi/ Një fermer i vogël me 5-10 lopë (me prodhimtari optimale 4000 litra në vit) ka një fitim neto në vit rreth 40 000 lekë për 1 lopë. Pra, me 10 lopë ai arrin të marrë një fitim neto afro 400000 lekë (mesatarisht).

Këtu nuk përfshihet “*rroga e tyre e konvertuar në lekë*” (Ende në Shqipëri fermeret nuk llogarisin krahun e punës së familjes së tyre dhe një sërë procesesh të tjera).

Një fermer me rreth 50 krerë dele, ka një fitim neto prej 6500 lek për 1 dele (shitja e qengjit, qumështi etj.) ose rreth 320 000 lekë në total.

Në përgjithësi, numri i vogël i krerëve dhe përmasa e vogël e fermës rezultojnë në efikasitet të ulët. Kostot e foragjerëve janë ende të larta, pra mbeten një pengesë kryesore për fermerat që merren me blegtori. Në vija të përgjithshme, kooperimi bujqësor, pra krijimi i kooperativave dhe rritja graduale e madhësisë së fermës (konsolidimi i tokës) janë ndër masat që do të merren në të ardhmen për këtë kategori fermash.

Kosto e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale në Shqipëri është më e lartë se kostoja e prodhimit në vendet e rajonit dhe shumë më e lartë krahasuar me vendet e BE-së. Shkaktohet pse kjo kosto është më e lartë janë:

- Madhësia e vogël e fermave bujqësore;
- Shkalla e ulët e investimeve publike dhe private në bujqësi;
- Shkalla e ulët e mekanizimit në bujqësi;
- Niveli teknologjik i ulët në agroindustri;
- Çmimi i lartë i inputeve bujqësore;
- Infrastruktura rrugore e pazhvilluar në një pjesë të mirë të zonave rurale;
- Largësia e prodhuesve dhe prodhimit nga tregjet urbane.

Më poshtë janë renditur masat e tjera për uljen e kostove:

- Nxitja e zhvillimit të tregut të tokës bujqësore
- Rritja e nivelit të investimeve publike në ujë dhe kullim
- Nxitja e kooperimit në bujqësi nëpërmjet krijimit të kooperativave bujqësore (ose shoqërive të bashkëpunimit bujqësor SHBB) dhe konsolidimit të atyre që janë krijuar, deri tani rreth 30 SHBB
- Subvencionimi i blerjes së disa inputeve bujqësore.

Politika të veçanta për zhvillimin e zonave malore të tilla si:

- Subvencionimin për aktivitetet bujqësore, në të gjitha ato që konsiderohen “Zona më pak të favorizura” sipas kritereve të CAP ;
- Mbështetja e Agroturizmit;
- Mbështetja e disa aktiviteteve të tjera me natyrë jo bujqësore.

Fermerët e vegjël që prodhojnë për tregun do të vazhdojnë të mbështeten nëpërmjet skemave ekzistuese kombëtare.

Përsa i përket aplikimeve shumë të pakta të skemës së subvencioneve të IPARD-like dhe për më tepër, numrit tejet të pakët të fituesve, arsyeja është:

- Pamundësia për të plotësuar standardet;
- Një pjesë e mirë, fillimisht filluan të aplikojnë me synimin për të “përfituar” një sasi të madhe fondi dhe jo për qëllimin e vërtetë të kësaj skeme, por me pas kuptuan që kjo ish një aplikim shumë serioz, me shumë kërkesa dhe që nuk linte vend për abuzime, dhe janë tërhequr;
- Një pjesë tjetër, e shohin të vështirë përmbushjen e shumë detyrimeve dhe preferojnë më mirë mos t’i fillojnë procedurat;
- Një pjesë e vogël, që duan me të vërtetë të ecin dhe zgjerojnë biznesin e tyre, e mbështesin fuqimisht këtë skemë dhe realisht kanë përfituar dhe kjo pjesë është “model” për të tjerët, që do t’i hapë rrugën aplikimeve të mëvonëshme.

Draft i Strategjisë Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (2014-2020) indentifikon këto çështje:

Toka

- Përdorimi i ulët dhe i paekuilibruar i plehrave organike dhe minerale
- Mosaplikimi i qarkullimeve të duhura bujqësore
- Masat jo efektive të mbrojtjes së bimëve,
- Teknikat e papërshtatshme të punimit të tokës,
- Masat jo efektive në sigurimin e kullimit
- Përmbytjet, shtimi i erozionit për shkak edhe të shpyllëzimeve pa kriter, etj të evidentuara në mjaft raste, ndikojnë në uljen e pjellorisë si dhe në degradimin e tokave bujqësore.

Blegtoria/ Përmasa e vogël e fermës rezulton në efikasitet të ulët. Kostot e foragjereve janë ende të larta dhe mbeten një pengesë kryesore për fermat që merren me blegtori.

Shumica e qumështit prodhohet nga prodhues shumë të vegjël, gjysmë të specializuar që kanë më pak se 50 dele apo dhi dhe ferma gjedhi me më pak se 5 lopë. Shumica e fermave të gjedhëve kanë 1-2 krerë gjedhë dhe rreth 2% e tyre kanë më shumë se 5 lopë. Sidoqoftë, vihet re një prirje drejt konsolidimit: numri i fermave me më shumë se 5 lopë është trefishuar në krahasim me vitin 2005, ndërkohë që numri i fermave me mbi 10 gjedhë (1 317 në vitin 2011) është pesëfishuar krahasuar me vitin 2005. Aktualisht ka 1 317 prodhues me mbi 10 krerë gjedhë; 8 347 ferma me më shumë se 50 dele dhe 3 506 ferma me më shumë se 50 dhi.

Aktorët e zinxhirit të vlerës (veçanërisht fermat dhe përpunuesit e vegjël), duhet të bëjnë më shumë për të arritur standardet mjedisore dhe ato të sigurisë ushqimore. Mbledhja dhe transporti i qumështit është një nga pikat më të dobëta në zinxhirin e vlerës. Mbledhja e qumështit të papërpunuar kryhet më së shumti direkt nga përpunues qumështi dhe nga grumbullues qumështi privatë të pavarur. Në disa raste, qumështi nuk ruhet në tank ftohës në fermë dhe as gjatë transportit për në fabrikën e bulmetit.

Prioritet për këtë sektor do të jetë prodhimi për plotësimin e kërkesës së tregut të brendshëm. Ka nevojë për investime në zinxhirin e ftohjes në fermë. Në nivel përpunimi, mbështetja do të synojë edhe përmirësimin e standardeve të sigurisë së ushqimit, edhe ato të mjedisit. Do të jepet gjithashtu mbështetje për përmirësimin e ambalazhimit dhe të etiketimit. Mbështetja për zbatimin e standardeve duhet të ecë paralelisht me ndërtimin e kapaciteteve të fermerëve e përpunuesve, si dhe me përmirësimin e zbatimit të ligjit.

Objektivat e matshme kryesore të politikave janë³¹:

- Norma e rritjes reale ekonomike e sektorit bujqësor të jetë deri në 10% në vitin 2020;
- Rritja e produktivitetit të punës në bujqësi me të paktën 10% në vit, duke arritur 6 650 Euro për njësi vjetore të punës (NJVP) në vitin 2020;
- Rritja e nivelit të investimeve në bujqësi duke arritur një nivel vjetor prej 100 milionë Euro në vitin 2020;
- Rritja e produktivitetit të punës në agropërpunim me të paktën 8-10% në vit, duke arritur 61 500 Euro për njësi vjetore të punës (NJVP) në vitin 2020;
- Rritja e nivelit të investimeve në agropërpunim duke arritur një nivel vjetor prej 70 milionë Euro në vitin 2020;
- Sjellja e të gjitha fermave dhe e operatorëve agropërpunues të regjistruar në përputhje të plotë me standardet e BE-së deri në vitin 2020;
- Rritja e madhësisë mesatare të fermës në të paktën 3 ha në vitin 2020; dhe rritja e madhësisë mesatare të fermave komerciale në 3,5 ha³².
- Rritja e organizimit të zinxhirit të vlerës nëpërmjet krijimit të 100 shoqërive dhe llojeve të ngjashme të bashkëpunimit ndërmjet fermerëve në vitin 2020;
- Krijimi i 100 mikro-ndërmarrjeve dhe i 30 000- 35 000 vendeve të reja të punës në zonat rurale përmes diversifikimit të aktivitetëve që krijojnë të ardhura;
- Përmirësimi i raportit eksport- import në 1:3 në vitin 2020;
- Krijimi i një sistemi insitucional të plotë dhe gjithëpërfshirës të MBUMK-së, i një kuadri rregullator dhe një sistemi të duhur zbatimi në përputhje me BE-në dhe PPB-në;
- Nxitja dhe krijimi i aktivitetëve përpunuesë bujqësorë me 20 000 vende pune;
- Aktivitete jo bujqësore dhe shërbime të tjera do ofrojnë deri në 50 000 vende pune.

³¹ Të dhënat për indikatorët bazë ndodhen në shtojcën A. Objektivat janë përcaktuar nga MBUMK.

³² Në madhësinë e fermës përfshihet edhe sipërfaqja e marrë me qerra afatgjatë.